Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M2-2021

**MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 19, DATË 6.4.2022 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË.*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

PARATHËNIE		*7*
SHËNIME		*9*
DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2021		*11*
1.	*VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR*	*19*
1.1	*Harta e stabilitetit financiar*	*19*
1.2	*Rreziku sistemik*	*20*
2.	*ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE SEKTORIALE*	*24*
2.1	*Mjedisi makroekonomik i jashtëm*	*24*
2.2	*Mjedisi makroekonomik në vend*	*28*
2.3	*Pozicioni financiar i ekonomisë, individëve dhe bizneseve*	*34*
3.	*TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE*	*43*
3.1	*Tregjet e kapitalit dhe tregu valutor*	*43*
3.2	*Tregu i pasurive të paluajtshme*	*47*
3.3	*Sistemet e pagesave*	*51*
4.	*SISTEMI FINANCIAR*	*52*
4.1	*Sektori bankar*	*53*
4.2	*Sektori jobankar*	*92*
5.	*POLITIKA MAKROPRUDENCIALE*	*96*
5.1	*Vlerësimi i rreziqeve sistemike në Shqipëri*	*96*
5.2	*Masat makroprudenciale në Shqipëri*	*97*

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1.	*Disa tregues për vlerësimin e ndikimit të agresionit ushtarak në Ukrainë dhe të sanksioneve ndaj Rusisë, në aktivitetin tregtar të Shqipërisë*	*31*
Hapësirë informuese 2.	*Ecuria e numrit të aplikimeve për kredi dhe norma e refuzimit nga bankat në vend, 6MII-2021*	*41*
Hapësirë informuese 3.	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për 6M II-2021*	*49*
Hapësirë informuese 4.	*Kredia e ristrukturuar gjatë vitit 2021*	*69*
Hapësirë informuese 5.	*Ekspozimi i sektorit bankar ndaj vendeve të përfshira në agresionin ushtarak në Ukrainë*	*83*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2.	*Zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale*	
Tabelë 1.	*Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare*	*27*
Tabelë 2.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor*	*28*
Tabelë 3.	*Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve*	*40*
4	*Sistemi financiar*	
Tabelë 4.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %)*	*52*
Tabelë 5.	*Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, dhjetor 2021*	*53*
Tabelë 6.	*Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për vitet 2020-2021 (mld lekë)*	*60*
Tabelë 7.	*Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*62*
Tabelë 8.	*Të dhëna mbi kredinë e ristrukturuar gjatë viteve 2020 dhe 2021*	*70*
Tabelë 9.	*Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*71*
Tabelë 10.	*Rezultatet e provës për hendekun e thjeshtë sipas monedhave dhe shportave*	*91*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

Grafik 1.	*Harta e stabilitetit financiar*	*20*
Grafik 2.	*Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik*	*21*
Grafik 3.	*Indeksi i Stresit Financiar*	*21*
Grafik 4.	*Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike*	*22*
Grafik 5.	*Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve*	*25*
Grafik 6.	*Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera*	*25*
Grafik 7.	*Rritja vjetore e PBB-së*	*29*
Grafik 8.	*Norma e papunësisë*	*29*
Grafik 9.	*Llogaria korrente dhe investimet e huaja direkte*	*31*
Grafik 10.	*Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit*	*31*
Grafik 11.	*Ecuria e deficitit buxhetor në terma të PBB-së*	*33*
Grafik 12.	*Ecuria e kursit të këmbimit*	*33*
Grafik 13.	*Depozitat dhe kredia e bizneseve (b.m.) dhe stoku i investimeve të huaja direkte (b.d.)*	*34*
Grafik 14.	*Depozitat dhe kredia e individëve*	*34*
Grafik 15.	*Pozicioni neto i individëve sipas instrumenteve*	*36*
Grafik 16.	*Mjetet dhe detyrimet e individëve sipas sektorëve kundërparti (viti 2020)*	*36*
Grafik 17.	*Indekset e aftësisë paguese për 6 muajt e kaluar dhe 6 muajt e ardhshëm*	*37*
Grafik 18.	*Indeksi i planifikimit të huamarrjes dhe shpërndarja e familjeve që planifikojnë hua të re*	*37*
Grafik 19.	*Mjetet dhe detyrimet e bizneseve sipas instrumenteve për vitet 2013-2020 dhe sipas sektorëve kundërparti për vitin 2020*	*38*
Grafik 20.	*Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave*	*40*
Grafik 21.	*Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës*	*40*
Grafik 22.	*Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive*	*41*
Grafik 23.	*Norma e refuzimit të kredive nga bankat vendase dhe të huaja*	*42*
Grafik 24.	*Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)*	*43*
Grafik 25.	*Përbërja e borxhit të brendshëm në lekë të emetuar gjatë 2016-2021*	*43*
Grafik 26.	*Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar*	*44*
Grafik 27.	*Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar*	*44*
Grafik 28.	*Vëllimi dhe norma e huamarrjes në tregun ndërkombëtar*	*45*
Grafik 29.	*Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar*	*46*
Grafik 30.	*Nivelet e Yield-it (YTM) në datën 30.6.2021*	*46*
Grafik 31.	*Normat e interesit në tregun ndërbankar*	*47*
Grafik 32.	*Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor*	*47*
Grafik 33.	*Ecuria e Indeksit Fischer të Çmimit të Banesave në rang vendi dhe për Tiranën*	*48*
Grafik 34.	*Cilësia e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme*	*48*
Grafik 35.	*Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjashtëmujorin e dytë të viteve 2020 dhe 2021*	*51*
Grafik 36.	*Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë*	*51*
Grafik 37.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2021*	*52*
Grafik 38.	*Ecuria e aktiveve në valutë dhe detyrimeve në valutë*	*54*
Grafik 39.	*Detyrimet ndaj jorezidentëve (mld lekë)*	*54*
Grafik 40.	*Pozicioni neto me jorezidentët*	*54*
Grafik 41.	*Indeksi i shëndetit bankar*	*55*
Grafik 42.	*Harta e shëndetit bankar*	*55*
Grafik 43.	*Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*56*
Grafik 44.	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit*	*56*
Grafik 45.	*Ndryshimi në kapitalin rregullator sipas elementeve përbërëse*	*57*
Grafik 46.	*Ecuria e levës financiare për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, në herë*	*57*
Grafik 47.	*Teprica e kapitalit për sektorin bankar dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas grupeve të bankave (dhjetor 2021)*	*59*
Grafik 48.	*Përbërësit e rezultatit financiar*	*61*
Grafik 49.	*ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit*	*61*
Grafik 50.	*Tregues të përfitueshmërisë dhe shpenzimeve të sektorit bankar*	*61*
Grafik 51.	*Ecuria e kredisë sipas sektorëve, kontribut në p.p., ndryshime gjashtëmujore*	*62*
Grafik 52.	*Ndryshimi 6-mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse*	*63*
Grafik 53.	*Kredia në lek dhe kredia në valutë me dhe pa efektin e kursit të këmbimit, ndryshim vjetor*	*63*
Grafik 54.	*Ecuria vjetore e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës*	*63*
Grafik 55.	*Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës*	*65*
Grafik 56.	*Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe qarqeve (Dhjetor 2021)*	*65*
Grafik 57.	*Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë*	*66*
Grafik 58.	*Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj*	*66*
Grafik 59.	*Kredia e re për bizneset dhe individët sipas qëllimit të përdorimit*	*67*
Grafik 60.	*Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja, në %: norma e agreguar, norma sipas monedhës, norma sipas subjektit*	*68*
Grafik 61.	*Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontributi në normën vjetore të ndryshimit)*	*71*

Grafik 62.	*Ecuria e depozitave në lekë dhe në euro*	*72*
Grafik 63.	*Struktura e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*72*
Grafik 64.	*Depozitat sipas afatit dhe valutës*	*72*
Grafik 65.	*Depozitat sipas afatit dhe sektorit*	*72*
Grafik 66.	*Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione*	*74*
Grafik 67.	*Kontributi në ndryshimin gjashtëmujor të stokut të kredive me probleme*	*74*
Grafik 68.	*Norma e prurjeve të kredive me probleme dhe norma e falimentit*	*75*
Grafik 69.	*Norma e kredive me probleme të rikuperuara*	*75*
Grafik 70.	*RKP-ja për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas monedhave*	*76*
Grafik 71.	*RKP-ja për kredinë e pambrojtur sipas qëllimit të përdorimit*	*76*
Grafik 72.	*Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme, sipas llojit të kolateralit*	*77*
Grafik 73.	*Diferenca në maturimin mesatar të mbetur midis aktive-pasive dhe kredi-depozita*	*78*
Grafik 74.	*Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*	*78*
Grafik 75.	*Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin bankar dhe grupet*	*79*
Grafik 76.	*Ecuria e përbërësve të indeksit për sektorin bankar*	*79*
Grafik 77.	*Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave*	*80*
Grafik 78.	*Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare*	*80*
Grafik 79.	*Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %*	*81*
Grafik 80.	*Ecuria sipas grupeve e pozicionit neto për normat fikse (FIR) dhe variabël (VIR) të interesit*	*81*
Grafik 81.	*Hendeku sipas grupeve dhe monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %*	*82*
Grafik 82.	*Pozicioni neto i peshuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %*	*82*
Grafik 83.	*Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave dhe spread i normave të interesit, në %*	*83*
Grafik 84.	*Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në p.p.*	*83*
Grafik 85.	*Projeksionet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë*	*85*
Grafik 86.	*Projeksionet mbi treguesit e rinj makroekonomikë*	*86*
Grafik 87.	*Projeksionet mbi portofolin e kredisë sipas modeleve përkatëse për bizneset dhe individët*	*86*
Grafik 88.	*Ecuria e vlerave të RMK-së përgjatë harkut kohor ushtrimor*	*87*
Grafik 89.	*Kontributi në ndryshimin e RMK i zërave kryesorë të bilancit për skenarin e rënduar*	*87*
Grafik 90.	*Kontributi në RMK për skenarin e rënduar, për Bankat me Rëndësi Sistemike - BARS dhe Banka të Tjera*	*88*
Grafik 91.	*Kontributi në RMK për skenarin e rënduar, Bankat me Kapital të Huaj dhe Vendas*	*88*
Grafik 92.	*Nevojat për kapital shtesë ndaj PBB-së*	*89*
Grafik 93.	*Diferenca midis flukseve hyrëse dhe dalëse sipas shportave të maturimit*	*90*
Grafik 94.	*Flukset e përgjithshme hyrëse dhe dalëse dhe kapacitetet kundërpeshuese*	*90*
Grafik 95.	*Struktura e sektorit jobankar*	*92*
Grafik 96.	*Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas subjekteve në vite*	*93*
Grafik 97.	*Mjetet, detyrimet dhe pozicioni neto sipas subjekteve të sektorit jobankar (shtator 2021)*	*93*
Grafik 98.	*Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas instrumenteve*	*93*
Grafik 99.	*Ndërlidhja e sektorit jobankar me sektorin bankar (shtator 2021)*	*93*

PARATHËNIE

Raporti i Stabilitetit Financiar (më tej "raporti") publikohet dy herë në vit dhe ky është numri i 27-të i tij. Në hyrje të tij është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila sipas kërkesës së ligjit duhet të publikohet çdo gjashtë muaj. Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e tij, si dhe vlerëson aftësinë e sistemit financiar për t'i përthithur këto rreziqe. Dokumenti në fjalë iu mundëson autoriteteve publike identifikimin në kohë të masave përkatëse për korrigjimet e nevojshme.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Analiza në vijim mbulon kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021 (më tej, "periudha"). Treguesit ekonomikë dhe financiarë dhe analiza shoqëruese, i referohen periudhës përpara nisjes së agresionit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, dhe nuk reflektojnë efektet ekonomike e financiare të kësaj ngjarjeje. Megjithatë, në raport është dhënë një vlerësim cilësor mbi ndikimin e mundshëm të kësaj ngjarjeje mbi ekonominë dhe veprimtarinë e sektorit bankar. Në tërësi, nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe rreth 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë së veprimtarisë së tij dhe të rreziqeve që burojnë nga ndërveprimi me mjedisin e përgjithshëm ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm. Për t'i vlerësuar këto rreziqe janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara dhe ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Për të vlerësuar zhvillimet dhe rreziqet e lidhura me ekonominë vendase, janë analizuar treguesit e rritjes ekonomike, bilancit të pagesave, nivelit të përgjithshëm të çmimeve, kursit të këmbimit, si dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve të veçanta, është vlerësuar gjendja financiare e sektorit të bizneseve/ndërmarrjeve dhe të individëve/familjeve, si edhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të ndryshme makroekonomike është vlerësuar në bazë të ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe atë të likuiditetit. Në këtë raport, për herë të parë, është përfshirë

edhe një analizë e ndërlidhjes dhe e rrezikut të përhapjes së krizave ndërmjet sektorëve institucionalë, që janë sektori i korporatave jofinanciare, sektori i ekonomive familjare, sektori i Qeverisë së Përgjithshme, sektori i korporatave financiare dhe sektori i jorezidentëve.

Raporti i Stabilitetit Financiar përgatitet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

SHËNIME

Në fund të muajit dhjetor 2021, klasifikimi i bankave në sektorin bankar shqiptar ishte si në vijim:

I. Sipas kontributit marzhinal të secilit institucion në rrezikun sistemik në vend[1], bankat grupohen në:

- Banka me rëndësi sistemike, që janë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a.;
- Banka të tjera, që janë: Banka Alpha Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka Tirana sh.a.;

II. Sipas origjinës së kapitalit, bankat grupohen në:

- Banka me kapital të huaj[2], që janë: Banka Raiffeisen sh.a. (Austri), Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (Itali), Banka Alpha Albania sh.a. (Greqi), Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi), Banka OTP Albania sh.a. (Hungari), Banka Procredit sh.a. (Gjermani), Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari), Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (Arabia Saudite). Këto banka zotërojnë 70% të aktiveve të sektorit.
- Banka me kapital shqiptar, që janë: Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a, Banka Amerikane e Investimeve sh.a., dhe Banka Tirana sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 30% të totalit të aktiveve të sektorit.

III. Shtrirje të rrjetit bankar jashtë vendit kanë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. me filialin e saj në Kosovë, dhe Banka Credins sh.a. me degën e saj në Kosovë.

Për analizën e kryer në raport, duhet të konsiderohet që:

(1) Termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit. Në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje" dhe "biznese" apo dhe "individë" dhe "familje".

[1] *Për më shumë informacion mbi indeksin dhe mbi përcaktimin e BARS, lutem konsultoni Metodologjinë "Për përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike dhe shtesën përkatëse të kapitalit" të publikuar në: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_miratuara/*

[2] *Një bankë klasifikohet si bankë me kapital të huaj, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

(2) Në këtë raport, "teprica e kredisë" i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç paraqitet në raportimet e bankave. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga largimi i kredive me probleme nga bilancet e bankave gjatë periudhës. Për këtë arsye, teprica e kredisë që analizohet në Raportin e Stabilitetit Financiar është një koncept i ndryshëm nga ai i "kredisë për ekonominë", që trajtohet në Raportet e Politikës Monetare. Në kredinë për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobanka. Gjithashtu, në vlerën e kësaj kredie përfshihet vetëm kredia për sektorin privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirjet e kredive me probleme nga bilancet e bankave duke qenë se këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën ekonomike të tyre; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt. Dallimi në këto koncepte të kredisë, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2021

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë (BSH) publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me zhvillimet ekonomike, të jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si edhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë e tij. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 (më tej, "periudha"), veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme. Depozitat dhe kreditë u rritën me ritme të shpejta, cilësia e kredisë vijoi përmirësimin dhe treguesit e tjerë të qëndrueshmërisë financiare mbetën në nivele të përshtatshme. Në tërësi, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve u paraqit i kontrolluar. Zhvillimet ekonomike përgjatë vitit 2021 ishin mjaft pozitive, ndonëse rritja ekonomike, ulja e normës së papunësisë dhe goditjet nga krahu i ofertës, u shoqëruan me rritje të presioneve inflacioniste në fund të periudhës.

Agresioni ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet ndaj Rusisë kanë ashpërsuar më tej problemet globale me zinxhirët e prodhimit dhe ofertën, duke ndikuar në rritjen e mëtejshme të çmimit të naftës, gazit, drithërave dhe metaleve. Projeksionet e reja sugjerojnë presione të qëndrueshme inflacioniste në afat të shkurtër, të cilat mund të shoqërohen me rritje të kostove të prodhimit, rënie të konsumit dhe të investimeve, pra me ngadalësim të rritjes ekonomike.

Reagimi aktual i politikave ekonomike dhe financiare për të zbutur këtë goditje, vlerësohet në drejtimin e duhur, në kushtet kur pasiguritë rreth zhvillimeve gjeopolitike dhe situatës energjetike janë të konsiderueshme. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar ndaj Rusisë dhe Ukrainës është i vogël dhe

nuk do të ndikojë në treguesit e qëndrueshmërisë financiare të veprimtarisë. Ekspozimi i tërthortë përcaktohet nga ecuria e ekonomisë, qëndrueshmëria makroekonomike dhe performanca e huamarrësve. Këto zhvillime evidentojnë nevojën që politikat ekonomike dhe financiare të ruajnë elementet e fleksibilitetit për të reaguar në linjë me dinamikën e zhvillimeve. Për sektorin bankar, mbetet aktuale rëndësia e vlerësimit të rregullt të shkallës së ekspozimit ndaj rreziqeve të reja dhe e ruajtjes së një qëndrimi proaktiv në drejtim të marrjes së masave për zbutjen dhe përballimin e tyre. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas ligjit, për të mbështetur veprimtarinë bankare dhe kontribuar në stabilitetin e sistemit financiar.

Më konkretisht, zhvillimet e periudhës treguan që:

Aktiviteti ekonomik botëror ka vijuar të rimëkëmbet gjatë periudhës, me ritëm më të ngadalësuar dhe të ndryshëm mes rajoneve. Zhvillimet pozitive në Eurozonë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë mbështetur nga lehtësimi i situatës shëndetësore të lidhur me pandeminë dhe nga forcimi i kërkesës së brendshme. Rritja e çmimeve të energjisë dhe goditjet nga ana e ofertës kanë nxitur presionet inflacioniste dhe rritje të normave të interesit nga bankat qendrore, veçanërisht në vendet e zhvilluara. Kushtet e financimit janë shtrënguar dhe luhatshmëria në tregjet financiare është rritur. Agresioni ushtarak i Rusisë në Ukrainë dhe sanksionet ekonomike të vendosura mbi Rusinë, janë shoqëruar me rritjen e çmimeve të energjisë, të ushqimeve dhe të metaleve, duke sjellë pasoja të konsiderueshme ekonomike e financiare. Shkalla e pasigurisë për mënyrën e zhvillimit të kësaj lufte dhe implikimet e saj jo vetëm ekonomike, mbeten të larta. Në afatin e shkurtër, pasojat e saj pritet të sjellin ngadalësimin e mëtejshëm të rritjes së ekonomisë botërore, duke përfshirë edhe të Bashkimit Evropian e të rajonit tonë.

Në vend, ritmi i rritjes ekonomike mbeti i lartë gjatë periudhës, pavarësisht ngadalësimit të tij. Rritja ekonomike është mbështetur nga përmirësimi i konsumit dhe i investimeve, duke reflektuar fuqizimin e kërkesës së brendshme. Ajo është shoqëruar me rënie të nivelit të papunësisë, rritje të nivelit të pagave dhe, në kushtet e vijimit të problemeve të ofertës në tregjet ndërkombëtare, me rritje të presioneve inflacioniste. Këto të fundit janë ashpërsuar pas nisjes së konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe vendosjes së sanksioneve ndaj Rusisë. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve dhe me qëllimin për të zbutur goditjen mbi bizneset dhe familjet, ka ardhur reagimi i politikave fiskale e monetare. Ky reagim vlerësohet i përshtatshëm në kushtet kur pasiguritë rreth zhvillimeve gjeopolitike dhe situatës energjetike, janë të konsiderueshme. Sfida e problematikës me të cilën po ndeshet ekonomia, kërkon fleksibilitet dhe koordinim të politikave ekonomike e financiare në afatin më të shkurtër, dhe ndërmarrjen e reformave strukturore për zhvillimin e alternativave të sigurisë energjetike dhe ushqimore në një afat më të gjatë.

Tregjet kanë operuar në mënyrë normale dhe pa luhatshmëri të mëdha. Gjatë periudhës, vëllimi i titujve të borxhit në lek të emetuar nga qeveria ishte i krahasueshëm me atë të një viti më parë. Prirja drejt huamarrjes me maturim afatgjatë ka vazhduar. Norma mesatare e interesit të titujve ka qenë e qëndrueshme dhe është luhatur rreth nivelit 2.3% gjatë gjithë periudhës. Huamarrja nëpërmjet Eurobondit, në nëntor të vitit 2021, ka rezultuar e dobishme në kushtet e zhvillimeve gjeopolitike të fillimvitit 2022. Në tregun dytësor, vlera e tregtuar shënoi rritje gjatë periudhës dhe kontributi kryesor ka ardhur nga titujt afatgjatë. Zhvilluesit e tregut kanë ndihmuar në rritjen e numrit dhe të vlerës së titujve të referencës së tregtuar. Kurba e *yield*-eve në treg shfaq një pjerrësi normale dhe investitorët vijojnë të kenë preferencë për mbajtjen e titujve deri në maturim.

Në tregun ndërbankar, vëllimi i transaksioneve është rritur gjatë vitit të fundit, për shkak të rritjes së vëllimit të transaksioneve javore dhe ditore. Norma mesatare e interesit në këto transaksione është luhatur pranë normës bazë të interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo ecuri ka reflektuar edhe injektimin e likuiditetit pa kufi nga Banka e Shqipërisë gjatë periudhës. Kursi i këmbimit të lekut ka qenë i qëndrueshëm, duke reflektuar edhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Monedha vendase u mbiçmua ndaj monedhës evropiane dhe u nënçmua ndaj dollarit amerikan. Në tregun e pasurive të paluajtshme, kërkesa dhe oferta kanë shënuar rritje gjatë periudhës. Ato janë mbështetur nga rritja e kredisë bankare për prona dhe për ndërtim. Çmimet e banesave të shitura janë rritur me 8.4% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 9% në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që edhe kostot e ndërtimit janë rritur me rreth 3% në terma vjetorë. Agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme mbeten relativisht optimistë për të ardhmen e këtij tregu.

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në lekë ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Gjatë periudhës është vërejtur rritje e numrit dhe vëllimit të transaksioneve me vlerë të vogël dhe të madhe, dhe rritje e përdorimit të instrumenteve të pagesave, ku kanë dhënë kontribut pozitiv ato me kartë dhe pagesat përmes aksesit të drejtpërdrejtë në aplikacionet dhe faqet e internetit të bankave.

Rritja e fortë e kursimeve ka bërë që pozicioni kreditor i individëve të rritet, ndërsa pozicioni neto debitor i bizneseve të tkurret. Në tërësi, ekonomia shqiptare ka një pozicion huamarrës neto ndaj pjesës tjetër të botës. Kontributin kryesor në këtë pozicion e japin sektorët e biznesit dhe të qeverisë së përgjithshme. Sektori i individëve ka një pozicion neto kreditor, ndërsa institucionet financiare kanë një pozicion neto të balancuar. Duke u përqendruar tek individët dhe bizneset, vërehet se gjatë periudhës, rritja më e fortë e depozitave në krahasim me kredinë, ka bërë që pozicioni kreditor i individëve të zgjerohet dhe ai debitor i bizneseve të tkurret. Sipas monedhës, vërehet që individët kanë një strukturë të balancuar të depozitave dhe kredive midis lekut dhe valutës. Për sektorin e biznesit, preferenca për valutën duket më e qartë. Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare të familjeve tregojnë

se pjesa e familjeve që kanë një hua për të paguar nuk paraqiti ndryshime të rëndësishme përgjatë vitit 2021.

Aftësia paguese e familjeve huamarrëse u paraqit në rënie gjatë periudhës. Kërkesa e individëve për kredi pritet të gjallërohet disi gjatë pjesës së parë të vitit 2022, nëse ndikimi nga zhvillimet gjeopolitike rezulton më afatshkurtër sesa pritjet aktuale. Për bizneset, rezultatet e vrojtimit tregojnë se ecuria e nivelit të shitjeve dhe e rezultatit financiar paraqitet e përmirësuar në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Vlerësimi i ndërmarrjeve për rritjen e investimeve dhe zgjerimin e veprimtarisë vijon të sinjalizojë zhvillime pozitive. Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ndaj numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve nuk ka shënuar ndryshime të ndjeshme gjatë vitit. Ngarkesa me borxh ka ardhur në rënie në raport me kapitalin, por duket disi më e lartë në raport me të ardhurat e bizneseve. Pritjet për huamarrje të bizneseve në periudhën e ardhshme duken më të mira, por pasiguritë mbeten të pranishme. Vrojtimi për aplikimet për huamarrje tregon se numri i përgjithshëm i aplikimeve ishte më i ulët se një vit më parë, por norma e refuzimit të aplikimeve ka mbetur e njëjtë. Nga aplikimet e shqyrtuara, norma e refuzimit ka vijuar të bjerë për ndërmarrjet e mëdha.

Gjatë periudhës, pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është rritur lehtë, duke u ngjitur në nivelin 111%. Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë aktivitetet e sektorit bankar dhe të fondeve të investimeve. Pesha e sektorit bankar ndaj PBB-së arriti në 99%, ndërsa pesha e sektorit jobankar rezultoi sa 12% e PBB-së duke mos shënuar ndryshime nga niveli i një viti më parë. Treguesit e performancës së sistemit financiar duke përfshirë ata të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbetën në nivele të mira. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i kufizuar dhe nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme gjatë kësaj periudhe. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj atij bankar vijon të mbetet i lartë, duke qenë se vendosjet e jobankave pranë sektorit bankar, në formën e depozitave dhe instrumenteve të kapitalit zënë rreth 1/5 e bilancit të jobankave.

Sektori bankar e zgjeroi ndjeshëm veprimtarinë gjatë periudhës dhe rritja e fortë e depozitave është drejtuar kryesisht në investimet në tituj dhe në kreditim. Veprimtaria në valutë e sektorit bankar është pothuajse e përputhur në të dy krahët e bilancit. Depozitat dhe fondet e veta përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë. Gjatë periudhës, efekti statistikor i kursit të këmbimit, në vlerat e raportuara në lek, ka qenë i vogël. Pesha e pozicionit kreditor neto të sektorit bankar ndaj jorezidentëve nuk ka ndryshuar, ndërsa varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbeti në nivele të ulëta. Në përgjithësi, indeksi i shëndetit bankar tregoi përmirësim të situatës financiare të sektorit bankar.

Sektori bankar ruajti një nivel të përshtatshëm të kapitalizimit gjatë periudhës dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit u luhat rreth nivelit 18%. Kundrejt të

njëjtës periudhë të një viti më parë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar rënie. Në këtë rënie vjetore ndikoi kryesisht rritja relative e aktiveve të peshuara me rrezik, e cila tejkaloi rritjen e kapitalit rregullator. Bankat me kapital evropian dhe bankat sistemike raportojnë nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Sektori bankar e mbylli vitin 2021 me një fitim gati 30% më të lartë se një vit më parë. Në rritjen vjetore të rezultatit financiar kanë ndikuar rritja në të ardhurat neto nga interesat dhe nga veprimtaritë e tjera, dhe rënia e shpenzimeve për provigjionimin e rrezikut të kredisë. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë janë rritur dhe raporti i tyre ndaj të ardhurave të veprimtarisë është rritur lehtë kundrejt një viti më parë. Sipas monedhës, në rezultatin financiar të sektorit ka kontribuar kryesisht veprimtaria në monedhën kombëtare.

Teprica e kredisë bankare në fund gjashtëmujorit të parë të vitit 2021 ishte rreth 670 miliardë lekë, dhe u rrit me 7% gjatë periudhës dhe me 10% ndaj një viti më parë. Ndikimin kryesor në zgjerimin e stokut të kredisë gjatë periudhës e ka dhënë shtesa nga kredia e re, e cila ishte gati 40% më e lartë në krahasim me periudhën e mëparshme. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës ka shënuar rënie. Rritja më e lartë është regjistruar në kredinë për bizneset, kredinë në valutë dhe kredinë afatshkurtër. Fshirja e kredive me probleme nga bilancet e bankave ka vijuar me ritme më të ulëta. Për bizneset, zgjerimi i kredisë është ndikuar nga ecuria e kredisë afatshkurtër. Rritja e kredisë për individët lidhet me rritjen e kredisë për konsum mallrash dhe për blerje pasurish të paluajtshme. Peshën kryesore në kredinë për bizneset, e zë kredia për investime në pasuri të paluajtshme dhe ajo për blerje pajisjesh, me nga 30%. Në kredinë për individë, peshën kryesore e zë kredia për blerje pasurish të paluajtshme me gati 70%. Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë ka rënë lehtë gjatë periudhës. Si rezultat, pesha e kredisë së pambrojtur në valutë ndaj kredisë në valutë dhe tepricës së përgjithshme të kredisë ka shënuar rënie. Kredia e ristrukturuar gjatë periudhës ishte sa 25% e kredisë së ristrukturuar për vitin 2021 dhe u përqendrua tek kredia për individët, ajo në valutë dhe kredia për tregti.

Zgjerimi i depozitave në gjashtëmujorin e dytë të vitit ishte gati dy herë më i lartë se rritja e tyre në gjashtëmujorin e parë të vitit. Depozitat u rritën me 7% gjatë periudhës dhe me gati 11% kundrejt një viti më parë, duke u ngjitur në nivelin 1,433 miliardë lekë. Rritja e fortë e depozitave është mbështetur nga rritja në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në valutë. Pesha e depozitave me afat ndaj stokut të përgjithshëm të depozitave ka vijuar të bjerë, në favor të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat. Depozitat e bizneseve mbahen kryesisht në formën e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave pa afat, dhe janë të balancuara sipas monedhës. Depozitat e individëve vijojnë të dominojnë në vlerën e përgjithshme të depozitave dhe janë kryesisht në formën e depozitave me afat. Sipas monedhës, pesha e valutës ka ardhur në rritje. Normat mesatare të interesit për llojet e ndryshme të depozitave nuk kanë shënuar ndryshime të ndjeshme gjatë periudhës.

Në tërësi, rreziqet për ekonominë shqiptare kanë qenë të kontrolluara gjatë periudhës. Harta e stabilitetit financiar, e ndërtuar me tregues që ende nuk kishin reflektuar ndikimin e luftës në Ukrainë, tregoi nivele më të ulëta të rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm makroekonomik dhe për agjentët e ekonomisë reale në krahasim me gjysmën e parë të vitit, ndërsa rreziqet që lidhen me veprimtarinë bankare mbetën në nivele të kontrolluara. Paralelisht, tregues të tjerë që përpiqen të kapin perceptimet dhe vlerësimet për rreziqet sistemike, duke përfshirë edhe vlerësimet e industrisë bankare, evidentuan zbutje të rreziqeve të lidhura me zhvillimet ekonomike dhe cilësinë e kredisë, por edhe nevojën për rritjen e kujdesit ndaj ecurisë së deficitit buxhetor, nivelit të borxhit publik dhe, së fundi, të inflacionit. Këto çështje fitojnë një rëndësi më të madhe në kushtet e pasojave ekonomike që lidhen me agresionin në Ukrainë dhe të nevojës për zbutjen e tyre. Rritja e çmimit të banesave në tregun e pasurive të paluajtshme, e cila vijon në mënyrë të pandërprerë prej disa vitesh, ka nevojë të analizohet nga këndvështrimi i qëndrueshmërisë. Zbutja e rreziqeve që mund të vijnë nga zhvillimet në këtë treg do të vendoset edhe në vëmendjen e politikës makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë.

Në terma të rreziqeve më specifike për veprimtarinë e sektorit bankar, vërehet se:

Rreziku i kredisë shënoi rënie të ndjeshme gjatë periudhës. Raporti i kredive me probleme vijoi rënien, duke shënuar nivelin 5.6%. Ky përmirësim është vënë re në të gjitha llojet e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës. Tkurrja e ndjeshme e stokut të kredive me probleme, që zbriti në rreth 40 miliardë lekë, lidhet me hyrjet më të pakta të kredive të reja me probleme, riklasifikimin e kredive me probleme në klasa më të mira dhe fshirjet e kredive të humbura. Përmirësimi i cilësisë së kredisë konfirmohet edhe nga tregues të tjerë plotësues. Krijimi i provigjioneve për rrezikun e kredisë ka qenë në vlera më të ulëta se në periudhat e mëparshme, por për shkak të zvogëlimit të stokut të kredive me probleme, raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme u ngjit në nivelin 69%.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar vlerësohet në nivele të mira, por ka nevojë për monitorim të kujdesshëm. Treguesit e likuiditetit, në lek dhe valutë, mbetën ndjeshëm mbi nivelet minimale rregullative. Depozitat vijojnë të mbulojnë më shumë se dy herë vlerën e kredive, në lek dhe në valutat kryesore. Diferenca midis afatit mesatar të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve, është rritur lehtë gjatë periudhës. Për afatet e shkurtra të maturimit, hendeqet midis aktiveve dhe detyrimeve mbeten në vlera të dukshme negative. Këto hendeqe mbulohen nga prania e bollshme e aktiveve likuide. Megjithatë, në një situatë hipotetike stresi likuiditeti, cilësia e likuiditetit të aktiveve të përzgjedhura mund të sfidohet nga thellësia e tregjeve ku ato mund të tregtohen ose faktorë të tjerë të paprovuar më parë. Për këto arsye, është e nevojshme që secila bankë të vlerësojë kapacitetet dhe kuadrin e saj për krijimin e burimeve të likuiditetit që mund të nevojiten në kushte stresi, dhe të ndërmarrë veprimet e duhura strukturore për zbutjen graduale të hendekut të maturimit në afatin e shkurtër.

Rreziqet e tregut kanë njohur rritje gjatë periudhës, por mbeten në nivele të kontrolluara. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit është shtuar gjatë periudhës, por mbetet ndjeshëm nën limitin e përcaktuar rregullator. Treguesi i pozicionit të hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator është ngjitur në 9.2%, duke mbetur rreth tre herë më i ulët se kufiri i sipërm rregullator. Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka shënuar rënie. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të normës së interesit ka shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës. Madhësia e ndikimit të ndryshimit të normës së interesit, e matur nga raporti i pozicionit total neto të peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator të sektorit bankar, shënoi 5.9% në fund të vitit, duke u rritur me 0.3 p.p. ndaj periudhës së mëparshme. Ky tregues mbetet ndjeshëm nën kufirin e sipërm të përcaktuar nga kuadri rregullator. Ashtu si edhe për rreziqet e tjera, edhe për rreziqet e tregut është e nevojshme të vlerësohet dhe të monitorohet rregullisht ekspozimi i bankave të veçanta. Rezultatet tregojnë që pavarësisht një shpërndarjeje të larmishme, në secilin rast respektohen kufijtë e përcaktuar nga rregullorja përkatëse.

Zhvillimet gjeopolitike në Evropë do të ndikojnë në rritjen e rreziqeve për veprimtarinë bankare. Megjithëse ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar shqiptar në tregjet dhe instrumentet financiare të vendeve të përfshira në luftime është i parëndësishëm, ndikimi mund të vijë tërthorazi nëpërmjet rënies së besimit të familjeve dhe të bizneseve në vend, ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe dobësimit të performancës së huamarrësve në sektorët më të ekspozuar. Këto mund të rezultojnë në rënien e cilësisë së kredisë dhe uljen e rezultatit financiar për sektorin bankar. Krahas këtyre rreziqeve, vetë bankat vlerësojnë se është rritur mundësia e sulmeve kibernetike në infrastrukturën e tyre të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, duke evidentuar rëndësinë e forcimit të rezistencës së kësaj infrastrukture atje ku është e nevojshme.

Rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës mbështesin vlerësimet për gjendjen e mirë financiare të sektorit bankar. Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve nga ekonomia reale ose tregjet financiare në një horizont afatmesëm, Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike ushtrimet e provës së rezistencës. Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit ose aftësinë paguese tregon shkallën e rezistencës së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë përshtatshmërinë e tij në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike, kredinë, nivelet e kursit të këmbimit dhe normat e interesit. Prova e rezistencës së likuiditetit tregon aftësinë e sektorit bankar për të përballuar situatat e stresit të likuiditetit brenda një horizonti afatmesëm.

Në tërësi, këto ushtrime të kryera për fundin e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021, dhe të shtrira në periudhën 2022-2023, tregojnë se sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj goditjeve të supozuara makroekonomike, dhe se gjendja e likuiditetit të tij është e fortë. Rezultatet gjithashtu tregojnë që banka të veçanta janë më të ndjeshme ndaj goditjeve të supozuara dhe kanë nevojë të fuqizojnë pozicionet e tyre të likuiditetit dhe të kapitalit.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë vlerëson se sistemi financiar dhe sektori bankar kanë vijuar të performojnë në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit 2021. Por ndikimet e ekonomisë së vendit nga zhvillimet gjeopolitike të fundit në Evropë dhe situata e pafavorshme energjetike, përfaqësojnë sfida të rëndësishme për politikat ekonomike dhe mund të ndikojnë veprimtarinë e sistemit financiar dhe të sektorit bankar në mënyra të ndryshme. Ndaj për sektorin bankar, mbetet aktuale rëndësia e vlerësimit të rregullt të shkallës së ekspozimit ndaj rreziqeve të reja, dhe e ruajtjes së një qëndrimi proaktiv në drejtim të marrjes së masave për zbutjen dhe përballimin e tyre.

1. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

1.1 HARTA E STABILITETIT FINANCIAR

Mbështetur në zhvillimet e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021, harta e stabilitetit financiar tregon një nivel përgjithësisht të kontrolluar të rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm makroekonomik dhe për agjentët e ekonomisë reale. Edhe rreziqet që lidhen me veprimtarinë e sektorit bankar gjithashtu mbeten në nivele të kontrolluara dhe në zbutje. Treguesit janë vlerësuar përpara zhvillimeve më të fundit gjeopolitike dhe ekonomike, ndaj ecuria e tyre do të monitorohet dhe rivlerësohet në vijim. Në mënyrë të përmbledhur, vlerësohet se:

Harta e stabilitetit financiar, që përmbledh rreziqet më të rëndësishme nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm përpara agresionit ushtarak të Rusisë në Ukrainë, tregon që në përgjithësi, këto rreziqe kanë ardhur duke u zbutur gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021.

Harta tregon një nivel më të ulët të rreziqeve nga mjedisi i përgjithshëm makroekonomik dhe nga veprimtaria e agjentëve të ekonomisë reale. Edhe rreziqet nga veprimtaria e sektorit bankar mbetën në nivele të kontrolluara dhe në rënie.

A. Në mjedisin e përgjithshëm ekonomik:

I. Rreziku që buron nga ekonomia e brendshme u vlerësua "mesatar" dhe i pandryshuar përgjatë vitit. Norma e inflacionit dhe nevojat për financim të jashtëm për shkak të zgjerimit të deficitit të llogarisë korrente, kanë sinjalizuar nivele më të larta të rrezikut. Sidoqoftë, ky efekt është balancuar nga qëndrueshmëria në treguesit e hendekut të prodhimit, kursit të këmbimit dhe stokut të borxhit të jashtëm.

II. Rreziku i përgjithshëm nga mjedisi i jashtëm vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe në zbutje krahasuar me një vit më parë. Pas zbutjes së ndikimeve nga pandemia, shumica e partnerëve tanë tregtarë[3] kanë regjistruar rigjallërim të aktivitetit ekonomik, siç konfirmohet nga ecuria pozitive e indeksit paralajmërues OECD-CLI[4] mbi aktivitetin ekonomik botëror. Rritja e theksuar e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, nuk ka qenë e mjaftueshme për të ndryshuar balancën e rrezikut në këtë kategori.

B. Në agjentët kryesorë të ekonomisë reale:

I. Rreziku nga bizneset u vlerësua "i ulët", dhe ka rënë ndaj nivelit të një viti më parë. Në këtë kategori, përmirësim të ndjeshëm ka dhënë indeksi i gjendjes financiare dhe pritshmëritë e sektorit privat, ndërkohë që ka vijuar përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë së bizneseve.

II. Rreziku nga individët vijoi të vlerësohet "mesatar" dhe i pandryshuar ndaj një viti më parë. Nota e rrezikut të kësaj kategorie është ndikuar nga ngadalësimi i dërgesave të emigrantëve dhe pesha e huamarrjes

[3] *Shifrat e larta të rritjes së PBB-së janë diktuar pjesërisht dhe nga efekti i llogaritjeve mbi një bazë shumë të ulët të treguesit të shënuar gjatë vitit të kaluar.*

[4] *Indeksi OECD-CLI (Composite Leading Indicator) jep sinjale paralajmërimi të hershëm mbi kthesat e ciklit të biznesit në nivel global. Rënia e vlerave të tij sinjalizon rënien e nivelit të aktivitetit ekonomik nën potencialin afatgjatë të tij.*

së individëve, ndërkohë që tregu i banesave, norma e papunësisë dhe pritshmëritë e individëve kanë ruajtur një nivel të pandryshuar të notës së rrezikut.

III. Rreziku nga qeveria vijon të vlerësohet "mesatar", por disi në rënie ndaj një viti më parë. Në këtë ecuri kanë ndikuar madhësia e deficitit buxhetor në raport me PBB-në dhe ecuria e përmirësuar e të ardhurave tatimore.

C. Në veprimtarinë e sektorit bankar, në fund të periudhës:

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



* Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

I. Rreziku nga kapitalizimi dhe përfitueshmëria u vlerësua në nivelin "mesatar" dhe i pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Rritja e të ardhurave nga interesat në aktivitetin bankar dhe rënia e raportit të kredive me probleme, kanë kontribuar në mbajtjen e këtij rreziku në nivele të ulëta.

II. Rreziku nga likuiditeti dhe financimi ka mbetur në nivelin "mesatar" dhe me një prirje të lehtë rënëse gjatë vitit. Rritja e depozitave vendase ka balancuar rrezikun lidhur me zgjerimin e lehtë të financimit nga jorezidentët, ndërkohë që treguesit e tjerë kanë mbetur pothuaj të pandryshuar.

III. Rreziku që lidhet me strukturën e sektorit bankar u vlerësua në nivelin "mesatar" dhe me prirje të lehtë rënëse ndaj një viti më parë. Rritja e rrezikut si rezultat i rritjes së përqendrimit të kredisë bankare ndaj biznesit është balancuar nga rënia e rrezikut të lidhur me treguesin e përqendrimit të burimeve të financimit të sektorit bankar.

Treguesit e agreguar të materializimit dhe akumulimit të rreziqeve sistemike kanë shënuar rënie gjatë periudhës.

Përpara agresionit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, sektori bankar perceptonte zbutje të rreziqeve të lidhura me ecurinë ekonomike dhe cilësinë e kredisë, pavarësisht shqetësimit në rritje ndaj rrezikut të inflacionit.

Në vijim të agresionit, bankat vlerësojnë rritje të rreziqeve për kuadrin makroekonomik dhe për veprimtarinë e tyre.

1.2 RREZIKU SISTEMIK

Për të vlerësuar dhe monitoruar ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik përdoren tre tregues të agreguar që paraqesin akumulimin e rrezikut sistemik, materializimin e rrezikut sistemik dhe shkallën e stresit financiar, si edhe vrojtimi i perceptimit të sektorit bankar rreth këtyre rreziqeve[5]. Treguesit sugjerojnë se stresi financiar nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës, ndërkohë që rreziku sistemik me të cilin është përballur sistemi financiar dhe rreziku sistemik i akumuluar kanë shënuar nivele më të ulëta gjatë gjysmës së dytë të vitit në krahasim me periudhat paraardhëse. Në zbutjen e rrezikut të materializuar kanë ndikuar përmirësimi i cilësisë së kredisë dhe rënia e papunësisë, ndërsa në zbutjen e rrezikut sistemik të akumuluar kanë ndikuar përmirësimi i treguesve të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm dhe i cilësisë së kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit.

[5] *Perceptimi i sektorit bankar mbi rreziqet kryesore sistemike në vend përftohet nëpërmjet një vrojtimi ad hoc.*

1.2.1 ZHVILLIMET NË TREGUESIT E RREZIKUT SISTEMIK

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik kanë rënë krahasuar me fundin e një viti më parë. Ecuria e indeksit të akumulimit të rrezikut sistemik u përcaktua nga rënia e portofolit të kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit si dhe përmirësimi relativ i treguesve të borxhit publik, borxhit të jashtëm dhe llogarisë korrente[6]. Në indeksin e materializimit kanë ndikuar përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë, rënia e papunësisë dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit të monedhës vendase. Për shkak të mënyrës së ndërtimit dhe fenomeneve që trajton secili tregues, pritet që në të ardhmen indeksi i materializimit të pasqyrojë rënien e vërejtur në indeksin e akumulimit të rrezikut sistemik. Indeksi i stresit financiar nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Rritja e depozitave dhe e kredisë me ritme më të larta nga prirja afatgjatë, tregon për mungesën e shqetësimeve të rëndësishme në veprimtarinë bankare. Në tregun e parasë, gjendja e qetë e likuiditetit është pasqyruar në ngushtimin e lehtë të *spread*-it të normës njëditore të interesit për transaksionet ndërbankare. Lëvizjet në kursin e këmbimit gjatë periudhës, kanë dhënë një kontribut të vogël pozitiv në drejtim të rritjes së vlerës së indeksit të stresit financiar.

Grafik 2. Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Indeksi i Stresit Financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2.2 PERCEPTIMI I RREZIKUT SISTEMIK NGA SEKTORI BANKAR

Rezultatet e vrojtimit mbi perceptimin e rreziqeve sistemike në vend nga industria bankare, të kryer përpara fillimit të agresionit ushtarak të Rusisë mbi Ukrainën, sugjerojnë se lehtësimi i situatës pandemike dhe rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik brenda dhe jashtë vendit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, kanë ndikuar në zbutjen e perceptimit të përgjithshëm të sektorit bankar

[6] *Treguesit e borxhit dhe të llogarisë korrente ndaj PBB-së janë përmirësuar për shkak të rritjes më të madhe të PBB-së në raport me këta tregues.*

ndaj rreziqeve sistemike. Rreziku i përkeqësimit të ekonomisë së vendit dhe rreziku i kredisë nga të gjitha subjektet, ndonëse kanë vijuar të klasifikohen nga bankat si dy rreziqet kryesore sistemike në vend, janë vlerësuar në rënie gjatë periudhës. Nga ana tjetër, zgjerimi i borxhit publik në raport me PBB-në, i ndikuar edhe nga kostot e administrimit të pandemisë, ka vijuar të konsiderohet si rrezik i rëndësishëm, për shkak të pasojave që mund të vijnë nga masat për rikthimin e tij në nivelet e mëparshme. Një rrezik i ri i evidentuar nga bankat gjatë periudhës është dhe rreziku i inflacionit, që deri tani është konsideruar minimal. Pengesat në zinxhirët e prodhimit dhe tregtimit në mbarë botën si pasojë e pandemisë, kanë sjellë forcim të ndjeshëm të presionit për rritje të çmimeve në muajt e fundit të vitit 2021, si brenda edhe jashtë vendit. Këto zhvillime duket se kanë rritur shqetësimin e bankave mbi këtë rrezik dhe pasojat që mund të ketë rritja e çmimeve mbi sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar paraqitet më i fortë në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit dhe një vit më parë, dhe indeksi i besimit është rikthyer në nivelet e parapandemisë. Ky besim ka mbetur i kënaqshëm dhe paraqitet në rritje si për horizontin afatshkurtër (deri në një vit) ashtu edhe për të ardhmen afatmesme (deri në tre vjet). Sektori bankar gjykon se pavarësisht sfidave që kanë karakterizuar mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm gjatë dy viteve të fundit, sistemi financiar në vend ka mbetur i qëndrueshëm, i mirëkapitalizuar dhe i aftë për të përthithur humbjet e mundshme nga kriza. Rritja e nivelit të besimit gjatë gjysmës së dytë të vitit tregon se, pavarësisht rikthimit të valës së infektimeve me variantet e reja të COVID-19 në fund të vitit, efektet negative të pandemisë mbi ekonominë dhe sistemin financiar në vend kanë qenë të kufizuara dhe kanë ardhur duke u zbutur gjatë periudhës.

Grafik 4. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kuadër të mbledhjes së vlerësimeve të bankave për mënyrën se si situata ekonomike në vend mund të ndikohet nga lufta në Ukrainë dhe sanksionet

ndaj Rusisë, Banka e Shqipërisë kreu një vrojtim të posaçëm[7] gjatë muajit mars 2022. Nga përgjigjet rezulton se bankat vlerësojnë që lufta në Ukrainë dhe sanksionet ndaj Rusisë do të kenë ndikim mbi ekonominë shqiptare, kryesisht në formën e ngadalësimit të rritjes ekonomike, rritjes së inflacionit, rritjes së deficitit buxhetor dhe përkeqësimit të bilancit tregtar, për një periudhë kohe që shkon përtej vitit 2022. Sektorët ekonomikë më të ekspozuar negativisht janë energjia, drithërat, ndërtimi dhe turizmi. Në veprimtarinë bankare, ndikimi më i madh pritet në rënien e cilësisë së portofolit të kredisë, që mund të shtrihet përtej vitit 2022. Bankat shfaqin një ndjeshmëri të lartë edhe ndaj mundësisë së cenimit të sigurisë kibernetike. Në tërësi, ndikimi nuk pritet të dëmtojë ndjeshëm treguesit e likuiditetit dhe të kapitalit. Bankat janë duke monitoruar ecurinë e situatës dhe pritet të zhvillojnë vlerësime më konkrete në të ardhmen afatshkurtër.

[7] *Për më shumë detaje, shiko Aneksin 1*

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE SEKTORIALE

2.1 MJEDISI MAKROEKONOMIK I JASHTËM

Aktiviteti ekonomik botëror ka vijuar të rimëkëmbet gjatë periudhës, me ritëm më të ngadalësuar dhe të ndryshëm mes rajoneve. Zhvillimet pozitive në Eurozonë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë mbështetur nga forcimi i kërkesës së brendshme.

Rritja e çmimeve të energjisë dhe goditjet nga oferta kanë nxitur presionet inflacioniste dhe rritje të normave të interesit nga bankat qendrore. Kushtet e financimit janë shtrënguar dhe luhatshmëria në tregje është rritur.

Agresioni ushtarak i Rusisë në Ukrainë dhe sanksionet ekonomike ndaj Rusisë, janë shoqëruar me rritjen e çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve, dhe pasoja të konsiderueshme ekonomike e financiare. Shkalla e pasigurisë për mënyrën e zhvillimit të kësaj lufte dhe implikimet e saj, mbeten të larta. Në afatin e shkurtër, pritet që ajo të sjellë ngadalësimin e mëtejshëm të rritjes së ekonomisë botërore dhe asaj të rajonit tonë.

Me gjithë vijimin e pandemisë COVID-19, aktiviteti ekonomik botëror ka vijuar të normalizohet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, me ritëm më të ngadaltë se pritjet dhe ecuri të ndryshme mes rajoneve. Rritja është mbështetur nga rimëkëmbja e aktivitetit në sektorët e shërbimeve dhe rigjallërimi i konsumit, pas lehtësimit të masave kufizuese të lidhura me pandeminë, në muajt e verës. Nga ana tjetër, zgjerimi i prodhimit dhe i tregtisë janë frenuar nga rikthimi i valës së infektimeve me variantin Omikron në fund të vitit dhe nga intensifikimi i problematikave në zinxhirët e ofertës së prodhimit. Administrimi i pandemisë dhe vijimi i politikave mbështetëse financiare e fiskale, ishin faktorë kyçë në rimëkëmbjen ekonomike të rajoneve, duke sjellë dhe diferenca mes tyre.

Lehtësimi i masave kufizuese në vendet e zhvilluara ndihmoi në normalizimin e aktivitetit ekonomik gjatë tremujorit të tretë të vitit, por ritmi u ngadalësua disi në muajt e fundit të vitit për shkak të rritjes së infektimeve. Në rajonet në zhvillim, ekonomia u ndikua negativisht nga mungesat në tregun e punës për shkak të masave anticovid, problematikat financiare në sektorin e pasurive të paluajtshme në Kinë dhe shtrëngimi i kushteve të financimit në tregje. Presionet inflacioniste janë rritur ndjeshëm në të gjithë botën në gjysmën e dytë të vitit, ndikuar nga rritja e çmimeve të energjisë dhe pengesat në zinxhirët e ofertës, në kushtet e një kërkese të shtuar globale për mallra dhe shërbime. Në rajonet e zhvilluara, normat e inflacionit kanë tejkaluar mesataren historike të viteve të fundit, ndërsa në rajonet në zhvillim, dinamikat kanë qenë të ndryshme, por me prirje rritëse të çmimeve.

Kushtet e financimit në shkallë globale mbetën përgjithësisht të qëndrueshme dhe në mbështetje të rritjes ekonomike. Megjithatë, në tregjet e vendeve të zhvilluara, përkeqësimi i situatës pandemike për shkak të rritjes së infektimeve me variantin Omikron, rritja e presioneve inflacioniste në mbarë botën dhe njoftimi i Rezervës Federale të SHBA-së (FED) për shtrëngimin e politikës monetare, sollën rritje të tensioneve në tregjet financiare. Kjo u reflektua në rritjen e luhatshmërisë së normave të interesit dhe rënie të vlerave në tregjet e aksioneve, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim. Në tregjet e monedhave, euro përgjithësisht u nënçmua gjatë periudhës ndaj monedhave kryesore si dollari amerikan, jeni japonez, franga zvicerane dhe paundi britanik, duke reflektuar pritjet e tregjeve për një normalizim më të shpejtë të politikës monetare të FED-it dhe Bankës së Anglisë.

Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e naftës dhe nënprodukteve të saj kanë vijuar të rriten gjatë periudhës, si pasojë e zhvillimeve në faktorë të kërkesës dhe ofertës. Rigjallërimi i ekonomisë botërore dhe rifillimi i fluturimeve ndërkombëtare pas heqjes së kufizimeve të lëvizjes në gjysmën e parë të vitit, rritën ndjeshëm kërkesën për naftë dhe nënproduktet e saj. Nga ana tjetër, nivelet e prodhimit nuk arritën të mbulojnë kërkesën, duke sjellë rritje të ndjeshme të presionit të çmimeve në tregje. Një prirje të ngjashme kanë ndjekur çmimet e metaleve dhe të produkteve ushqimore, ndikuar nga forcimi i kërkesës globale në kushtet e problematikave në zinxhirët e ofertës.

Grafik 5. Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane

Grafik 6. Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera



Burimi: Banka Qendrore Evropiane

Deri në janar të vitit 2022, parashikimet afatshkurtra dhe afatmesme të ekspertëve mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik botëror ishin përgjithësisht pozitive[8]. Sipas tyre, ekonomia globale pritej të zgjerohej me ritëm të qëndrueshëm, mbështetur nga forcimi i kërkesës për mallra dhe shërbime, dhe programet e mbështetjes fiskale veçanërisht në rajonet e zhvilluara. Presionet inflacioniste priteshin të larta në gjysmën e parë të vitit 2022 dhe do të fillonin të normalizoheshin gjatë gjysmës së dytë të tij, si rezultat i shuarjes së efektit të faktorëve të përkohshëm. Perspektiva afatshkurtër mbetej e ndikuar në një masë të madhe nga dinamikat e pandemisë, zgjidhja e pengesave në zinxhirët e prodhimit dhe shpërndarjes, si dhe shpejtësia e normalizimit të politikës monetare të bankave të mëdha qendrore.

Në fund të shkurtit 2022, bota u përball me agresionin ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, konflikti më i madh ushtarak që prej Luftës së Dytë Botërore dhe një sfidë për rendin botëror. Në shenjë reagimi të fortë, shumë vende të zhvilluara ekonomikisht dhe demokratike, kanë vendosur sanksione të fuqishme ekonomike dhe financiare ndaj Rusisë, të cilat përfshijnë bllokimin e aseteve të bankave që

[8] *Në parashikimin e muajit janar 2022, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vlerësonte që ekonomia botërore do të zgjerohet me 7.7% në vitin 2022 dhe me 3.8% gjatë vitit 2023 (World Economic Outlook, update).*

kontrollohen nga shteti dhe të një numri individësh, përjashtimin e disa bankave ruse nga sistemi i kryerjes së pagesave ndërkombëtare SWIFT dhe ndalimin e aksesit të bankës qendrore në Rusi ndaj një pjese të konsiderueshme të rezervës valutore. Ndonëse Rusia dhe Ukraina, së bashku, zënë më pak se 2% të ekonomisë botërore, ato kanë një peshë shumë më të rëndësishme si prodhues të naftës dhe gazit, të drithërave e të fertilizuesve, dhe të mineraleve. Si rezultat, çmimet e këtyre produkteve në tregjet botërore janë rritur ndjeshëm (nga 20%-40%), duke ashpërsuar më tej zhvillimet inflacioniste globale. Goditja ndjehet më e fortë në tregjet që janë të varura më shumë nga burimet energjetike që vijnë nga Rusia siç është Evropa, apo nga drithërat siç është Afrika. Krahas humbjes së jetëve njerëzore dhe dramës së të shpërngulurve, kjo luftë po sjell rritje të kostove të jetesës dhe të prodhimit, si edhe rënie të konsumit dhe të investimeve. Me shumë gjasa, këto kosto do të mbeten të larta të paktën gjatë këtij viti, në kushtet kur shumë vende dhe rajone kanë deklaruar objektivat e tyre për uljen e varësisë nga burimet energjetike ruse dhe gjetjen e burimeve të reja. Shkalla e pasigurisë për mënyrën e zhvillimit të kësaj lufte dhe implikimet e saj jo vetëm ekonomike, mbetet e lartë. Në afatin e shkurtër, pritet që ajo të sjellë ngadalësimin e mëtejshëm të rritjes së ekonomisë botërore.

EUROZONA

Ekonomia e Eurozonës u zgjerua me 2.3% gjatë tremujorit të tretë 2021, ndikuar nga forcimi i konsumit privat pas lehtësimit të masave në shumicën e vendeve anëtare gjatë muajve të verës dhe nga efekti pozitiv i politikave mbështetëse financiare e fiskale. Nga ana tjetër, rritja e infektimeve me variantin Omikron, rritja e çmimeve të energjisë dhe intensifikimi i pengesave në zinxhirët e furnizimit, sollën ngadalësim të ritmit të rritjes së rajonit gjatë tremujorit të katërt në nivelin 0.3%. PBB-ja e Eurozonës vlerësohet të jetë rritur me 5.2% gjatë vitit 2021, pas rënies me 6.4% të regjistruar për vitin 2020. Në tregun e punës, zhvillimet kanë qenë pozitive, ndikuar dhe nga skemat e qeverive për ruajtjen e vendeve të punës. Norma e papunësisë në nivel rajoni ka rënë në 7% në fund të vitit 2021. Nga ana tjetër, rikthimi i ekonomisë në kapacitet të plotë, pritet të mbështesë rritjen e nivelit të pagave dhe punësimit. Presionet inflacioniste kanë vijuar të rriten gjatë periudhës dhe norma e inflacionit shënoi rekordin prej 5% në dhjetor. Kjo ecuri ka reflektuar rritjen e çmimeve të energjisë në nivel global, si dhe rritjen e kërkesës së brendshme, ndërkohë që oferta ishte e pamjaftueshme për shkak të vështirësive në zinxhirët globalë të furnizimit. Në këto kushte, politika monetare e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) ka vijuar të mbetet lehtësuese, duke mbështetur sektorin financiar dhe ekonominë me likuiditet, përmes programeve të lehtësimit sasior dhe instrumenteve të tjera jokonvencionale. Kredia bankare ndaj sektorit privat ka vijuar të rritet në mënyrë të qëndrueshme, duke shënuar 4% në fund të vitit, mbështetur nga kushtet e favorshme financiare dhe ecuria ekonomike pozitive. Rezultatet e vrojtimit mbi kredinë bankare në Eurozonë treguan se standardet e kreditimit kanë mbetur përgjithësisht të pandryshuara, ndërkohë që kërkesa për kredi e bizneseve dhe amiljeve raportohet në rritje.

Sipas parashikimeve të muajit shkurt nga BQE[9], ekonomia e Eurozonës pritet të mbetet në trajektoren e një rimëkëmbjeje të qëndrueshme, mbështetur nga forcimi i mëtejshëm i kërkesës së brendshme dhe të jashtme, përmirësimi i kushteve në tregun e punës dhe vijimi i politikave mbështetëse fiskale e monetare. Shpërthimi i konfliktit të armatosur në Ukrainë dhe përfshirja e BE-së me ndihma dhe pritjen e ukrainasve që i largohen luftës, si edhe sanksione të forta ndaj Rusisë, do të kërkojë rivlerësim të këtyre parashikimeve. Situata pritet të ngadalësojë aktivitetin ekonomik përmes rritjes së çmimeve të energjisë, rënies së besimit, tronditjes së tregjeve financiare, dëmtimit të kanaleve tregtare etj., por masa e ndikimit është e vështirë të vlerësohet. BQE-ja dhe institucionet e tjera evropiane janë shprehur të gatshme të ndërmarrin politikat e duhura në mbështetje të stabilitetit ekonomik dhe financiar të rajonit.

Tabelë 1. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)			Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	2021*	T3'21**	T4'21**	Shtat'21	Dhj'21	Shtat'21	Dhj'21	T2'21	T3'21
SHBA	5.9	4.9(0.6)	5.6(1.7)	5.4	7.0	4.7	3.9	125.4	122.5
Eurozonë	5.2	4.0(2.3)	4.6(0.3)	3.4	5.0	7.4	7.0	98.3	97.7
Gjermani	2.7	2.9(1.7)	1.8(-0.3)	4.1	5.7	3.3	3.2	69.7	69.4
Francë	6.7	3.5(3.1)	5.4(0.7)	2.7	3.4	7.7	7.4	114.5	116.0
Italì	6.2	3.9(2.5)	6.2(0.6)	2.9	4.2	9.1	9.0	156.4	155.3
Greqi	:	11.4(2.0)	7.7(0.4)	1.9	4.4	13.2	12.7	207.3	200.7

Burimi: BQE, Eurostat, Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labor Statistics).
** vlerësim i FMN-së (Janar 2022), Zyra e Analizave Ekonomike;*
*** në kllapa janë vendosur shifrat e rritjes tremujore të PBB-së*
": " mungesë informacioni.

BALLKANI PERËNDIMOR

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë vijuar të rimëkëmben në tremujorët e dytë dhe të tretë të vitit 2021 dhe rritja ekonomike sipas tremujorëve përkatës shënoi 14.5% dhe 8.6%. Përtej efektit të bazës krahasuese, që ka ardhur duke u zbehur në fund të vitit, rritja është mbështetur gjerësisht nga forcimi i kërkesës së brendshme dhe të jashtme pas lehtësimit të masave kufizuese dhe rinisjes së aktivitetit në sektorët më të prekur nga pandemia. Në linjë me ecurinë e qëndrueshme ekonomike, zhvillimet në tregun e punës kanë qenë pozitive dhe niveli i papunësisë ra në shumicën e vendeve të rajonit. Në sektorin e jashtëm, presionet ndaj bilancit të llogarisë korrente kanë vijuar të zbuten, mbështetur nga rigjallërimi i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve dhe një rritje e ndjeshme e dërgesave të emigrantëve. Deficiti i llogarisë korrente në nivel rajoni ra në 3.9% të PBB-së në fund të vitit, duke shënuar vlerën më të ulët në 10 vitet e fundit. Rigjallërimi ekonomik solli rritje të të ardhurave buxhetore dhe ngushtim të deficitit fiskal, dhe disa prej vendeve kanë reduktuar borxhin publik ndaj PBB-së. Presionet inflacioniste janë rritur ndjeshëm në muajt e fundit të vitit, nga rritja në nivel global e çmimit të energjisë dhe produkteve ushqimore. Bankat qendrore të rajonit njoftuan publikun për mundësinë e rritjes së normave të interesit, në vijim të rikuperimit ekonomik dhe presioneve inflacioniste.

[9] *Buletini Ekonomik i Bankës Qendrore Evropiane, shkurt 2022.*

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)				Papunësia (në %)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në%)	
	T2'21	T3'21	2021p	2022p	T2'21	T3'21	T3'21	T4'21*	T3'21	T4'21
Bosnje-Hercegovinë	12.1	8.4	:	:	18.1	16.4	2.4	3.2	5.5	:
Maqedoni e Veriut	13.4	3.0	3.7	3.9	15.9	15.7	5.8	7.6	3.5	3.1
Mali i Zi	19.0	25.8	7.1	6.4	17.3	15.0	8.5	7.1	5.6	6.0
Kosovë	16.8	14.5	:	:	:	:	12.1	14.7	2.2	2.2
Serbi	13.7	7.7	5.3	4.3	11.1	10.5	7.9	8.9	3.6	3.6
Shqipëri**	18.4	7.0	4.0	3.7	12.1	11.6	7.4	10.2	6.5	5.6

Burimi: Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse, INSTAT.
Shpjegime: 'p'- parashikimi i ECFIN në nëntor 2021; ':' mungesë informacioni; "" të dhënat të nëntorit 2021; "**"të dhënat të dhjetorit 2021.*

Në sektorin bankar, kredia ndaj sektorit privat ka vijuar të zgjerohet në terma vjetorë, mbështetur nga rikuperimi i aktivitetit ekonomik dhe vijimi i disa masave rregullatore lehtësuese. Në shumicën e vendeve të rajonit, kredia ndaj individëve është rritur më shpejt se ajo ndaj bizneseve. Bilanci i bankave të rajonit ka qenë përgjithësisht në përmirësim. Treguesi i raportit të kredive me probleme ka shënuar rënie në Shqipëri, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnje-Hercegovinë, dhe ka mbetur i pandryshuar në pjesën tjetër të rajonit. Gjithsesi, mendohet që ky tregues nuk ka reflektuar ende plotësisht efektin financiar të pandemisë dhe lehtësive rregullative të ndërmarra nga bankat qendrore gjatë vitit të kaluar.

Rajoni është i ndjeshëm ndaj luftës në Ukrainë dhe sanksioneve ndaj Rusisë. Përveç ndjeshmërisë së përgjithshme ndaj çmimeve të energjisë dhe të produkteve ushqimore, disa prej vendeve kanë varësi më të theksuar jo vetëm në sektorin e energjisë, por edhe të turizmit. Në sistemin financiar, disa prej vendeve u përballën me nevojën dhe vepruan me shpejtësi për të nxjerrë nga tregu bankar investitorët rusë. Për më tepër, implikimet e sulmit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, mund të përcillen në një situatë sigurie më të brishtë për disa prej vendeve të rajonit. Në tërësi, të gjitha vendet kanë vepruar për të forcuar pozitat e tyre të sigurisë, si edhe për të zbutur goditjet ndaj ekonomisë dhe mbrojtur shtresat sociale më të ndjeshme. Edhe për rajonin vlerësohet se presionet inflacioniste do të mbeten të larta, ndërsa rritja ekonomike do të ngadalësohet.

Ritmi i rritjes ekonomike mbeti i lartë gjatë periudhës, pavarësisht ngadalësimit të tij. Rritja ekonomike është mbështetur nga shumë faktorë dhe ishte me bazë të gjerë. Ajo është shoqëruar me ulje të nivelit të papunësisë dhe rritje të presioneve inflacioniste, që u ashpërsuan pas nisjes së konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe vendosjes së sanksioneve ndaj Rusisë.

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, ka ardhur reagimi i politikave fiskale e monetare. Sfida e problematikës me të cilën po ndeshet ekonomia, kërkon koordinimin e politikave ekonomike në afatin më të shkurtër, dhe ndërmarrjen e reformave strukturore në një afat më të gjatë.

2.2 MJEDISI MAKROEKONOMIK NË VEND

Ritmi i rritjes ekonomike mbeti i lartë gjatë periudhës, pavarësisht ngadalësimit të tij. Rimëkëmbja ekonomike është mbështetur nga një gamë e gjerë faktorësh. Mungesa e zbatimit të masave të forta kufizuese të lidhura me pandeminë e COVID-19, përmirësimi i mjedisit ekonomik, rritja e besimit të agjentëve, politikat stimuluese monetare e fiskale dhe ruajtja e qëndrueshmërisë makroekonomike, i kanë hapur rrugë rritjes së shpejtë të konsumit, investimeve dhe eksporteve shqiptare. Rritja ekonomike është shoqëruar me rënie të normës së papunësisë, rritje të pagave dhe rritje të presioneve inflacioniste. Këto zhvillime bënë që rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit të kapërcejë, pas shumë vitesh,

nivelin objektiv të Bankës së Shqipërisë. Rritja e çmimeve u ashpërsua pas nisjes së luftës në Ukrainë dhe vendosjes së sanksioneve ndaj Rusisë.

SEKTORI REAL

Pas rritjes me 4.3% në tremujorin e parë të vitit, rimëkëmbja e ekonomisë shqiptare u përshpejtua ndjeshëm në tremujorin e dytë, gjatë të cilit PBB-ja u rrit me 17.7% në terma vjetorë. Pas rritjes në tremujorin e tretë prej 7%, gjatë tremujorit të katërt, rritja vijoi të ishte pozitive por ritmi i rritjes vjetore u ngadalësua në 5.5%. Të gjitha kategoritë e shpenzimeve vijuan rritjen gjatë periudhës, duke tejkaluar efektin e bazës së ulët krahasuese të lidhur me zhvillimet jo të zakonshme të vitit 2020. Rritja e konsumit të familjeve dhe e investimeve ishte më e lartë kundrejt tremujorit paraardhës dhe të njëjtës periudhë të një viti më parë. Konsumi i qeverisë ka vijuar të rritet edhe gjatë tremujorit të katërt, duke ruajtur ritmet e larta të gjysmës së parë të vitit. Rritja vjetore e lartë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve u shoqërua me rigjallërimin e importeve.

Të dhënat e prodhimit sipas sektorëve tregojnë që rritja ka prekur sektorët kryesorë, si: ndërtimin (+16%), tregtinë, transportin dhe akomodimin (+6%). Edhe aktivitetet e shërbimeve e zgjeruan veprimtarinë përgjatë vitit, ku veçohen ato të pasurive të paluajtshme (+12%), të komunikacionit (+6%) dhe shërbimet financiare dhe të sigurimit (+2%). Treguesi i ndjesisë ekonomike i vlerësuar për fundin e vitit, ishte më i lartë në krahasim me fundin e tremujorit të mëparshëm, por rritja u ngadalësua në krahasim me tremujorët paraardhës të vitit. Në fund të vitit 2021, ky tregues qëndronte mbi mesataren historike dhe pasqyronte përmirësimin e besimit të konsumatorit dhe të sektorëve të industrisë, shërbimeve dhe tregtisë. Konflikti ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet ndaj Rusisë, pritet të ndikojnë negativisht në aktivitetin e sektorit real të ekonomisë përmes kërkesës më të ulët konsumatore, kostove më të larta të prodhimit dhe investimeve potencialisht më të ulëta.

Grafik 7. Rritja vjetore e PBB-së



Burimi: INSTAT.

Grafik 8. Norma e papunësisë



Burimi: INSTAT.

TREGU I PUNËS

Tregu i punës dha sinjale rimëkëmbjeje në gjysmën e dytë të vitit 2021, pas një përkeqësimi në tremujorin e parë. Punësimi shënoi një rritje prej 2.7% në terma vjetorë duke bërë që shkalla e papunësisë të bjerë nga 11.9% në tremujorin e parë, në 11.4% në tremujorin e fundit të vitit. Papunësia te të rinjtë (15-29 vjeç) u ul në 20.6% ose me 1.1 p.p. ndaj nivelit të T4-2020, duke regjistruar edhe vlerën më të ulët që nga viti 2017. Rritja e punësimit gjatë periudhës në sektorin e industrisë (7.5%) dhe në sektorin e shërbimeve (7.2%), mbështeti rimëkëmbjen e tregut të punës. Rritja e pagave[10] vazhdoi të përshpejtohej në 8.4% në terma vjetorë në tremujorin e katërt, me kontribut të përbashkët nga sektori privat (8.2%) dhe sektori publik (4.1%). Brenda sektorit privat, pagat u rritën për të gjithë sektorët, por shërbimet shënuan rritjen më të lartë. Ndërsa, rritja e pagave në sektorin publik është kryesisht rezultat i rritjes më të lartë të pagave për punonjësit e shëndetësisë dhe mësuesit. Përmirësimi i konstatuar në tregun e punës, pritet të ngadalësohet në varësi të shkallës së ndjeshmërisë së sektorit real ndaj ndikimit prej zhvillimeve gjeopolitike dhe ndikimit të tyre në tregjet ndërkombëtare.

SEKTORI I JASHTËM

Kontributi i sektorit të jashtëm të ekonomisë ishte negativ gjatë periudhës, në sajë të zgjerimit të ndjeshëm të deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave. Deficiti korrent arriti në 7.6% të PBB-së[11], dhe shënoi nivelin 546 milionë euro ose 56% më shumë nga niveli i një viti më parë. Përkeqësimi i tij në terma vjetorë, u diktua nga thellimi i deficitit tregtar në mallra dhe ngushtimi i balancës pozitive të të ardhurave dytësore. Rimëkëmbja e eksporteve të shërbimeve, kryesisht atyre të udhëtimit gjatë sezonit veror, i dha fund tkurrjes së tyre njëvjeçare dhe, së bashku me rimëkëmbjen e transaksioneve të transportit, mundësoi zbutjen e deficitit të llogarisë korrente. Rritja në eksporte u mbështet edhe nga çmimet e larta ndërkombëtare të lëndëve djegëse dhe metaleve bazë. Nga ana tjetër, deficiti tregtar në mallra u thellua me rreth 39% në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 1,224 milionë euro. Ky zhvillim u diktua nga rritja e importeve të lëndëve djegëse si "energji dhe naftë" dhe shpenzimeve të larta në importet e grupmallrave "makineri e pajisje" e "mjete transporti", diktuar nga zhvillimet në sektorin e ndërtimit. Prurjet valutore në formën e dërgesave të emigrantëve vlerësohen në rreth 222 milionë euro, me një rritje vjetore prej 9%, ndërsa fluksi i investimeve të huaja direkte vlerësohet në 302 milionë euro, me një rritje vjetore prej 22%. Në fund të periudhës, mjetet e rezervës valutore ishin të mjaftueshme për mbulimin e 8.8 muaj importesh në mallra dhe shërbime.

---

10 *I referohet pagës mesatare mujore bruto.*

11 *Ky tregues llogaritet si raport midis balancës kumulative të llogarisë korrente të katër tremujorëve të fundit kundrejt PBB-së kumulative gjatë së njëjtës periudhë.*

Grafik 9. Llogaria korrente dhe investimet e huaja direkte



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik 10. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit



Burimi: INSTAT.

HAPËSIRË INFORMUESE 1. DISA TREGUES PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË AGRESIONIT USHTARAK NË UKRAINË DHE TË SANKSIONEVE NDAJ RUSISË, NË AKTIVITETIN TREGTAR TË SHQIPËRISË

Ndikimi që ekonomia do të ketë prej konfliktit ushtarak në Ukrainë, duhet vlerësuar në elementet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Në fund të vitit 2021, aktiviteti tregtar i Shqipërisë me këto dy vende (importe dhe eksporte, në mallra dhe shërbime), vlerësohet në rreth 1.5% të vlerës totale të importeve dhe të eksporteve. Vetëm për mallrat, raporti i importeve dhe eksporteve nga këto dy vende me totalin e importeve dhe eksporteve, është rreth 2.5%. Për shërbimet, raporti është në vlerën 0.2%. Në tërësi, aktiviteti tregtar me këto dy vende është i vogël.*

Ekspozimi i drejtpërdrejtë i ekonomisë shqiptare ndaj Rusisë dhe Ukrainës, në formën e eksporteve në këto dy vende, është pothuaj i pandjeshëm. Shqipëria eksporton kryesisht produkte bujqësore, minerale dhe shërbime turizmi në këto vende dhe ka ekspozime minimale financiare. Duke iu referuar eksporteve të mallrave, ato shkojnë kryesisht drejt Ukrainës, por vlerat e ekspozimit të Shqipërisë ndaj të dy vendeve janë të papërfillshme. Për eksportet e shërbimeve, edhe duke konsideruar vlerat e vitit 2019 si viti më i mirë (për eksportet e shërbimeve të turizmit), vlerat mes të dy vendeve janë më të balancuara por vlerësohet se nuk kapërcejnë 1% të vlerës totale të eksporteve të shërbimeve, apo 2% të vlerës së eksporteve të shërbimeve të udhëtimit. Pra, vlerat potencialisht të humbura për shkak të konfliktit nuk janë të rëndësishme dhe tërheqja e këtyre vëllimeve nga tregje të tjera është e mundshme.

Ndikimi i tërthortë për Shqipërinë, në kuadër të importeve nga këto dy vende, është më i dukshëm, por përsëri nuk është kritik. Më konkretisht, importet e mallrave nga Rusia dhe Ukraina, në fund të vitit 2021, zinin rreth 3% të vlerës totale të importeve të mallrave. Vlera e importeve nga Rusia është rreth 4 herë më e lartë sesa ajo e importeve nga Ukraina, dhe sipas rëndësisë është e përqendruar tek drithërat dhe produktet vegjetale, lëndët djegëse minerare (karburantet), metalet bazë dhe produktet e industrisë kimike (fertilizuesit). Si peshë specifike, importet e lëndëve djegëse dhe minerare, dhe importet e drithërave dhe produkteve vegjetale, zinin respektivisht rreth 4.1% dhe 41% të totalit të këtyre importeve të

vendit tonë gjatë vitit 2021. Importet e këtyre grupmallrave nga Ukraina janë të parëndësishme. Nga Ukraina importohen kryesisht metale bazë, yndyrna, e më pak drithëra dhe produkte vegjetale.

Duke konsideruar peshat specifike të zërave kryesorë të importeve nga këto dy vende, vlerësohet që ndikimi mbi vendin tonë në sferën e çmimeve dhe të ofertës, është i lidhur kryesisht me koniunkturën (lëvizjet e çmimit) e tregjeve ndërkombëtare kur është fjala për lëndët djegëse e minerare (karburantet). Ndërsa kur bëhet fjalë për drithërat dhe produktet vegjetale, apo për metalet bazë, ndikimi prej agresionit ushtarak në Ukrainë dhe sanksioneve ndaj Rusisë është edhe më i drejtpërdrejtë.

* *Të dhënat për tregtinë e shërbimeve sipas shteteve i përkasin fundit të vitit 2020, duke qenë se këto statistika publikohen më vonë sesa statistikat e përgjithshme të bilancit të pagesave.*

ZHVILLIMET MONETARE

Në dhjetor të vitit 2021, Banka e Shqipërisë rikonfirmoi qëndrimin e saj për një politikë monetare stimuluese duke mbajtur normën bazë të interesit të pandryshuar, në nivelin më të ulët historik prej 0.5%. Inflacioni në vend shënoi një rritje të shpejtë, duke kapur vlerën 3.7% në muajin dhjetor. Prirja rritëse e inflacionit gjatë periudhës u diktua nga rritja e kërkesës, rritja e punësimit dhe rritja e pagave. Në tremujorin e fundit të vitit, ecuria e inflacionit pasqyron kryesisht efektin e rritjes së ndjeshme të çmimeve të ushqimeve, të naftës dhe të energjisë në tregjet botërore. Pasojat e kësaj goditjeje nga ana e ofertës pritet ta mbajnë inflacionin mbi objektiv gjatë periudhës në vijim. Mbiçmimi i monedhës vendase ndaj euros ka vijuar edhe në tremujorin e katërt, gjatë të cilit leku u forcua me 2.4% në terma vjetorë dhe 0.6% në terma tremujorë. Në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, Banka e Shqipërisë, ka vijuar të ndërhyjë në tregun e parasë nëpërmjet ankandeve të injektimit javor pa limit, duke synuar ruajtjen e një situate likuiditeti sa më të përshtatshme për bankat e nivelit të dytë. Ndikimi i luftës në Ukrainë dhe i sanksioneve ndaj Rusisë, kanë ashpërsuar presionet inflacioniste dhe kanë diktuar një rishikim të projeksioneve për ecurinë e inflacionit në vend. Sipas projeksioneve më të fundit, norma e inflacionit do të jetë mbi nivelin objektiv të Bankës së Shqipërisë gjatë gjithë vitit 2022, duke kërkuar një politikë monetare disi më të shtrënguar. Në vijim të këtij vlerësimi, më 23 mars 2022, Banka e Shqipërisë rriti normën bazë të interesit me 0.5 pikë përqindjeje, në nivelin 1%. Edhe në nivelin e ri, kushtet monetare vlerësohen gjerësisht akomoduese.

ZHVILLIMET FISKALE

Politika fiskale mbeti lehtësuese edhe përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, duke ruajtur të njëjtën qasje si në vitin paraardhës. Në dhjetor 2021, deficiti fiskal arriti në rreth 90 miliardë lekë, ose 25 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ngushtimi i deficitit erdhi për shkak të vazhdimit të rikuperimit të fortë vjetor të të ardhurave (20%) kryesisht për shkak

të efektit bazë, por edhe falë performancës së mirë në të gjitha kategoritë e të ardhurave. Shpenzimet u rritën me 11% në terma vjetorë, kryesisht për investime dhe rindërtim pas tërmetit, por edhe për sigurimet shëndetësore dhe sociale. Shpërndarja më e drejtë e shpenzimeve të planifikuara, veçanërisht e atyre për investime, përgjatë vitit mbetet një nevojë e administrimit fiskal. Deficiti buxhetor është financuar më shumë nga huamarrja e huaj sesa ajo e brendshme.

Lufta në Ukrainë dhe vendosja e sanksioneve ndaj Rusisë janë shoqëruar me rritjen e presioneve inflacioniste dhe të kostove të prodhimit në ekonomi, kryesisht për shkak të rritjes së kostove të energjisë, të ushqimeve dhe të metaleve. Këto zhvillime pritet të japin një ndikim negativ në kërkesën konsumatore dhe investimet private. Në të njëjtën kohë, situata hidrike në hidrocentrale, ka diktuar uljen e ndjeshme të prodhimit të energjisë elektrike brenda vendit dhe rritjen e vëllimit të importeve të saj me çmime të jashtëzakonshme, sipas bursave ndërkombëtare. Në këto kushte, politika fiskale ka riorientuar një pjesë të të ardhurave dhe të shpenzimeve drejt nevojave më prioritare, duke përfshirë edhe ndihmën për përballimin e goditjes ndaj shtresave më të dobëta të shoqërisë. Zhvillimet ndërkombëtare dhe plotësimi i nevojave të energjisë, me shumë gjasa do të mbeten sfida të forta për ecurinë e ekonomisë në vend përgjatë gjithë vitit. Përballimi i tyre do të evidentojë edhe më shumë rëndësinë e miradministrimit fiskal dhe të koordinimit të politikave ekonomike e financiare në afat më të shkurtër, si edhe nevojën për reforma më të thella në fushën e alternativave të sigurisë energjetike dhe ushqimore, në afat më të gjatë.

Grafik 11. Ecuria e deficitit buxhetor në terma të PBB-së

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik 12. Ecuria e kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3 POZICIONI FINANCIAR I EKONOMISË, INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

Ekonomia shqiptare ka një pozicion huamarrës (debitor) neto, ndaj pjesës tjetër të botës. Kontributin kryesor në këtë pozicion e japin sektorët e biznesit dhe të Qeverisë së Përgjithshme. Sektori i individëve ka një pozicion neto kreditor, ndërsa institucionet financiare kanë një pozicion neto të balancuar.

Gjatë periudhës, rritja më e fortë e depozitave në krahasim me kredinë, ka bërë që pozicioni kreditor i individëve të zgjerohet dhe ai debitor i bizneseve të tkurret.

Individët kanë një strukturë të balancuar të depozitave dhe kredive midis lekut dhe valutës. Për sektorin e biznesit, preferenca për valutën duket më e qartë.

Ekonomia vendase paraqitet si një ekonomi huamarrëse neto ndaj pjesës tjetër të botës, pasi detyrimet e saj financiare janë më të mëdha sesa mjetet financiare. Pozicioni neto i ekonomisë përcaktohet nga: a) pozicioni neto pozitiv i sektorit të individëve (i ekonomive familjare); b) pozicionet neto negative të sektorit të bizneseve (të korporatave jofinanciare) dhe atij të Qeverisë së Përgjithshme; dhe c) pozicioni i balancuar mes mjeteve dhe detyrimeve të sektorit të korporatave financiare (institucionet financiare).

Sektori i individëve është sektori më i madh huadhënës, ndërsa sektori i bizneseve është sektori më i madh huamarrës në ekonominë shqiptare. Mjetet financiare të individëve dhe bizneseve janë përkatësisht sa 33% dhe 21% e mjeteve të përgjithshme të ekonomisë, që në fund të vitit 2020 shënonin 6,500 miliardë lekë. Në anën e detyrimeve, bizneset kanë rreth 45% të totalit të detyrimeve financiare të ekonomisë, që në fund të vitit 2020 shënonin 7,400 miliardë lekë, ndërsa pesha e detyrimeve të individëve ishte pothuajse e papërfillshme.

Gjatë periudhës, sektori i individëve ka vijuar të zgjerojë pozicionin e tij si sektor huadhënës neto, ndërkohë që pozicioni debitor i sektorit të bizneseve ka shënuar një ngushtim të lehtë. Për të dy sektorët, kjo ecuri është përcaktuar nga rritja më e fortë e depozitave në krahasim me rritjen e kredisë.

Grafik 13. Depozitat dhe kredia e bizneseve (b.m.) dhe stoku i investimeve të huaja direkte (b.d.)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Depozitat dhe kredia e individëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhës, vërehet që individët kanë një strukturë të balancuar të depozitave dhe kredive midis lekut dhe valutës. Për sektorin e biznesit, preferenca për valutën duket më e qartë edhe në kushtet kur bizneset kanë vijuar të tërheqin financim nga pjesa tjetër e botës në formën e investimeve të huaja direkte. Rritja në stokun e investimeve direkte gjatë 9-mujorit të parë të

vitit 2021 ishte më e lartë në krahasim me rritjen e investimeve gjatë së njëjtës periudhë të dy viteve paraardhëse.

2.3.1 GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E INDIVIDËVE

POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE

Sektori i individëve është një sektor huadhënës neto me investime të përqendruara në kapitalin e bizneseve dhe në depozita të mbajtura në sektorin bankar vendas. Nga ana tjetër, ky sektor ka një ekspozim si huamarrës mjaft të kufizuar në krahasim me mjetet e veta financiare, dhe ekspozimi është në formën e kredisë nga institucionet financiare rezidente. Mjetet financiare të individëve, që në fund të vitit 2020 shënonin 2,100 miliardë lekë, janë rreth 9 herë më të mëdha sesa detyrimet e tyre financiare prej 250 miliardë lekësh. Gjatë viteve 2017-2020, pozicioni neto i sektorit të individëve është zgjeruar në mënyrë të ndjeshme dhe ky zgjerim është përcaktuar kryesisht nga rritja e mjeteve (pretendimeve) në formën e depozitave dhe të pjesëmarrjeve në kapitalin e bizneseve. Më shumë se gjysma e mjeteve financiare të individëve (rreth 55%) përfaqësohet nga depozitat në banka, ndërsa 35% e mjeteve mbahet në formën e kapitalit në biznese dhe si aksione të individëve në fondet e investimit. Investimet në letra me vlerë të borxhit dhe llogari të tjera të arkëtueshme janë sa 4% dhe 6% e mjeteve financiare të individëve, ndërsa zërat "Hua" dhe "Sigurime dhe skemat e pensioneve" kanë një peshë të papërfillshme. Detyrimet e individëve përfaqësohen pothuajse plotësisht nga kreditë nga institucionet financiare rezidente, dhe ritmi i rritjes së tyre ka qenë më i ngadaltë në krahasim me rritjen e pretendimeve.

Si kundërparti, sektori me detyrimet më të mëdha ndaj individëve është sektori i korporatave financiare. Këto detyrime në fund të vitit 2020 ishin rreth 1,300 miliardë lekë dhe përfaqësonin 55% të të gjitha detyrimeve të korporatave financiare. Këto detyrime kanë formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave me dhe pa afat, në lekë dhe në valutë. Sektori i dytë për nga madhësia e detyrimeve ndaj sektorit të individëve është sektori i bizneseve. Në fund të vitit 2020, detyrimet e bizneseve ndaj individëve ishin 700 miliardë lekë ose sa 20% e totalit të detyrimeve të bizneseve. Detyrimi i qeverisë së përgjithshme në formën e huamarrjes nga individët në formën e letrave me vlerë të borxhit, shënonte rreth 80 miliardë lekë në fund të vitit 2020, dhe ky zë është tkurrur me 20 miliardë lekë gjatë dy viteve të fundit. Në raport me investimet e përgjithshme të ekonomisë vendase në letra me vlerë të borxhit[12], sektori i individëve zotëron rreth 7% të totalit. Në vitin 2017, individët zotëronin rreth 16% të stokut të letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria e përgjithshme, ndërkohë që në fund të vitit 2020, ky raport ra në 11%.

[12] *Këtu përfshihen letra me vlerë të emetuara nga subjekte rezidente dhe jorezidente.*

Grafik 15. Pozicioni neto i individëve sipas instrumenteve



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 16. Mjetet dhe detyrimet e individëve sipas sektorëve kundërparti (viti 2020)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë vitit 2021, sektori i individëve e ka zgjeruar edhe më tej pozicionin e tij si kreditor neto, duke qenë se depozitat dhe kreditë me bankat rezidente, që përfaqësojnë pjesën dërrmuese të mjeteve dhe detyrimeve financiare të individëve u shtuan me përkatësisht 90 dhe 25 miliardë lekë, ndërsa shtesat përkatëse gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit ishin 50 dhe 10 miliardë lekë.

HUAMARRJA E INDIVIDËVE DHE AFTËSIA PAGUESE

Pesha e familjeve që kanë një hua për të paguar ndaj numrit të familjeve të pyetura nuk shënoi ndryshime të rëndësishme gjatë vitit 2021. Aftësia paguese e familjeve gjatë periudhës ka shënuar rënie.

Kërkesa e individëve për kredi pritet të gjallërohet disi gjatë pjesës së parë të vitit 2022, nëse situata ekonomike nuk ndikohet së tepërmi nga pasojat e konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet ndaj Rusisë.

Për të vlerësuar gjendjen financiare, përdorimin dhe ngarkesën me borxh të individëve kryhet një vrojtim periodik[13]. Rreth 24% e familjeve që i janë përgjigjur pyetësorit, kanë deklaruar se kanë të paktën një hua për të paguar në momentin e intervistimit. Kjo peshë është rritur lehtë ndaj gjashtëmujorit të kaluar, duke mbetur në të njëjtin nivel të një viti më parë dhe nën mesataren historike të treguesit. Rreth 69% e familjeve deklarojnë se pagesa e huasë zë më pak se 30% të të ardhurave mujore[14]. Ky tregues ka rënë me 6 pikë përqindje në krahasim me vrojtimin e kaluar. Rreth 50% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese 'nuk ka ndryshuar' gjatë periudhës, ndërsa pjesa tjetër raportojnë në agregat një rënie të aftësisë së tyre paguese. Kjo ecuri është pasqyruar dhe në përkeqësimin e pritjeve të familjeve lidhur me aftësinë e tyre paguese në të ardhmen. Kështu, rreth 70% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese për gjysmën e parë të vitit 2022, ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar –20 pikë përqindjeje, duke sugjeruar për pritje pesimiste krahasuar me rezultatet e gjashtëmujorit të kaluar dhe të një viti më parë.

[13] *Kampioni prej 1,210 familjesh përzgjidhet, intervistohet dhe rishikohet në mënyrë periodike nga Instituti i Statistikave, në bazë të regjistrave që përdoren nga agjencia për anketat pranë familjeve. Shkalla e përgjigjes në vrojtimin e kryer në fund të vitit 2021 ishte 88%. Vrojtimi është kryer përpara goditjes ekonomike të lidhur me konfliktin ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet ndaj Rusisë.*

[14] *Deri në 10% të të ardhurave për 29% të familjeve huamarrëse, 10-30% të të ardhurave për 40% të familjeve.*

Grafik 17. Indekset e aftësisë paguese për 6 muajt e kaluar dhe 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Indeksi i planifikimit të huamarrjes dhe shpërndarja e familjeve që planifikojnë hua të re



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreth 55% e të përgjigjurve kanë deklaruar se 'nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm', ndërsa rreth 45% e tyre deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie[15] mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re. Kjo peshë është rritur 4.2 pikë përqindjeje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 1.3 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Si rezultat, indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re[16] ka rezultuar 0.20, duke shënuar rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë. Kjo mund të sinjalizojë një rigjallërim të kërkesës së individëve për kredi në gjysmën e parë të vitit 2022. Nga përgjigjet e grupit të familjeve që planifikojnë të marrin një hua të re, rezulton se rreth 60% e tyre janë 'huamarrës të rinj', pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit dhe kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtë muaj më parë.

2.3.2 GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E BIZNESEVE

POZICIONI FINANCIAR I BIZNESEVE

Sektori i bizneseve paraqitet si huamarrësi neto më i madh në ekonomi. Mjetet dhe detyrimet e këtij sektori në fund të vitit 2020 arritën në përkatësisht 1,300 dhe 3,300 miliardë lekë, ndërkohë që gjatë viteve 2014-2020, pozicioni debitor i bizneseve është zgjeruar me rreth 420 miliardë lekë, kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve ndaj sektorit jorezident. Në fakt, rreth 1/3 e të gjitha detyrimeve financiare të bizneseve janë detyrime ndaj sektorit jorezident (rreth 1,100 miliardë lekë) dhe kanë formën e investimeve të huaja direkte

[15] *Alternativat e dhëna janë: 'ka pak mundësi', 'ka shumë mundësi' dhe 'është e sigurt'.*

[16] *Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e % së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientet përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 opsione: 0('nuk ka asnjë mundësi'), 0.33 ('ka pak mundësi'), 0.66 ('ka shumë mundësi') dhe 1 ('është e sigurt'). Indeksi i përfituar merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.*

në formën e kapitalit, ndërsa sektori i dytë më i rëndësishëm në financimin e bizneseve është sektori i individëve (me rreth 700 miliardë lekë). Detyrimi i sektorit të bizneseve ndaj sektorit të individëve ose familjeve ka formën e kapitalit të investuar nga familjet në ndërmarrjet e sektorit privat. Ekspozimi i bizneseve ndaj qeverisë së përgjithshme nuk është shumë i madh në terma të madhësisë dhe në raport me totalin e detyrimeve të bizneseve, por është i rëndësishëm në raport me mjetet e sektorit të qeverisë së përgjithshme. Ky ekspozim ka formën e kapitalit të zotëruar nga qeveria në korporatat publike jofinanciare, si edhe të llogarive të tjera të arkëtueshme për qeverinë/të pagueshme për sektorin privat. Në fund të vitit 2020, detyrimet e bizneseve ndaj qeverisë shënonin vlerën 500 miliardë lekë. Pretendimet e bizneseve ndaj qeverisë kanë kryesisht formën e llogarive të pagueshme nga qeveria dhe të arkëtueshme për bizneset.

Grafik 19. Mjetet dhe detyrimet e bizneseve sipas instrumenteve për vitet 2013-2020 (majtas) dhe sipas sektorëve kundërparti për vitin 2020 (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i bizneseve ndaj korporatave financiare është relativisht i kufizuar si në anën e mjeteve, ashtu edhe në atë të detyrimeve, por pozicioni i përgjithshëm ka vlerë negative pasi detyrimet në formën e kredisë janë më të mëdha sesa mjetet në formën e depozitave. Në anën e detyrimeve, pjesën më të madhe e zënë huatë e dhëna nga bankat dhe institucione të tjera financiare rezidente, dhe në fund të vitit 2020 këto detyrime shënonin 400 miliardë lekë, duke qenë sa 12% të detyrimeve të përgjithshme të bizneseve. Pretendimet e bizneseve ndaj korporatave financiare kanë kryesisht formën e depozitave dhe në fund të vitit 2020, këto pretendime kishin vlerën 340 miliardë lekë.

Në terma të instrumenteve financiare, pjesa më e madhe e mjeteve të bizneseve (rreth 60%) përfaqësohet nga llogari të arkëtueshme ose kredi tregtare dhe pretendime të tjera ndaj sektorëve të lidhur. Rreth 20% e mjeteve të bizneseve mbahen në formën e depozitave bankare të përfaqësuara kryesisht nga llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në valutë. Detyrimet kryesore të bizneseve vijnë nga pjesëmarrja në kapital e sektorëve të tjerë, huatë e marra nga institucionet financiare dhe llogari të tjera të pagueshme. Zërat 'Kapitali dhe aksionet në fonde investimi' dhe 'Hua' përfaqësojnë pjesën dërrmuese të detyrimeve neto të sektorit.

Nga ana e pretendimeve ose mjeteve financiare, sektori i bizneseve i ka përqendruar burimet e veta në financimin e vetë sektorit të bizneseve me kredi tregtare midis ndërmarrjeve, në sektorin e korporatave financiare (depozita) dhe në sektorin e qeverisë së përgjithshme (letra me vlerë të borxhit dhe llogari të tjera të arkëtueshme). Gjatë 9 muajve të parë të vitit 2021, sektori i bizneseve ka ngushtuar disi pozicionin si huamarrës ndaj sektorit të korporatave financiare, duke qenë se depozitat e bizneseve janë rritur më shumë sesa kredia për këtë sektor. Në të njëjtën kohë, stoku i investimeve të huaja direkte që dominohet nga investimet e jorezidentëve në sektorin e bizneseve, gjatë 9 muajve të parë të vitit është zgjeruar me rreth 40 milionë euro, dhe kjo rritje ka qenë më e madhe sesa rritja e regjistruar gjatë 9-mujorit të parë të 2 viteve paraardhëse.

HUAMARRJA TEK BIZNESET DHE AFTËSIA PAGUESE

Për të vlerësuar gjendjen financiare, përdorimin dhe ngarkesën e borxhit tek ndërmarrjet, përdoret një vrojtim i posaçëm[17] periodik, i kryer me ndihmën e Institutit të Statistikave. Rreth 82% e totalit morën pjesë në mënyrë aktive në vrojtim duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Gjatë periudhës, ndërmarrjet e vrojtuara vlerësuan elementet e "konkurrencës" dhe të "gjetjes së tregut" si problematikat kryesore në ushtrimin e aktivitetit të tyre, por këto ishin në rënie në krahasim me vrojtimin e kaluar. Elemente që kanë marrë rëndësi për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe janë "kostoja e prodhimit dhe e punës" dhe "përshtatshmëria e legjislacionit në fuqi", ndërkohë që edhe "disponueshmëria e stafit të kualifikuar" është evidentuar si një sfidë e rëndësishme nga ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha. Indeksi i shitjeve është ngjitur në nivelin më të lartë të vitit të fundit, por nuk ka arritur ende nivelin e periudhës para pandemisë. Në rang sektorial, indeksi shënoi rritje për bizneset në sektorët e industrisë, të shërbimeve dhe të tregtisë. Ndërmarrjet e të gjitha madhësive raportojnë një rritje të rezultatit financiar. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme raportojnë rritje të rezultatit financiar, pas tre gjashtëmujorësh me rënie. Ndërmarrjet e mëdha vijojnë të deklarojnë një balancë pozitive të rezultatit financiar, me një rritje të theksuar për periudhën. Pritshmëritë mbeten optimiste. Gjatë periudhës, rreth 60% e ndërmarrjeve kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre vetëm nëpërmjet shitjeve, dhe ky raport është rritur për të gjitha grupet e ndërmarrjeve sipas madhësisë.

Për shumicën e bizneseve, ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar është përmirësuar në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021. Vlerësimi i ndërmarrjeve për rritjen e investimeve dhe zgjerimin e veprimtarisë vijon të sinjalizojë zhvillime pozitive. Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka ndryshuar pak gjatë vitit. Ngarkesa me borxh ka ardhur në rënie në raport me kapitalin, por duket disi më e lartë në raport me të ardhurat e bizneseve.

Pritjet për huamarrje të bizneseve në periudhën e ardhshme, duken disi më të larta. Vrojtimi për aplikimet për hua tregon një numër të përgjithshëm më të ulët se një vit më parë, por norma e refuzimit ka mbetur e njëjtë.

Rreth 42% e totalit të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Ky raport ka ndryshuar pak gjatë vitit, duke u rritur me 2 dhe 1 pikë përqindje në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Rreth 78% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 83% e ndërmarrjeve të mesme dhe 82% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Huamarrja e ndërmarrjeve është realizuar vetëm në monedhën vendase për 67% të ndërmarrjeve të vogla,

[17] *Kampioni prej 1,366 biznesesh përfaqëson subjekte të madhësive të ndryshme të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Kampioni përzgjidhet, intervistohet dhe rishikohet në mënyrë periodike nga Instituti i Statistikave, në bazë të regjistrave që përdoren nga agjencia për anketat pranë ndërmarrjeve.*

58% të ndërmarrjeve të mesme dhe 48% të ndërmarrjeve të mëdha, ndërsa pjesa tjetër është në valutë dhe/ose e kombinuar.

Vlera totale e huasë rezulton sa rreth gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për rreth 77% të ndërmarrjeve dhe pothuajse e njëjtë me vlerën e kapitalit për 12% të tyre, ndërkohë që 11% e tyre raportojnë se vlera e huasë e tejkalon atë të kapitalit. Raporti "hua/kapital" është më i lartë për ndërmarrjet e mesme e të mëdha, pasi rreth 25% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit. Gjatë periudhës, ky raport është rritur vetëm për ndërmarrjet e mëdha. Ngarkesa me borxh ka ardhur në rënie dhe paraqitet më e lartë tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të ndërtimit.

Tabelë 3. Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve

Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve				
	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MI 2020	16.4%	22.9%	19.7%	22.2%
6MII 2020	19.7%	25.0%	17.6%	21.9%
6MI 2021	22.3%	26.5%	29.9%	27.0%
6MII 2021	22.7%	24.7%	24.4%	22.1%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (70%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të tyre. Pesha e këtyre ndërmarrjeve ka rënë me rreth 7 pikë përqindjeje ndaj periudhës paraardhëse. Të pyetura nëse kostoja e shërbimit të huasë ka ndryshuar gjatë periudhës, mbi 90% e ndërmarrjeve pohojnë që ky shpenzim ka mbetur i pandryshuar.

Grafik 20. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 21. Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, përgjigjet e ndërmarrjeve sugjerojnë se kërkesa për kredi pritet të forcohet. Rreth 45% e ndërmarrjeve deklarojnë se "nuk ka asnjë mundësi" që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme. Kjo peshë ka shënuar rënie për të gjitha

madhësitë e ndërmarrjeve në krahasim me periudhën paraardhëse. Nga ana tjetër, vërehet një rritje e peshës së ndërmarrjeve që pohojnë se "ka pak mundësi" ose "ka shumë mundësi" të marrin një kredi në gjysmën e parë të vitit 2022. Indeksi i vlerësimit të planifikimit të huamarrjes për gjashtëmujorin e ardhshëm është rritur lehtë për shkak të rritjes së indeksit të ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mëdha.

HAPËSIRË INFORMUESE 2. ECURIA E NUMRIT TË APLIKIMEVE PËR KREDI DHE NORMA E REFUZIMIT NGA BANKAT NË VEND, 6MII-2021

Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2021, bankat kanë raportuar se kanë marrë në shqyrtim gjithsej 67,126 aplikime për kredi, nga të cilat 7% i përkasin sektorit të 'ndërmarrjeve' (2,749 aplikime nga 'ndërmarrje të vogla dhe të mesme' dhe 1825 aplikime nga 'ndërmarrje të tjera'), dhe 93% i përkasin sektorit të 'individëve' (62,552 aplikime). Krahasuar me një vit më parë, kjo strukturë ka shënuar një zhvendosje të lehtë në favor të klientëve 'individë'.

Grafik 22. Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Numri total i aplikimeve për kredi të shqyrtuara nga bankat ka shënuar një rritje shumë të lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por ka rënë me rreth 21% krahasuar me një vit më parë. Rënia në terma vjetorë ka ardhur nga segmenti i 'ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme' dhe 'individët', ndërkohë që numri i aplikimeve të shqyrtuara nga kategoria 'ndërmarrje të tjera' ku mbizotërojnë ndërmarrjet e mëdha, ka rezultuar në rritje. Në totalin e aplikimeve të marra në shqyrtim gjatë periudhës, rezulton se rreth 18.5% e tyre janë refuzuar nga bankat. Kjo normë ka shënuar rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 2.4 p.p.), por rënie të lehtë krahasuar me një vit më parë dhe kjo rënie vërehet në të gjitha ndarjet sipas llojit të klientelës.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, norma totale e refuzimit të aplikimeve për kredi nga bankat me kapital vendas ka rënë në 6.2% (nga 8.3% një 6-mujor më parë), ndërsa për bankat me kapital të huaj kjo normë është rritur në 27% (nga 21.1% e raportuar në 6-mujorin e kaluar). Sipas segmenteve të klientelës, bankat e huaja mbeten më të prirura për të kredituar segmentin e ndërmarrjeve, veçanërisht ndërmarrjet e mëdha dhe norma e refuzimit për këtë grup ndërmarrjesh ka rënë ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit. Nga ana tjetër,

norma e refuzimit kundrejt segmentit 'të individëve' ka shënuar rritje për grupin e bankave të huaja dhe rënie për grupin e bankave me kapital vendas.

Në përgjithësi, nga analiza mund të arrihet në përfundimin se ecuria e numrit të aplikimeve të shqyrtuara nga bankat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, tregon për rritje të moderuar të kërkesës për kredi (në terma vjetorë), si nga sektori i individëve, ashtu edhe nga ai i bizneseve, por me një prirje të lehtë rritëse gjatë vitit. Nga ana tjetër, lehtësimi i masave kufizuese të pandemisë dhe rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik në vend pas rifillimit të punës në sektorët e prekur, ka vijuar të ndikojë pozitivisht prirjen krediduese të bankave, veçanërisht ndaj grupit të ndërmarrjeve të mëdha.

Grafik 23. Norma e refuzimit të kredive nga bankat vendase dhe të huaja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE

3.1 TREGJET E KAPITALIT DHE TREGU VALUTOR

TREGU PARËSOR I LETRAVE ME VLERË

Karakteristikë e tregut parësor të titujve të borxhit është se ai mbizotërohet nga titujt e borxhit të Qeverisë Shqiptare. Vëllimi i borxhit të Qeverisë të emetuar në Lek gjatë periudhës ishte 150 miliardë lekë. Në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, vëllimi i titujve të emetuar ishte 20% ose 35 miliardë lekë më pak, por ky vëllim ishte i krahasueshëm me atë të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020. Normat e interesit të titujve kanë qenë të qëndrueshme dhe norma mesatare e interesit për të gjitha maturitetet e letrave me vlerë është luhatur rreth nivelit 2.3% gjatë dy viteve të fundit. Mbi 60% e vëllimit të titujve të emetuar gjatë gjysmës së dytë të vitit përfaqësohet nga emetime në bono thesari, ndërsa pjesa tjetër ishin tituj afatgjatë.

Vëllimi i titujve të borxhit në Lek të emetuar nga qeveria gjatë gjysmës së dytë të vitit ishte i krahasueshëm me atë të një viti më parë. Prirja drejt huamarrjes me maturim afatgjatë ka vazhduar. Norma mesatare e interesit të titujve ka qenë e qëndrueshme dhe është luhatur rreth nivelit 2.3% gjatë gjithë periudhës. Huamarrja nëpërmjet Eurobondit në nëntor 2021, ka rezultuar veçanërisht e dobishme në kushtet e zhvillimeve gjeopolitike të fillimvitit 2022.

Grafik 24. Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 25. Përbërja e borxhit të brendshëm në lekë të emetuar gjatë periudhës 2016-2021



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreth 90% të borxhit afatshkurtër e zënë bonot e thesarit me maturim 12-mujor. Emetimi i bonove 12-mujore ishte 24% ose 27 miliardë lekë më pak nga ai i periudhës së mëparshme dhe pothuajse i njëjtë me vëllimin e bonove 12-mujore të emetuara gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020. Vëllimi i bonove 3-mujore të emetuara gjatë periudhës ishte disi më i vogël nga ai i gjashtëmujorit të parë të vitit por pak më shumë nga vëllimi i të njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm, ndërsa vëllimi i bonove 6-mujore ra në krahasim me të dy gjashtëmujorët paraardhës. Norma mesatare e interesit për titujt afatshkurtër ishte 1.6% në fund të periudhës dhe kjo normë qëndronte rreth 0.1-0.2 pikë përqindjeje nën

nivelin e gjashtë muajve dhe një viti më parë. Me përjashtime të rralla, oferta për investim në tituj afatshkurtër ka qenë e njëjtë ose më e lartë sesa kërkesa e qeverisë për huamarrje. Në ato raste kur kërkesa e qeverisë për financim nëpërmjet emetimeve 3 dhe 6-mujore nuk është përmbushur, janë shtuar presionet për rritje të normave të interesit për këto maturitete. Norma mesatare e interesit për bonot 12-mujore u rrit nga 1.4% në 1.8% gjatë tremujorit të tretë të vitit, por rritja e vazhdueshme e ofertës për investim ka ndikuar në uljen graduale të saj gjatë tremujorit të katërt deri në nivelin 1.6% në fund të vitit.

Grafik 26. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 27. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vëllimi i titujve afatgjatë të borxhit të emetuar gjatë periudhës ishte 9% më pak në krahasim me atë të gjashtëmujorit të parë të vitit, por u rrit lehtë në krahasim me vëllimin e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Gjatë dy viteve të fundit është vërejtur rritja në vëllimin e emetimit të titujve me maturim 7 dhe 10-vjeçar. Në krahasim me vëllimet përkatëse të gjashtëmujorit të parë të vitit, emetimet për këto maturitete ishin përkatësisht 17% dhe 26% më të larta. Emetimi në obligacione 2-vjeçare vijon të përfaqësojë pjesën më të madhe të emetimit në titujt afatgjatë, por vëllimi i këtij emetimi gjatë gjysmës së dytë të vitit ishte më i ulët që prej fundit të vitit 2017. Në nëntor 2021, u emetua për herë të parë obligacioni me afat maturimi 15 vjet, dhe ky është titulli me maturitetin më afatgjatë të emetuar nga Qeveria Shqiptare deri më sot. Norma mesatare e interesit për titujt afatgjatë ka qëndruar në nivelin 3.3% gjatë gjithë periudhës. Norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt me maturim 2, 3 dhe 5 vjet ishte përkatësisht 2.1%, 2.6% dhe 3.5%, ndërsa për titujt me maturim 7, 10 dhe 15 vjet, normat e ponderuara të interesit ishin përkatësisht 4.0%, 5.1% dhe 5.9%. Preferenca për të investuar në tituj afatgjatë ka qenë e lartë duke qenë se oferta për investim në këta tituj ka qenë pothuajse në të gjitha rastet më e lartë se sa kërkesa për huamarrje nga qeveria.

HUAMARRJA NË TREGUN NDËRKOMBËTAR TË KAPITALIT

Në nëntor të vitit 2021, Qeveria Shqiptare u riprezantua në tregun ndërkombëtar të kapitalit me emetimin e një obligacioni të ri 10-vjeçar, me vlerë 650 milionë euro dhe kupon 3.5%. Ky emetim është më afatgjati i marrë deri më sot në tregun e jashtëm. Oferta për investim ishte rreth 63% mbi shumën e kërkuar, çka tregoi interesin e tregjeve ndërkombëtare për titujt shqiptarë dhe besimin e investitorëve të huaj në ekonominë vendase. Emetimi i Eurobondit ishte në të njëjtin nivel me emetimin e Eurobondit 7-vjeçar të vitit 2020, dhe norma e kuponit ishte e krahasueshme me atë të dy emetimeve të mëparshme. Duke konsideruar ngjarjet gjeopolitike të fillimit të vitit 2022 dhe stresin pasues, huamarrja në tregun ndërkombëtar në fund të vitit 2021 mund të konsiderohet si një vendimmarrje efektive.

Grafik 28. Vëllimi dhe norma e huamarrjes në tregun ndërkombëtar



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

TREGU DYTËSOR I TITUJVE TË BORXHIT

Vlera e transaksioneve të kryera në tregun dytësor gjatë periudhës ishte rreth 3 miliardë lekë ose rreth 10% më shumë sesa vlera e regjistruar gjatë dy gjashtëmujorëve paraardhës. Kjo vlerë u shpërnda në mënyrë të barabartë midis titujve afatshkurtër dhe atyre afatgjatë. Vlera e transaksioneve në tituj afatgjatë ishte më e lartë, kurse ajo e titujve afatshkurtër ishte më e ulët, në krahasim me ato të gjashtëmujorit të parë të vitit.

Numri i përgjithshëm i transaksioneve të kryera në tregun dytësor (670 transaksione) ishte më i vogël në krahasim me numrin e transaksioneve të kryera gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Kjo rënie erdhi nga zvogëlimi me rreth 20% në numrin e transaksioneve në tituj afatshkurtër (gjithsej 570). Numri i transaksioneve në titujt afatgjatë (gjithsej 190), u rrit me 30% gjatë periudhës. Investitorët në tregun sekondar me pakicë vijojnë të shfaqin preferencë për t'i mbajtur letrat me vlerë deri në maturim, duke qenë se vetëm rreth 23% e tyre tregtohen.

Megjithë rënien e numrit të transaksioneve në tregun dytësor të titujve, vlera e tregtuar shënoi rritje gjatë periudhës, me kontributin kryesor nga titujt afatgjatë. Zhvilluesit e tregut kanë ndihmuar në rritjen e numrit dhe të vlerës së titujve të referencës së tregtuar. Kurba e yield-eve në treg shfaq një pjerrësi normale, dhe investitorët vijojnë të kenë preferencë për t'i mbajtur titujt deri në maturim.

Grafik 29. Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Grafik 30. Nivelet e *Yield*-it (YTM) në datën 30.6.2021



Burimi: Banka e Shqipërisë

Zhvilluesit e tregut (*market makers*) kanë vijuar kuotimet ditore të titujve *benchmark* (obligacione referencë me maturitet 3- dhe 5-vjeçar), të cilat zënë rreth 25% të transaksioneve në titujt afatgjatë. Gjatë periudhës, vlera e tregtuar e tyre u trefishua, por mbetet e ulët (në rreth 0.3 miliardë lekë). Edhe numri i transaksioneve tregoi të njëjtën ecuri, duke u rritur me 16%, në nivelin 43. Kuotimi me bazë ditore i titujve referencë mundëson llogaritjen e kurbës së *yield*-it, që shërben si referencë për titujt e tjerë të borxhit në treg dhe rrit transparencën, duke dhënë informacion në kohë reale për çmimin e titujve. Kurba e *yield*-it në fund të periudhës paraqet një pjerrësi normale në rritje, me norma interesi më të larta për maturitetet më afatgjata.

TREGU NDËRBANKAR

Vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar gjatë vitit të fundit është rritur. Kontributi kryesor ka ardhur nga transaksionet javore dhe ditore. Norma mesatare e interesit është luhatur pranë normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë. Kjo ecuri ka reflektuar edhe injektimin e likuiditetit pa kufi nga ana e Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës.

Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar u zgjerua me 30%, ndërsa normat e interesit janë luhatur pranë nivelit të normës bazë të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Tregu ndërbankar vijon të mbizotërohet nga transaksionet 1-javore, të cilat përbëjnë rreth 90% të vëllimit të huamarrjes ndërbankare. Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve 1-javore u rrit kundrejt gjashtëmujorit të kaluar dhe të njëjtës periudhë të një viti më parë me përkatësisht 25% dhe 34%. Transaksionet 1-ditore përbëjnë rreth 10% të vëllimit të përgjithshëm dhe në krahasim me dy gjashtëmujorët e mëparshëm u shtuan me rreth 20%. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, në tregun ndërbankar janë regjistruar edhe transaksione 3-mujore, por vëllimi i tyre është shumë i vogël në krahasim me transaksionet 1-ditore dhe 1-javore. Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka injektuar likuiditet përmes marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor. Forma e ankandit lejonte që bankat të merrnin hua në shuma të pakufizuara, në nivelin e normës bazë të interesit.

Grafik 31. Normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 32. Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Gjatë periudhës, tregu valutor dhe kursi i këmbimit të lekut treguan qëndrueshmëri. Në fund të vitit, kursi i këmbimit të euros ishte rreth nivelit 120.8 lekë, duke treguar mbiçmim të lekut me përkatësisht 1.6% dhe 2.2% ndaj vlerave të gjashtë muajve dhe një viti më parë. Ecuria e kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt dollarit amerikan ka reflektuar zhvillimet ndërkombëtare në kursin USD/Euro. Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, Leku u nënçmua me përkatësisht 4.8% dhe 5.2% kundrejt dollarit amerikan, duke shënuar 106.9 lekë në fund të vitit.

Gjatë periudhës, kursi i këmbimit të lekut ka qenë i qëndrueshëm. Monedha vendase u mbiçmua ndaj monedhës evropiane dhe u nënçmua ndaj dollarit amerikan. Në këtë ecuri, kanë ndikuar edhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

3.2 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Treguesit që përdoren për monitorimin e ecurisë së tregut të pasurive të paluajtshme sugjerojnë që kërkesa dhe oferta në këtë treg ka shënuar rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021. Bankat lehtësuan standardet e kreditimit për kreditë për blerje banesash. Treguesit cilësorë reflektojnë kushte të pandryshuara të bankave për kredi për pasuri të paluajtshme, por kërkesa nga individët për financimin e blerjes së banesave është rritur. Teprica e kredisë bankare për pasuri të paluajtshme si për sektorin e individëve, ashtu edhe për atë të bizneseve ka shënuar rritje, ndërsa agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme kanë raportuar rritje të çmimit të shitjes dhe vëllime më të larta të njësive të shitura gjatë periudhës. Për sa i përket ofertës në këtë treg, kredia për ndërtim shënoi rritje në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe ndaj një viti më parë dhe numri i lejeve të ndërtimit të dhëna gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021 ishte përkatësisht 30% dhe 40% më i lartë në krahasim me numrin e lejeve të dhëna gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit dhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020. Kostot e ndërtimit gjithashtu paraqesin një rritje të lehtë në krahasim me gjysmën e parë të vitit dhe ndaj një viti më parë dhe kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë rritja e shpenzimeve për materiale ndërtimi.

Në tregun e pasurive të paluajtshme, kërkesa dhe oferta kanë shënuar rritje gjatë periudhës. Ato janë mbështetur nga rritja e kredisë bankare për prona dhe për ndërtim.

Çmimet e banesave të shitura gjatë periudhës, janë rritur me 8.4% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 9% në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që edhe kostot e ndërtimit janë rritur me rreth 3% në terma vjetorë.

Agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme mbeten optimistë për të ardhmen e tregut.
Ecuria e tregut të pasurive të paluajtshme është e rëndësishme për stabilitetin financiar. Banka e Shqipërisë po punon për përmirësimin e të dhënave, të analizës dhe të adresimit të rreziqeve potenciale që shoqërojnë veprimtarinë e këtij tregu.

Mbështetur në vrojtimin periodik të kryer gjatë periudhës me agjenci të tregtimit të pasurive të paluajtshme dhe kompani ndërtimi, agjentët u shprehën relativisht optimistë dhe e vlerësojnë në përmirësim situatën e këtij tregu. Në fund të periudhës, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme kanë raportuar çmime shitjeje më të larta ndaj gjashtëmujorit të kaluar për të gjithë territorin e vendit. Çmimet e banesave të llogaritura sipas Indeksit Fischer për shitjet e kryera gjatë gjysmës së dytë të vitit, janë rritur me 8.4% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 9% në krahasim me një vit më parë. Për shitjet e realizuara në zonën e Tiranës, që përfshin qendrën, periferinë dhe zonat jashtë qytetit, indeksi regjistroi një rritje prej 8.5% ndaj periudhës paraardhëse dhe 12.3% ndaj një viti më parë.

Kostot e ndërtimit të matura sipas Indeksit të Kushtimit në Ndërtim janë rritur me 1.4% në terma mesatarë gjashtëmujorë dhe me 2.7% në krahasim me nivelin mesatar të indeksit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020. Zërat e shpenzimeve me rritjen më të lartë gjashtëmujore brenda indeksit të përgjithshëm ishin nëntreguesit "materiale hidrosanitare", "materiale ndërtimi", "materiale elektrike" dhe "energji" që u rritën me përkatësisht 2.5%, 2%, 1.6% dhe 1.5%. Zëri "materiale ndërtimi" është zëri me peshën më të lartë në shportën e shpenzimeve për ndërtim me 35%, i ndjekur nga shpenzimet për paga dhe për makineri me përkatësisht 22% dhe 13%.

Të dhënat e sektorit bankar për periudhën tregojnë rritje të tepricës së kredisë për pasuri të paluajtshme dhe përmirësim të cilësisë së saj përgjatë vitit të fundit. Stoku i kredisë për blerje pasurish të paluajtshme për sektorin e individëve në fund të vitit 2021 arriti në rreth 130 miliardë lekë, dhe u rrit me 7% ndaj nivelit të fundit të gjashtëmujorit të parë dhe me 13% në krahasim me nivelin e regjistruar në fund të vitit 2020. Ecuria e kësaj kredie vijon të favorizohet nga një mjedis me norma interesi të ulëta dhe të qëndrueshme për këtë kategori kredie. Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie ra në 3.1%, nga rreth 3.7% një gjashtëmujor më parë dhe 4.3% një vit më parë.

Grafik 33. Ecuria e Indeksit Fischer të Çmimit të Banesave në rang vendi dhe për Tiranën



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 34. Cilësia e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme



Burimi: Banka e Shqipërisë

Teprica e kredisë për ndërtim u rrit me 16% ndaj nivelit të fundit të qershorit të vitit 2021 dhe me 27% në krahasim me një vit më parë. Pesha e kredisë për ndërtim zë 16% të tepricës së kredisë së bizneseve, dhe kjo peshë ka ardhur duke u rritur gjatë viteve të fundit. Në fund të periudhës, stoku i kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme shënoi rritje ndikuar nga ecuria e kredive të kolateralizuara në monedhën vendase. Brenda kësaj ndarjeje, 63% e stokut mbahet nga sektori i individëve dhe pjesa tjetër nga sektori i bizneseve.

Interesi i Bankës së Shqipërisë në ecurinë e tregut të pasurive të paluajtshme nuk lidhet me detyrime ligjore të drejtpërdrejta, duke qenë se funksionimi i atij tregu varet nga faktorë që nuk përcaktohen nga banka qendrore (si për shembull, zhvillimet demografike apo sipërfaqja e tokës së disponueshme për ndërtim). Megjithatë, monitorimi i zhvillimeve në këtë treg është i rëndësishëm për të evidentuar situatat kur ecuria e çmimeve është e paqëndrueshme. Kjo do të thotë që çmimet në treg nuk reflektojnë ndryshimet në kohë të faktorëve themelorë që përcaktojnë kërkesën dhe ofertën për pasuri të paluajtshme.

Nëse çmimet zhvillohen në mënyrë të paqëndrueshme, rritet stresi për grupe të caktuara publiku dhe rritet mundësia që çmimet të korrektohen në mënyrë të papritur, duke krijuar humbje në pasurinë e agjentëve ekonomikë e financiarë të ekspozuar në treg. Sa më i lartë ekspozimi në pasurinë e këtyre agjentëve, aq më e madhe do të jetë humbja me të cilën ata mund të përballen dhe aq më e madhe është nevoja që të vlerësohet rezistenca e tyre ndaj këtyre skenarëve. Kjo qasje është e rëndësishme nga këndvështrimi i stabilitetit financiar, në drejtim të marrjes së masave për zbutjen e rreziqeve sistemike eventuale. Banka e Shqipërisë po punon për të përmirësuar të dhënat, analizën dhe trajtimin e rreziqeve nga kjo veprimtari.

HAPËSIRË INFORMUESE 3. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR 6M II-2021

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës nga ana e agjentëve në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme. Subjektet e zgjedhura janë agjentë imobiliarë dhe shoqëri ndërtimi shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar.

<u>Vlerësimi i përgjithshëm.</u> Vlerësimi i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut është përmirësuar lehtë në krahasim me periudhën e kaluar, dhe ky rezultat përfaqëson një ndryshim të kahut të perceptimit të periudhave të kaluara, që ka qenë përgjithësisht pesimist. Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve rezultoi [+4%], ku rreth 60% e përgjigjeve ishin neutrale – "pa ndryshim". Kjo vlerë shfaq ndryshim të dukshëm edhe ndaj mesatares afatgjatë

prej rreth -20%. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje gjatë periudhës rezultoi, ashtu siç pritet, shumë më pozitiv, në vlerën +28%.

Ecuria e çmimeve dhe e shitjeve. Gjatë periudhës, Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi shënoi rritje me 8.4% në krahasim me nivelin e periudhës paraardhëse dhe rritje me 9% ndaj gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar. Vëllimi i shitjeve ose numri i njësive të shitura në zonat e preferuara të kryeqytetit ishte dy herë më i lartë në krahasim me vëllimin e shitjeve të realizuara gjatë gjysmës së parë të vitit, dhe ky zhvillim, për shkak të çmimeve më të larta të kësaj zone, përfaqëson edhe faktorin kryesor pas rritjes së ndjeshme të çmimeve të banesave gjatë periudhës. Indeksi i Çmimit për Tiranën u rrit me 8.5% ndaj periudhës paraardhëse dhe me 12.3% ndaj së njëjtës periudhë një vit më parë dhe kjo rritje është përcaktuar vetëm nga rritja e çmimit për shitjet në zonat qendrore të kryeqytetit. Rritje është raportuar gjithashtu edhe për çmimet e shitjeve në zonat e tjera, ndërkohë që shitjet e raportuara në qytetet bregdetare janë realizuar me çmime mesatare më të ulëta në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm.*

Numri i banesave të regjistruara. Agjentët kanë raportuar një numër më të ulët banesash të reja të regjistruara në librat e tyre. Balanca neto e atyre që kanë raportuar rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që vlerësojnë se numri i tyre ka rënë, ishte rreth -6%, dhe kjo vlerë tregon rënie të treguesit në krahasim me periudhën e kaluar. Numri i pronave të pashitura, si për banesat, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjashtëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes. Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi vlerësohet të jetë rritur lehtë në krahasim me periudhën e kaluar duke shënuar 11 muaj nga 10.5 muaj për gjashtëmujorin e parë të vitit. Për Tiranën, subjektet e intervistuara kanë raportuar një kohë mesatare shitjeje prej 9.4 muajsh, dhe kjo vlerë ka mbetur pothuajse e pandryshuar nga një gjashtëmujor më parë. Për zonën e bregdetit dhe për zonat e tjera, koha e shitjes u raportua përkatësisht 11 dhe 12.9 muaj. Vlen të theksohet që për qytetet bregdetare, koha mesatare është rritur ndjeshëm nga vlera prej 7.6 muajsh e gjashtëmujorit të parë të vitit kaluar, duke iu afruar mesatares afatgjatë prej 12.1 muajsh.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare. Sipas agjentëve, ashtu si periudhën e kaluar, rreth 30% e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Nga këto, në gjysmën e rasteve kredia ka mbuluar deri në 60% të vlerës.

Pritjet për të ardhmen. Ashtu si edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, agjentët u shprehën pozitivë për ecurinë në të ardhmen afatshkurtër të tregut në territorin ku ata veprojnë, dhe për ecurinë e pritshme të tregut në të gjithë territorin për periudhën më afatgjatë (deri në 2 vjet). Numri i pronave që pritet të regjistrohen për shitje gjatë periudhës në vazhdim, sipas balancës neto prej +30%, pritet të rritet. Agjentët presin gjithashtu rritje të çmimeve të pronave të paluajtshme për banesat dhe pronat tregtare. Balancat neto për këto dy pyetje, ishin pozitive dhe shënuan vlerën +22%, duke reflektuar optimizëm nga ana e agjentëve.

Çmimi i qirasë. Çmimet e qirasë sipas agjentëve të intervistuar kanë shënuar rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, dhe kërkesa për të marrë prona me qira gjithashtu ka shënuar një rritje të lehtë ndaj periudhës së kaluar. Nevojitet të theksohet që përgjigjet për këtë seksion të pyetësorit përgjithësisht plotësohen për zonën e kryeqytetit.

** "Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së Bregdetit.*

3.3 SISTEMET E PAGESAVE

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në lekë ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Gjatë periudhës është vënë re një rritje e ndjeshme e numrit dhe vëllimit të pagesave të vogla dhe të mëdha. Për të dytin vit radhazi, transfertat me kartë kanë vijuar të zënë vendin e parë për nga frekuenca e përdorimit.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan gjatë periudhës rreth 73 mijë pagesa me një vlerë prej 5,800 miliardë lekësh. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri dhe vlera e transaksioneve kanë shënuar një rritje prej 8% dhe 13%. Në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës janë kleruar rreth 550 mijë pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 160 mijë lekësh. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar një rritje të ndjeshme si në numrin, ashtu edhe në vlerën e pagesave. Për të dy këta tregues rritja vjetore ishte rreth 20%.

Grafik 35. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjashtëmujorin e dytë të viteve 2020 dhe 2021



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës janë kryer 15.2 milionë pagesa me një vlerë prej 2,880 miliardë lekësh. Kjo ecuri tregon rritje të ndjeshme të numrit dhe vlerës së transaksioneve, me përkatësisht 25% dhe 18% ndaj gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020. Pagesat me karta zënë vendin kryesor të instrumenteve të pagesave për nga numri i transaksioneve që ishte sa 56% e numrit të përgjithshëm të transaksioneve të tyre për këtë periudhë, duke tejkaluar kështu për të dytin vit radhazi transfertat e kreditit në formë letër, që kanë dominuar në tregun shqiptar për vite me radhë. Nga ana tjetër, numri i transfertave të kreditit në formë joletër (*internet banking, mobile banking*) ka vijuar të rritet me ritme të shpejta.

Grafik 36. Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4. SISTEMI FINANCIAR

Grafik 37. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2021



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Gjatë periudhës, pesha e aktiveve të sistemit financiar[18] ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ka shënuar rënie, si rrjedhojë e rritjes më të madhe të PBB-së krahasuar me aktivet. Kjo peshë ra në 105% nga 110% gjashtë muaj dhe një vit më parë. Pesha e sektorit bankar ndaj PBB-së zbriti në 94% nga 98% një vit më parë, ndërsa pesha e sektorit jobankar rezultoi sa 11% e PBB-së, duke rënë lehtë nga niveli i një viti më parë. Treguesit e performancës të sistemit financiar duke përfshirë ata të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira.

Tabelë 4. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %)*

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë			Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare			Ndërmjetësimi financiar
Sistemi financiar	Sektori bankar	IFJB	SHKK dhe Unioni	Shoqëri sigurimi	Fonde pensioni	Fonde investimi	
2011	86.1	2.6	0.8	1.5	0.0		91.0
2012	89.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	95.4
2013	91.4	2.6	0.7	1.6	0.0	3.7	100.2
2014	92.7	2.8	0.8	1.8	0.0	4.6	102.7
2015	91.9	2.7	0.7	2.0	0.1	4.7	102.0
2016	95.5	2.8	0.6	2.0	0.1	4.5	105.5
2017	93.2	2.9	0.5	2.0	0.1	4.7	103.4
2018	88.8	3.2	0.6	1.9	0.1	4.2	98.8
2019	87.2	3.9	0.6	2.0	0.2	4.0	97.9
2020	97.8	4.2	0.7	2.4	0.2	4.2	109.5
2021	93.8	4.0	0.7	2.2	0.2	4.1	105.1

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

* *Në ndryshim nga llogaritjet e mëparshme kur PBB-ja shprehej me çmime konstante, këtë herë vlerat në tabelë janë rillogaritur të gjitha, duke përdorur PBB-në nominale me çmime korrente, sipas INSTAT. Kjo mënyrë do të përdoret edhe në vijim.*

[18] *Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar (institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursimit-kreditit, shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit dhe fondet e investimit).*

4.1 SEKTORI BANKAR

4.1.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN BANKAR

Aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 8% gjatë periudhës dhe me 12% në krahasim me një vit më parë. Sektori bankar ka zhvilluar normalisht funksionet kryesore të veprimtarisë dhe ka mbështetur ekonominë me financim. Vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 130 miliardë lekë gjatë periudhës duke arritur në rreth 1,770 miliardë lekë. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e kanë dhënë zgjerimi i investimeve në tituj me rreth 60 miliardë lekë dhe i aktivitetit kreditues me rreth 50 miliardë lekë.

Veprimtaria e sektorit bankar gjatë vitit 2021 është zgjeruar. Rritja e aktivitetit është mbështetur nga rritja në investimet në tituj dhe në kredi për ekonominë.

Tabelë 5. Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, dhjetor 2021

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor, %	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor, %
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	28	5	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	6	30
II. Veprime me klientët (Kredia)	38	10	II. Veprime me klientët (Depozita)	81	12
Nga të cilat: për sektorin publik	1	-34	Nga të cilat: të sektorit publik	1	60
Nga të cilat: për sektorin privat	36	8	Nga të cilat: të sektorit privat	79	11
III. Veprimet me letrat me vlerë	33	21	III. Veprimet me letrat me vlerë	0	-13
IV. Fonde rezervë të krijuara	-2	-17	IV. Detyrime të tjera	1	40
V. Të tjera	3	-1	V. Burimet e përhershme	11	7
			Nga të cilat: Borxhi i varur	1	11
			Nga të cilat: Kapitali aksionar	10	7
Totali i aktiveve	100	12	Totali i pasiveve	100	12

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në fund të periudhës, aktivet dhe detyrimet e sektorit bankar në valutë zinin përkatësisht 52% dhe 51% të totalit të bilancit dhe këto raporte janë ruajtur gjatë periudhës. Në vlerë absolute, bankat raportuan nivele të përafërta të aktiveve dhe detyrimeve në valutë (920 miliardë dhe 900 miliardë lekë), duke ruajtur kështu një ekspozim pothuaj të përputhur të aktivitetit në valutë. Nga ana e aktiveve në valutë, zërat me peshën më të madhe mbeten aktiviteti kreditues dhe investimet ndërbankare, ndërkohë që gjatë dy viteve të fundit është vërejtur rritje e peshës së investimeve në letrat me vlerë. Nga ana e detyrimeve në valutë, struktura paraqitet më e qëndrueshme në vite dhe dominohet nga depozitat në valutë. Këta përbërës kanë përcaktuar në masën më të madhe ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj ekspozimit në valutë. Efekti statistikor i kursit të këmbimit në kundërvlerën në lekë të bilancit në valutë ishte negativ, por i vogël dhe pa ndikim të rëndësishëm në të dhënat e raportuara në lek. Depozitat dhe fondet e veta vijojnë të përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar, me 92% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë ka qenë e qëndrueshme gjatë periudhës.

Veprimtaria në valutë e sektorit bankar është pothuajse e përputhur në të dy krahët e bilancit. Depozitat dhe fondet e veta përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë.

Efekti statistikor i kursit të këmbimit, në vlerat e raportuara në lek gjatë periudhës ka qenë i vogël.

Pesha e pozicionit kreditor të sektorit bankar ndaj jorezidentëve nuk ka shënuar ndryshime.

Grafik 38. Ecuria e aktiveve në valutë (majtas) dhe detyrimeve në valutë (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktivet e vendosura pranë subjekteve jorezidente shënuan rritje gjatë periudhës për shkak të zgjerimit të investimeve në tituj dhe rritjes së vendosjeve në formën e llogarive rrjedhëse me bankat dhe institucionet financiare. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e ulët, ndonëse u rrit lehtë gjatë periudhës si rezultat i rritjes së detyrimeve ndaj jorezidentëve. Kontributin kryesor e kanë dhënë rritja e detyrimeve në formën e huasë dhe të depozitave, ndërsa detyrimet në formën e fondeve të veta kanë vijuar rënien si rrjedhojë e tkurrjes së borxhit të varur dhe ndryshimeve strukturore në kapitalin e bankave.

Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 22% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve zinin vetëm 3% të totalit të bilancit. Pozicioni kreditor neto i bankave vendase ndaj sektorit jorezident u zgjerua lehtë në terma nominalë, por mbeti i pandryshuar në terma relativë, në nivelin 19% të aktiveve.

Grafik 39. Detyrimet ndaj jorezidentëve (mld lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 40. Pozicioni neto me jorezidentë*



*Vija e zezë vertikale pasqyron periudhën e transformimit të degës së BKT në Filial.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.1.1 Indeksi i shëndetit bankar

Indeksi i shëndetit bankar ka vijuar të sinjalizojë përmirësim gjatë periudhës, duke qenë në nivelin më të mirë që nga viti 2005. Përmirësimi i indeksit është ndikuar kryesisht nga ecuria pozitive në treguesit e cilësisë së aktiveve dhe likuiditetit. Rënia e rrezikut të lidhur me përfitueshmërinë gjatë vitit të fundit[19] pasqyron rritjen e fitimit të sektorit bankar. Kontributi i treguesit të "Kapitalit" në nivelin e rrezikut është rritur vitin e fundit, ndikuar kryesisht nga rënia e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe nga zgjerimi i levës financiare. Rreziku i lidhur me likuiditetin ka shënuar rënie gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, për shkak të zgjerimit në raportin e aktiveve likuide ndaj aktiveve të përgjithshme, dhe kontributi i këtij përbërësi në nivelin e agreguar të rrezikut në kohë ka shënuar përgjithësisht rënie, veçanërisht gjatë vitit të fundit[20].

Indeksi i shëndetit bankar është përmirësuar gjatë periudhës. Kontributin kryesor në këtë drejtim e ka dhënë përmirësimi i cilësisë së aktiveve dhe i pozicionit të likuiditetit dhe rritja e përfitueshmërisë. Sipas indeksit, përmirësimi i shëndetit bankar ka qenë gradual por i qëndrueshëm në 5-6 vitet e fundit.

Grafik 41. Indeksi i shëndetit bankar*



Sa më e lartë vlera, aq më i lartë rreziku. Gjerësia e çdo dimensioni nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Harta e shëndetit bankar*



Largësia nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Cilësia e aktiveve është përmirësuar lehtë krahasuar me një vit më parë dhe kontributi i këtij nëntreguesi në rrezikun e përgjithshëm ka ardhur në rënie gjatë viteve të fundit. Vlera e këtij treguesi ra nga 0.71 në mars 2015, në 0.40 në dhjetor 2021 dhe rolin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rënia e konsiderueshme në raportin e kredive me probleme. Indeksi i shëndetit është përmirësuar në krahasim me një vit më parë edhe për bankat sistemike. Për këtë grup bankash vërehet përmirësim në katër prej pesë treguesve, por në mënyrë të veçantë përmirësimi është regjistruar në treguesit e likuiditetit dhe cilësisë së aktiveve. Treguesi i kapitalit për bankat sistemike ka shënuar rënie të lehtë gjatë vitit 2021, për shkak të një rënieje të lehtë në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit

[19] *Vlera e treguesit të përfitueshmërisë ra nga 0.54 në 0.50 gjatë periudhës dhjetor 2020 – dhjetor 2021, duke treguar ulje të rrezikut. Gjatë vitit 2020, ky tregues regjistroi vlerat më të larta që nga viti 2013.*

[20] *Vlera e treguesit të likuiditetit ra nga 0.33 në 0.40 gjatë periudhës dhjetor 2020 – dhjetor 2021.*

dhe njëkohësisht rritjes së levës financiare. Në tërësi, gjatë viteve 2014-2021, indeksi i agreguar i shëndetit bankar ka shfaqur një prirje rënëse, duke treguar përmirësim të shëndetit dhe rritje të qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

4.1.1.2 Kapitalizimi i veprimtarisë

Sektori bankar është i mirëkapitalizuar. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të periudhës rezultoi 18%.

Treguesi mbeti i pandryshuar gjatë periudhës, por u zvogëlua ndaj një viti më parë për shkak të rritjes së shpejtë të aktiveve të peshuara me rrezik. Të gjitha bankat plotësojnë normën minimale të kërkuar të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%.

Treguesi i levës financiare është rritur gjatë vitit, dhe është më i lartë për bankat me kapital shqiptar.

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe asnjë bankë e sektorit nuk ka raportuar normë mjaftueshmërie nën vlerën minimale të kërkuar nga kuadri rregullator prej 12%. Në fund të vitit 2021, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi nivelin 18%, duke mbetur e pandryshuar gjatë periudhës, por duke rënë me 0.7 pikë përqindje në krahasim me nivelin e një viti më parë. Rënia ka reflektuar rritjen më të shpejtë të aktiveve të peshuara me rrezik në krahasim me ndryshimin në nivelin e kapitalit rregullator. Bankat me kapital evropian dhe bankat sistemike raportojnë nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar është përqendruar në intervalin 14%-16%. Gjatë periudhës, ndryshimet në nivelin e kapitalit rregullator dhe në nivelin e aktiveve të peshuara me rrezik kanë ndikuar në drejtime të kundërta, por në masë pothuajse të njëjtë, në ndryshimin e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, prej rreth 1 pikë përqindjeje. Niveli i kapitalit rregullator të sektorit bankar u rrit me 9 miliardë lekë, duke arritur në 167 miliardë lekë në fund të vitit 2021.

Grafik 43. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 44. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja në kapitalin rregullator u ndikua kryesisht nga rritja e fitimit të pashpërndarë. Fitimi i pashpërndarë i periudhave të mëparshme ka qenë elementi kryesor në rritjen e kapitalit aksionar dhe atij rregullator gjatë dy viteve të fundit. Në

ruajtjen e fitimit të pashpërndarë nga periudhat e mëparshme ka ndikuar edhe ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë me vendimin e muajit janar 2021[21], për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat. Nga ana tjetër, aktivet e peshuara me rrezik kanë regjistruar rritje si ndaj gjashtë muajve të mëparshëm, ashtu edhe ndaj një viti më parë, duke arritur në 930 miliardë lekë. Rritja në aktivet e peshuara me rrezik lidhet kryesisht me shtimin e ekspozimeve nga veprimtaria e kreditimit.

Grafik 45. Ndryshimi në kapitalin rregullator sipas elementeve përbërëse (në pikë përqindjeje)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 46. Ecuria e levës financiare për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, në herë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Struktura e aktiveve të peshuara me rrezik sipas rreziqeve nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës dhe vijon të dominohet nga aktivet e peshuara për rrezikun e kredisë (86%), të ndjekura nga ato të rreziqeve operacionale dhe të tregut, me përkatësisht 11% dhe 3%. Sektori bankar ka ruajtur strukturën e aktiveve të peshuara për rrezikun e kredisë, në të cilën dominojnë ekspozimet ndaj shoqërive tregtare dhe kreditë me probleme. Raporti i levës financiare[22] në dhjetor 2021 ishte 10 herë, dhe kjo vlerë ishte më e lartë në krahasim me nivelin e fundit të vitit 2020 (9.6), dhe sa mesatarja e 5 viteve të fundit. Nga analiza e ecurisë së levës financiare për grupe të caktuara bankash vërehet se bankat me kapital shqiptar kanë nivelin më të lartë të levës financiare.

[21] *Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.4, dt.13.1.2021 "Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat" me efekt deri më 31 dhjetor 2021.*

[22] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksionar.*

TEPRICA E KAPITALIT DHE PËRMBUSHJA E KËRKESAVE RREGULLATIVE PËR SHTESAT MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Edhe pas përmbushjes së kufirit minimal rregullativ, kërkesave specifike mbikëqyrëse dhe kërkesave për shtesat makro-prudenciale të kapitalit, sektori bankar regjistron një tepricë kapitali sa rreth 5% e aktiveve të peshuara me rrezik. Kjo tepricë është më e lartë për bankat me rëndësi sistemike.

Shtesat makroprudenciale të kapitalit kanë për qëllim përmirësimin e rezistencës së bankave ndaj rreziqeve sistemike me natyrë ciklike dhe strukturore. Për këtë qëllim, bankat ndërtojnë rezerva kapitali për të përthithur humbjet e mundshme dhe për të krijuar hapësira për të mbështetur ekonominë reale me financim në kohë të vështira. Në përputhje me rregulloren "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"[23], bankat janë subjekt i shtesës konservuese të kapitalit (KONS), shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC), shtesës për bankat me rëndësi sistemike (SIST) dhe shtesës për rrezikun sistemik (STRUK). Shtesa konservuese e kapitalit për vitin 2021 është 1% për të gjitha bankat e sektorit, ndërsa shtesa efektive për bankat sistemike varion nga 0.5% në 1% në varësi të rëndësisë sistemike të bankës.

Shtesa kundërciklike e kapitalit është 0% dhe aktualisht Banka e Shqipërisë nuk ka shpallur shtesë për rrezikun sistemik. Duke marrë në konsideratë shtesat e mësipërme si dhe shtesën specifike që kanë disa banka të sektorit bankar, kufiri i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit varion ndërmjet 14% dhe 17% për bankat me rëndësi sistemike dhe 13% dhe 16% për bankat e tjera. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike dhe bankat e tjera aktualisht janë më të larta sesa nivelet rregullative të lartpërmendura.

Nga llogaritja e të gjitha kërkesave për kapital rezulton se në fund të vitit 2021, sektori bankar ka tepricë kapitali[24]. Ecuria e tepricës së kapitalit diktohet nga ecuria e fitimit të bankave, sjellja e elementeve të kapitalit bazë të nivelit të parë, si edhe kërkesat për shtesat makroprudenciale të kapitalit. Në fund të vitit 2021, teprica e kapitalit ose kapitali i disponueshëm arriti nivelin e 50 miliardë lekëve ose sa 5.3% e aktiveve të peshuara me rrezik (APR). Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, teprica e kapitalit regjistroi rënie në krahasim me fundin e vitit 2020 dhe në fund të muajit qershor, shënonte 36 miliardë lekë (4.1% në raport me APR). Kjo rënie ishte rezultat i rritjes së shtesave makroprudenciale të kapitalit që u zbatuan mbi bankat sipas vendimeve përkatëse të Bankës së Shqipërisë. Rritja konsistonte në rritjen nga 0.5% në nivelin 1.0% të shtesës KONS dhe në rritjen me 0.5% të shtesës SIST të aplikuar mbi bankat sistemike. Kjo ecuri i nxiti bankat që të merrnin masa për të forcuar pozitat e kapitalit nëpërmjet rritjes së fitimeve të pashpërndara, të mbështetura nga performanca e mirë financiare, si edhe nëpërmjet rritjes së përdorimit të borxhit të varur.

[23] *Rregullorja nr.41, datë 5.6.2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".*

[24] *Me tepricë kapitali i referohemi kapitalit të mbetur që disponojnë bankat pas përmbushjes së të gjithave kërkesave rregullatore në fuqi (kufiri ligjor prej 12%, shtesa specifike mbikëqyrëse dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit).*

Grafik 47. Teprica e kapitalit për sektorin sektorin bankar dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas grupeve të bankave (dhjetor 2021)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat me rëndësi sistemike përcaktojnë ecurinë e tepricës së kapitalit të sektorit bankar duke qenë se këto banka zotërojnë më shumë kapital në krahasim me bankat e tjera. Në fund të vitit 2021, teprica e kapitalit për këto banka arriti në 40 miliardë lekë, ose 10 miliardë lekë më shumë sesa teprica e llogaritur në fund të gjashtëmujorit të parë dhe kjo tepricë ishte sa 6% e aktiveve të peshuara me rrezik. Bankat me rëndësi sistemike duhet të përmbushin një nivel më të lartë shtesash makroprudenciale dhe për këtë arsye, ato duhet të monitorojnë dhe raportojnë rregullisht pozicionin e tyre të kapitalit. Ajo që vihet re për fundin e vitit 2021, është se këto banka raportojnë një nivel të lartë fitimi neto dhe rrjedhimisht nivele të larta të kapitalit bazë të nivelit të parë, dhe që iu mundëson përmbushjen e kërkesave rregullative në fuqi. Bankat e tjera raportojnë nivele më të ulëta të kapitalit bazë të nivelit të parë e për rrjedhojë teprica e kapitalit e mbetur pas përmbushjes së kërkesave rregullative është më e vogël sesa ajo e bankave sistemike. Në fund të vitit 2021, kjo tepricë shënonte 8 miliardë lekë nga 6 miliardë lekë që ishte niveli i raportuar në fund të gjashtëmujorit të parë.

4.1.1.3 Rezultati financiar

Sektori bankar e mbylli vitin me një rezultat neto financiar pozitiv prej 21.6 miliardë lekësh, ose rreth 30% më të lartë në krahasim me një vit më parë. Në rritjen e rezultatit financiar të sektorit bankar ka kontribuar pjesa më e madhe e bankave. Rritja në fitimin e sektorit është pasqyruar edhe në rritjen e treguesve mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar: në krahasim me një vit më parë, RoA u rrit me 0.2 pikë përqindje në nivelin 1.3%, ndërsa RoE u rrit me 2.2 pikë përqindje, në nivelin 12.9%. Ndikimin më të madh në përmirësimin e rezultatit neto të sektorit bankar për vitin 2021 e ka dhënë rënia e ndjeshme e shpenzimeve për provigjione dhe rritja në rezultatin neto nga interesat. Në të njëjtën kohë, sektori bankar ka mbledhur më shumë të ardhura nga aktivitet e tjera jo të lidhura me interesat. Nga ana tjetër, shpenzimet e veprimtarisë u rritën me mbi 10%.

Sektori bankar e mbylli vitin me një fitim gati 30% më të lartë se një vit më parë. Në rritjen vjetore të rezultatit financiar kanë ndikuar rritja në të ardhurat neto nga interesat dhe nga veprimtaritë e tjera, dhe rënia e shpenzimeve për provigjionimin e kredive. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë janë rritur dhe raporti i tyre ndaj të ardhurave të veprimtarisë është rritur lehtë kundrejt një viti më parë. Sipas monedhës, në rritjen e rezultatit financiar të sektorit ka kontribuar kryesisht veprimtaria në monedhën kombëtare.

Për sektorin, të ardhurat neto nga interesat vijojnë të përfaqësojnë zërin kryesor të të ardhurave dhe shpenzimet jo për interesa mbeten zëri kryesor i shpenzimeve. Rezultati neto nga interesat rezultoi 46 miliardë lekë, ose 7.4% më i lartë se një vit më parë. Kontributin e vetëm këtu e dha rritja e të ardhurave nga interesat. Të ardhurat nga interesat e arkëtuara nga klientët ishin rreth 5% më shumë nga një vit më parë dhe arritën në 32 miliardë lekë. Interesat e arkëtuara nga investimet në tituj kapën vlerën 20 miliardë lekë duke qenë, gjithashtu, rreth 5% më të larta në krahasim me të ardhurat e vitit 2020.

Të ardhurat jo nga interesat, të përfaqësuara kryesisht nga të ardhura nga komisionet janë kthyer në një burim të rëndësishëm të ardhurash për sektorin bankar. Këto të ardhura u rritën me rreth 8% në krahasim me një vit më parë, duke regjistruar në fund të vitit vlerën 16 miliardë lekë. Ato kanë regjistruar një rritje graduale gjatë viteve të fundit dhe pesha e tyre në raport me të ardhurat neto nga interesat ka arritur në 35%, nga 20% një dhjetëvjeçar më parë.

Tabelë 6. Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për vitet 2020-2021 (mld lekë)

	2021			2020
	Në lekë	Në valutë	Total	Total
Të ardhura nga interesat	34	19.4	53.3	50.4
Shpenzime për interesat	5.4	1.9	7.4	7.7
Të ardhura neto nga interesat	28.5	17.5	46	42.8
Të ardhura jo nga interesat	10.8	5.3	16.2	14.7
gjoba dhe komisione	7.8	5.6	13.4	10.9
humbje ose fitim nga instrumentet financiare	1.9	(0.8)	1.2	2.6
Shpenzime jo për interesa	29.3	8.1	37.5	33.9
Provigjione (neto)	0.6	0.6	1.2	5.7
për kreditë	0.0	0.8	0.8	7.3
për mjete të tjera financiare	0.6	(0.2)	0.4	(1.6)
Zëra të jashtëzakonshëm	(0.9)	(0.7)	(1.6)	(1.3)
Taksa mbi të ardhurat	3.4	-	3.4	2.6
Rezultati neto	7	14.7	21.6	16.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, edhe shpenzimet e veprimtarisë u rritën me 10% në rreth 38 miliardë lekë, ndërkohë që kostot e veprimtarisë vijojnë të mbulohen në mënyrë të përshtatshme nga të ardhurat e bankave. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave u rrit lehtë në nivelin 60% si pasojë e rritjes më të madhe në vlerën e shpenzimeve në krahasim me atë në të ardhura. Pavarësisht rritjes në të ardhurat nga interesat, marzhi neto nga interesat qëndroi thuajse i pandryshuar në 3.4% për shkak të rritjes me po të njëjtën masë në aktivet mesatare që sjellin të ardhura.

Grafik 48. Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 49. ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rënia e fortë në shpenzimet për provigjione për kredi gjatë vitit 2021 ndikoi dukshëm në rritjen e fitimit të bankave. Këto shpenzime ishin disa herë më të ulëta në krahasim me shpenzimet e regjistruara gjatë vitit 2020 dhe të krahasueshme me nivelet e raportuara gjatë viteve 2017-2019. Për vitin 2021, shpenzimet për provigjione për kreditë ishin më pak se 1 miliardë lekë. Gjatë vitit 2020, për shkak të vështirësive të lidhura me kufizimet në aktivitetin e njësive tregtare dhe konsumatorëve, këto shpenzime u rritën ndjeshëm në 7 miliardë lekë, duke qenë të krahasueshme me vlerën e shpenzimeve të bankave për pagesat e interesit. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2021 bankat kanë raportuar rreth 2 miliardë lekë më shumë shpenzime për provigjionimin e mjeteve të tjera financiare.

Grafik 50. Tregues të përfitueshmërisë dhe shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhës, rritja e rezultatit neto dhe zhvillimet e përgjithshme pozitive në përfitueshmërinë e sektorit bankar vendas janë vërejtur kryesisht në aktivitetin në lekë, ndërsa në aktivitetin bankar në valutë janë regjistruar ndryshime të

vogla. Për aktivitetin në lekë, bankat kanë regjistruar rritje të ndjeshme të të ardhurave neto nga interesat dhe jo nga interesat dhe ulje të konsiderueshme të shpenzimeve për provigjione.

4.1.1.4 Kredia

Stoku i kredisë bankare është zgjeruar gjatë periudhës, si pasojë e ecurisë së mirë të kredisë së re. Rritja më e lartë është regjistruar në kredinë për bizneset, kredinë në valutë dhe atë afatshkurtër. Fshirja e kredive me probleme nga bilancet e bankave ka vijuar me ritme më të ulëta.

Rritja e kredisë për bizneset lidhet me zgjerimin e kredisë afatshkurtër.
Rritja e kredisë për individët lidhet me zgjerimin e kredisë për konsum mallrash dhe për blerje pasurish të paluajtshme.

Peshën kryesore në kredinë për biznese, e zë kredia për investime në pasuri të paluajtshme dhe ajo për blerje pajisjesh, me nga 30%. Në kredinë për individë, peshën kryesore e zë kredia për blerje pasurish të paluajtshme me gati 70%.

Në vitet e fundit, shtesa e kredisë për pasuri të paluajtshme për individët është përdorur në masë mbizotëruese në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit.

Stoku i kredisë së dhënë nga bankat është zgjeruar me ritme të shpejta gjatë periudhës. Teprica e kredisë në fund të periudhës, arriti në 670 miliardë lekë, duke qenë përkatësisht 7% dhe 10% më e lartë se gjashtë muaj dhe një vit më parë. Ndikimin kryesor në zgjerimin e stokut të kredisë gjatë periudhës e ka dhënë shtesa nga kredia e re, e cila gjatë periudhës ishte rreth 40% më e madhe në krahasim me kredinë e re të regjistruar gjatë gjysmës së parë të vitit. Kredia e re është akorduar kryesisht për sektorin e biznesit dhe për qëllime afatshkurtra. Të gjitha llojet e kredisë sipas afatit, maturitetit dhe subjektit, kanë shënuar rritje gjatë periudhës. Rritja më e madhe është regjistruar në portofolin e kredisë në valutë (10%), kredisë për bizneset (6%) dhe kredisë afatshkurtër (15%). Ndryshimi vjetor në stokun e kredisë në valutë ishte 12%. Duke përjashtuar efektin statistikor të kursit të këmbimit, që ishte negativ për 6 miliardë lekë, ky ndryshim do të ishte 14%.

Tabelë 7. Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës

	Mld lekë	Pesha (%)		Ndryshimi (%)	
	12/21	12/21	12/20	6 -mujor	Vjetor
Lek	328	49	50	4	8
Valutë	343	51	50	10	12
Sektori publik	26	4	3	70	29
Biznese	422	63	64	6	8
Individë	223	33	33	6	12
Afatshkurtër	170	25	25	15	10
Afatmesme	99	15	15	3	5
Afatgjatë	403	60	59	6	12
Kredia	671	100	100	7	10

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 51. Ecuria e kredisë sipas sektorëve, kontribut në p.p., ndryshime gjashtëmujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave ka vijuar edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit, por vlera e kredive të humbura të fshira nga bilancet[25] ishte më e vogël në krahasim me atë të fshirjeve të realizuara gjatë periudhave të mëparshme. Gjatë gjithë vitit 2021 janë fshirë rreth 4 miliardë lekë kredi të humbura dhe 70% e këtij vëllimi iu përket kredive të marra nga bizneset vendase në monedhë të huaj. Vlera e kredive të fshira vitin e fundit ishte sa 10% e tepricës së përgjithshme të kredive me probleme në portofolin e bankave në fund të muajit dhjetor 2021, ndërkohë që për vitin 2020 ky raport ishte i barabartë me 6%. Nëse në tepricën e kredisë, përveç efektit statistikor të kursit të këmbimit, do të përfshihej edhe stoku i kredive të fshira gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, rritja vjetore e kredisë do të ishte 12% nga 10%.

[25] *Rreth 3 miliardë lekë.*

Grafik 52. Ndryshimi 6-mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Kredia në lekë dhe kredia në valutë me dhe pa efektin e kursit të këmbimit, ndryshim vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – BIZNESI

Kredia për subjektet rezidente përfaqëson 95% të tepricës së kredisë bankare dhe gjatë periudhës u zgjerua me 7%. Kredia për bizneset rezidente që zë rreth 60% të totalit të kredisë për rezidentët, arriti nivelin prej 400 miliardë lekësh në fund të vitit dhe rritja gjatë periudhës ishte rreth 20 miliardë lekë ose me 5%. Në rritjen e kredisë për bizneset rezidente, kontributin kryesor e ka dhënë zgjerimi i stokut të kredive për qëllime afatshkurtra. Krahasuar me një vit më parë, teprica e kredisë për bizneset është zgjeruar me 7%, dhe në këtë rritje ndikimin kryesor e kanë dhënë rritja në stokun e kredisë 'Overdraft' dhe kredisë për blerje pajisjesh.

Grafik 54. Ecuria vjetore e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës (2016=100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Peshën kryesore të kredisë për bizneset rezidente e zënë kredia për investime në pasuri të paluajtshme dhe ajo për blerje pajisjesh me nga 30% të stokut të përgjithshëm. Kredia për këto qëllime është lëvruar kryesisht në monedhë të huaj. Për kredinë me maturitet afatshkurtër që përdoret kryesisht për blerje pajisjesh dhe si kapital qarkullues, bizneset vijojnë të preferojnë huamarrjen në monedhën vendase.

Rritja e tepricës së kredisë gjatë periudhës është vënë re në të tre portofolet e kredisë sipas madhësisë të biznesit. Pavarësisht se rritja më e madhe relative është regjistruar në portofolin e kredisë së akorduar për biznesin e mesëm, kontributin kryesor në rritjen e tepricës së kredisë për bizneset vijon ta japë kredia për biznesin e madh[26]. Për sektorët e biznesit të mesëm dhe të madh vërehet një ulje në peshën e kredisë afatgjatë dhe rritje e peshës së kredisë afatshkurtër, ndërkohë që për biznesin e mesëm, bankat raportojnë një tkurrje të stokut të kredisë afatmesme dhe rritje të tepricës së kredisë afatshkurtër dhe asaj afatgjatë. Bankat sistemike kanë akorduar rreth 70% të kredisë për bizneset.

KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – INDIVIDËT DHE SEKTORI PUBLIK

Kredia për individët rezidentë u zgjerua me 6% gjatë periudhës. Rritjen më të shpejtë dhe kontributin më të madh në ecurinë pozitive të kredisë për individët, e kanë pasur kredia për blerje pasurish të paluajtshme (hipotekare) dhe ajo për konsum mallrash jo të qëndrueshëm. Kredia për këto kategori u zgjerua me përkatësisht 6.5% dhe 5.6% gjatë periudhës. Peshën kryesore, me rreth 70%, në portofolin e kredisë për individët vijon ta zërë kredia për blerje pasurie të paluajtshme. Që nga fundi i vitit 2016 deri në fund të vitit 2021 stoku i kësaj kredie është zgjeruar me rreth 40%. Në rritjen e shpejtë të stokut të kredisë për individët gjatë viteve të fundit, ka ndikuar rritja e shpejtë e stokut të kredisë në lekë, ndërkohë që kredia për individët në monedhë të huaj ka pasur luhatje të vogla, dhe në fund të vitit 2021 qëndronte vetëm pak mbi nivelin e pesë viteve më parë.

Rreth 65% e të gjithë stokut të kredisë për individët është dhënë për individë në qarkun e Tiranës. Në vend të dytë renditet qarku i Durrësit me 7%, ndërsa Vlora, Fieri, Elbasani dhe Shkodra kanë nga 3% të stokut të përgjithshëm të kredisë për individët. Pesha e qarkut të Tiranës është edhe më e madhe në stokun e kredisë për pasuri të paluajtshme ose kredisë hipotekare, pasi për këtë ndarje të kredisë për individët, qarku i Tiranës zë rreth 70% të vlerës së përgjithshme të kredisë hipotekare për individët në rang vendi.

Pothuajse e gjithë shtesa në stokun e kredisë hipotekare për individët që nga fundi i vitit 2015 lidhet me zgjerimin prej rreth 60% dhe 20% në stokun e kësaj pjese të kredisë për qarkun e Tiranës dhe atë të Durrësit. Kredia hipotekare për individët e regjistruar në qarqet e tjera gjatë kësaj periudhe, ka mbetur

[26] *Portofoli i kredisë për biznesin e madh, të mesëm dhe të vogël u rrit me përkatësisht 8, 7 dhe 3 miliardë lekë gjatë periudhës.*

e pandryshuar ose është tkurrur. Pesha e madhe dhe rritja e shpejtë e kredisë hipotekare për individët në qarqet Tiranë dhe Durrës lidhet me migracionin nga qarqet e tjera drejt këtyre dy qarqeve, si edhe me zhvillimet e dhjetëvjeçarit të fundit në tregun e pasurive të paluajtshme, si rritja e vëllimit të ndërtimit, zgjerimi i sipërfaqeve të ndërtuara, rritja e cilësisë dhe rritja e çmimeve të pronave të paluajtshme.

Grafik 55. Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës (indeks, 2016 = 100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 56. Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe qarqeve (Dhjetor 2021)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për korporatat jofinanciare publike vijon të zërë një peshë të vogël në totalin e kredive për rezidentët (4%), megjithatë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, stoku i saj pothuajse është dyfishuar.

KREDIA PËR SUBJEKTET JOREZIDENTE

Stoku i kredisë për subjektet jorezidente është zgjeruar me rreth 20% gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021 dhe me 40% krahasuar me një vit më parë. Në fund të muajit dhjetor, kredia për jorezidentët ishte rreth 27 miliardë lekë dhe zinte rreth 4% të tepricës së kredisë së sektorit bankar, nga 3.2% një vit më parë. Kontributin kryesor në zgjerimin e kredisë për jorezidentët e ka dhënë rritja në stokun e kredisë për bizneset, kredisë në monedhë të huaj dhe kredisë afatgjatë. Këto janë njëkohësisht kategoritë me peshën më të madhe në stokun e kredisë për subjektet jorezidente.

KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

Ritmet e rritjes së kredisë së pambrojtur në valutë dhe pesha e saj në raport me kredinë e përgjithshme në valutë janë dy nga treguesit që monitorohen në vazhdimësi si tregues sinjalizues të rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Stoku i kredisë së pambrojtur në valutë ka rënë lehtë gjatë periudhës, duke arritur në nivelin më të ulët të regjistruar që prej vitit 2011[27]. Rënia e stokut të kredisë së

Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë ka rënë lehtë gjatë periudhës. Si rezultat, pesha e kredisë së pambrojtur në valutë ndaj kredisë në valutë dhe tepricës së përgjithshme të kredisë, ka shënuar rënie.

Pjesa më e madhe e kredisë së pambrojtur përfaqësohet nga kredia për bizneset në monedhën euro dhe ajo për investime në pasuri të paluajtshme.

[27] *Rreth 130 miliardë lekë.*

pambrojtur dhe rritja e stokut të kredisë në valutë bënë që pesha e kredisë së pambrojtur ndaj tepricës së kredisë në valutë të binte nga 41% në 37% gjatë periudhës. Edhe pesha e kredisë së pambrojtur ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë ra me 2 pikë përqindje në nivelin 19%. Peshën kryesore të kredisë së pambrojtur (64%) e zë kredia për bizneset, e cila gjatë periudhës ka rënë lehtë, kryesisht për shkak të tkurrjes së portofolit të kredive me probleme në euro.

Në të njëjtën kohë, kredia e pambrojtur për individët u rrit me 4% gjatë gjysmës së dytë të vitit, prej rritjes së kredisë për investime në pasuri të paluajtshme. Pavarësisht kësaj ecurie, duke qenë së kredia e pambrojtur për individët ka vetëm 34% të peshës së kredisë së pambrojtur, ndikimi i rritjes së këtij portofoli në ecurinë e stokut të përgjithshëm të kredisë së pambrojtur ishte i kufizuar. Pjesa kryesore e tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë përbëhet nga kredia në euro (rreth 90%) dhe stoku i këtij portofoli ka shënuar rënie gjatë periudhës. Në terma vjetorë, kredia e pambrojtur në valutë u tkurr me 1%, kryesisht si pasojë e rënies së kredisë së pambrojtur për bizneset dhe kredisë në monedhën euro.

Grafik 57. Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 58. Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj



Burimi: Banka e Shqipërisë

Kredia e pambrojtur e dhënë për investime në pasuri të paluajtshme vijon të mbajë peshën kryesore (rreth 54%) të totalit të kredisë së pambrojtur në valutë, pasuar nga kredia për tregti (me 25%). Pjesa tjetër e kredisë së pambrojtur në valutë është dhënë për zhvillim biznesi, për konsum, për qeverinë dhe për qëllime të tjera. Zhvillimet në ecurinë e stokut të kredisë së pambrojtur gjatë periudhës janë ndikuar nga tkurrja e kredisë së pambrojtur për zhvillim biznesi dhe asaj të dhënë për qëllime të tjera.

Kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme është dhënë për blerje të pasurive të paluajtshme rezidenciale, komerciale dhe për blerje toke, dhe gjatë periudhës ka shënuar rritje të lehtë. Peshën kryesore të saj vijon ta zërë kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme rezidenciale dhënë individëve (50%), që u rrit me 3% gjatë periudhës, dhe dha kontributin kryesor në ecurinë e kredisë së pambrojtur për pasuri të paluajtshme për periudhën.

KREDIA E RE DHE KREDIA E RISTRUKTURUAR

Kredia e re e dhënë gjatë periudhës ishte rreth 160 miliardë lekë. Kjo vlerë ishte rreth 40% më shumë në krahasim me kredinë e re të raportuar nga bankat gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit dhe 6% mbi vlerën e regjistruar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020. Rritja e fluksit të kredisë së re është vërejtur si për kredinë në lekë, ashtu edhe për atë në valutë. Kontributin kryesor në rritjen e fluksit të kredisë së re e ka dhënë sektori i bizneseve, i cili ka tërhequr rreth 55% më shumë kredi në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Pjesa kryesore (70%) e këtij fluksi është marrë nga bizneset për qëllime afatshkurtra, si kredi – kufi dhe kredi për kapital qarkullues. Më shumë se gjysma e kredisë së re për bizneset është dhënë në monedhën evropiane. Kredia e re për individët ishte rreth 8% më e madhe në krahasim me një gjashtëmujor më parë dhe rritja lidhet me faktin që bankat kanë dhënë më shumë kredi të re për blerje banesash dhe për konsum të mallrave jo të qëndrueshme. Kredia e re për blerje banesash, në mënyrë të ngjashme me raportin për tepricën e kredisë, ishte sa 50% e kredisë së re të dhënë për individët gjatë periudhës. Rritje e konsiderueshme është regjistruar edhe në kredinë e re për individët në monedhën vendase, që zinte rreth 70% të kredisë së re për sektorin e individëve.

Kredia e re e dhënë gjatë periudhës ishte 40% më e madhe në krahasim me fluksin e gjashtëmujorit të parë të vitit. Kjo kredi është përqendruar në sektorin e biznesit, ka shkuar kryesisht për qëllime afatshkurtra, dhe është lëvruar në monedhë vendase dhe të huaj. Kredia e re për individët është përdorur kryesisht për blerje banesash.

Kredia e ristrukturuar gjatë periudhës, ishte sa ¼ e kredisë së ristrukturuar për vitin 2021, dhe u përqendrua tek kredia për individët, ajo në valutë dhe kredia për tregti.

Kredia e ristrukturuar gjatë vitit 2021 ishte rreth 30 miliardë lekë ose sa 11% e fluksit vjetor të kredisë së re. Sipas raportimit të bankave, rreth 76% e vëllimit të ristrukturimit është realizuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2021. Portofolet e prekura më shumë nga ristrukturimi i kredisë ishin portofoli i kredisë për individët, kredisë për sektorin e tregtisë dhe kredisë së dhënë në monedhë të huaj.

Grafik 59. Kredia e re për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës ka rënë. Kjo rënie është vërejtur në normat e peshuara të interesit të kredisë për individë dhe ka përfshirë kredinë në valutë dhe kredinë në lekë.

Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës[28] ishte 4.8% në fund të vitit dhe ra me 0.2 pikë përqindje krahasuar me një gjashtëmujor më parë. Rënia e normës së peshuar të interesit ka ndodhur kryesisht në tremujorin e katërt të vitit dhe është vërejtur kryesisht në normat për kredinë dhënë individëve dhe ato për kredinë në valutë (Euro dhe USD). Norma e interesit për kreditë e reja në lekë vijon të shënojë nivele më të larta sesa norma e interesit për dy monedhat e tjera (Euro dhe USD) dhe kjo normë interesi është luhatur rreth nivelit 5.8% gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Norma e interesit për kreditë e reja në lek ka ardhur në rënie gjatë vitit 2021 dhe vlera mesatare e normës në muajin dhjetor të vitit 2021 ishte 0.3 pikë përqindjeje më pak sesa një vit më parë. Norma e interesit për kredinë e re për individët vijon të mbetet më e lartë në krahasim me atë të kredisë për bizneset, megjithatë gjatë vitit 2021 është vënë re një rënie e konsiderueshme e kësaj norme. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, kjo normë është luhatur rreth një niveli mesatar prej 5.4% dhe kjo vlerë ishte rreth 0.3 pikë përqindjeje më e ulët nga norma mesatare e kredisë për individët një vit më parë. Norma mesatare e kredive të reja për sektorin e biznesit ka ardhur në rënie gjatë pesë viteve të fundit, por gjatë muajve të fundit të vitit 2021, bankat kanë raportuar një rritje të lehtë të saj në krahasim me nivelin e raportuar në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit.

Grafik 60. Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja, në %: norma e agreguar (majtas), norma sipas monedhës (në mes), norma sipas subjektit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[28] *E llogaritur si mesatare gjashtëmujore.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4. KREDIA E RISTRUKTURUAR GJATË VITIT 2021

Vlera e kredisë së ristrukturuar gjatë vitit 2021 ishte rreth 30 miliardë lekë, nga të cilat 7 miliardë lekë ishin kreditë e ristrukturuara gjatë gjysmës së dytë të vitit. Në pjesën më të madhe të rasteve (77%) ristrukturimi është realizuar me kërkesë të klientit. Kredia e ristrukturuar gjatë këtij viti ishte sa 4% e tepricës së përgjithshme të kredisë dhe sa 77% e stokut të kredive me probleme, ndërkohë që kreditë e ristrukturuara zinin rreth 80% të portofolit të kredisë së klasifikuar si "kredi në ndjekje". Gjysma e kredisë së ristrukturuar është kredi e marrë nga bizneset, kryesisht ato të mesme. Në tepricën e kredisë së marrë nga bizneset, kredia e ristrukturuar gjatë vitit 2021 zë rreth 3%, ndërkohë që kredia e ristrukturuar për individët ishte sa 7% e tepricës së kredisë për sektorin e individëve.

Nga sektorët e ekonomisë sipas llojit të aktivitetit prodhues, sektori i tregtisë është sektori që ka paraqitur kërkesën më të lartë për ristrukturim kredish. Bizneset kredimarrëse nga sektori i tregtisë kanë ristrukturuar rreth 5% të stokut të përgjithshëm të kredisë dhe kredia e ristrukturuar për këtë sektor ishte sa rreth 24% e gjithë vëllimit të kredive të ristrukturuara nga sektori bankar gjatë vitit 2021. Rreth 80% e vëllimit të ristrukturimeve nga bizneset e tregtisë është kryer kryesisht në portofolin e kredive të klasifikuara si kredi "në ndjekje". Kërkesë për ristrukturim nga sektori i tregtisë ka pasur edhe për kredinë e klasifikuar "të humbur", e cila zë 11% të ristrukturimeve të kryera për sektorin e tregtisë).

Dy sektorë të tjerë me peshë të konsiderueshme në vëllimin e kredive të ristrukturuara gjatë vitit 2021 ishin sektori i industrisë (8%) dhe ai i ndërtimit (5%), të cilët kanë edhe peshën më të madhe në stokun e kredive me probleme pas sektorit të tregtisë. Kredia e ristrukturuar për këta sektorë ishte rreth 14 miliardë lekë ose sa 14% e kredisë së përgjithshme të ristrukturuar gjatë vitit. Gjatë vitit 2021, pesha e kredive me probleme të mbajtura nga biznese në sektorin e industrisë ra nga 28% në 20% të stokut të përgjithshëm të kredive me probleme, për shkak të tkurrjes me rreth 50% të tepricës së kredive me probleme të këtij sektori.

Rreth 90% e vlerës së kredive të risktrukturuara përfaqësohet nga kredi në monedhë të huaj. Kreditë e prekura nga ristrukturimi kanë qenë në pjesën më të madhe kredi të klasifikuara si kredi standarde dhe kredi në ndjekje, ndërkohë që janë ristrukturuar edhe kredi të klasifikuara si kredi me probleme. Kredia standarde zë peshën kryesore në stokun e kredive të ristrukturuara, por vëllimi i kredive të ristrukturuara ishte sa vetëm 2% e tepricës së kredive standarde. Për klasën e kredive "në ndjekje" ristrukturimet gjatë vitit 2021 ishin sa 30% e stokut të kredisë. Vlera e ristrukturimeve për kreditë me probleme ishte relativisht e ulët (rreth 11 miliardë lekë), por si peshë ndaj tepricës së kredive me probleme, ky vëllim ishte i konsiderueshëm (rreth 30%).

Format kryesore të ristrukturimit të përdorura nga bankat janë: zgjatja e afatit të maturimit, kapitalizimi i interesit dhe/ose kamatëvonesave, ndryshim i principalit, dhe caktimi i një periudhe faljeje për principalin ose interesin e kredisë. Mbi 40% e kredisë së ristrukturuar është kryer në formën e zgjatjes së afatit të maturimit. Pjesa tjetër është kryer duke ndryshuar principalin (30%), nëpërmjet kapitalizimit të interesit dhe/ose kamatëvonesave (13%), si dhe duke falur për një periudhë kohe principalin ose interesin (10%).

Tabelë 8. Të dhëna mbi kredinë e ristrukturuar gjatë viteve 2020 dhe 2021

	12/20	12/21	Pesha*		12/20	12/21	Pesha*
Pesha në kredinë e ristrukturuar				Pesha në kredinë e ristrukturuar			
Subjekti				Forma e ristrukturimit			
Individët	11	50	7	Zgjatja e afatit të maturimit	62	43	
Bizneset	89	50	3	Kapitalizimi i interesit dhe/ose kamatëvonesave	10	13	
I madh	58	15	2	Ndryshimi i frekuencës së pagesës	3	1	
I mesëm	9	28	8	Ndryshimi principalit	12	30	
I vogël	21	7	2	Periudhë falje principali/ interesi	11	10	
				Transferimi i kredisë tek një kredimarrës tjetër		2	
Monedha				Të tjera	3	2	
Lek	25	11	1				
Valutë	75	89	8				
Klasa				Sektorët e ekonomisë			
Standard	54	35	2	Tregtia, riparimi i automjeteve	14	24	5
Në ndjekje	23	27	30	Ndërtimi	4	5	3
Nënstandard	7	7	22	Industria	41	8	4
E dyshimtë	7	14	51	Energji, gaz, ujë	5	0	0
E humbur	8	16	24	Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	2	0	1
Destinacioni				Hotelet dhe restorantet	11	4	4
Kredi biznesi	90	50		Të tjera	11	8	4
Kredi hipotekare	6	23					
Kredi konsumatore	4	27		Kredia e ristrukturuar (fluks, mld lekë)	20.9	29.1	4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Pesha në tepricën e kredisë së raportuar në dhjetor 2021.*

Zgjerimi i stokut të depozitave gjatë periudhës ishte gati dy herë më i lartë se rritja e tyre në gjashtëmujorin e parë të vitit. Rritja e fortë e depozitave është mbështetur nga rritja në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në valutë. Pesha e depozitave me afat ndaj stokut të depozitave ka vijuar të bjerë, në favor të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat.

Depozitat e bizneseve janë kryesisht llogari rrjedhëse dhe depozita pa afat, dhe janë të balancuara sipas monedhës. Depozitat e individëve vijojnë të dominojnë depozitat e përgjithshme dhe janë kryesisht depozita me afat. Pesha e depozitave në valutë të individëve ka ardhur në rritje.

Normat e interesit nuk kanë shënuar ndryshime të ndjeshme gjatë periudhës por patën një prirje të lehtë për rritje gjatë fundit të periudhës.

4.1.1.5 Depozitat

Gjatë periudhës, depozitat u zgjeruan me rreth 100 miliardë lekë dhe në fund të vitit shënonin 1,430 miliardë lekë. Rritja më e fortë është regjistruar në llogaritë rrjedhëse, depozitat e individëve dhe depozitat në valutë, ndërkohë që edhe depozitat në lekë dhe depozitat e bizneseve shënuan rritje të konsiderueshme. Edhe depozitat me afat kanë pasur një prirje për rritje gjatë kësaj periudhe. Në krahasim me nivelin e regjistruar në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, depozitat ishin rreth 7% më të larta, ndërkohë që rritja vjetore arriti në 11%. Pesha e depozitave me afat ndaj stokut të përgjithshëm të depozitave ka vijuar të bjerë, në favor të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat. Shpërndarja e depozitave sipas valutës vijon të jetë e balancuar, por gjatë vitit 2021 është vënë re një rritje e lehtë e peshës së depozitave në valutë, të cilat në fund të vitit ishin sa 52% e stokut të përgjithshëm të depozitave. Depozitat e individëve vijojnë të zënë rreth 80% të totalit të depozitave, ndërkohë që struktura e tyre sipas afatit dhe valutës është përgjithësisht e balancuar. Në depozitat e sektorit të bizneseve dominojnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në valutë. Normat e interesit të depozitave në lek dhe në euro vijojnë të ruajnë nivele të ulëta dhe nuk kanë shënuar ndryshime të dukshme gjatë periudhës.

Si depozitat në lekë, ashtu edhe ato në valutë kanë shënuar rritje gjatë periudhës, por rritja dhe kontributi i depozitave në valutë ishte rreth dy herë më shumë në krahasim me depozitat në lekë. Gjashtëmujori i dytë i vitit 2021 shënoi një nga rritjet më të forta në nivelin e depozitave në valutë të 10 viteve të fundit. Normat gjashtëmujore dhe vjetore të ndryshimit të depozitave në valutë ishin përkatësisht 10% dhe 14%. Në fund të vitit, stoku i depozitave në euro ishte 5.33 miliardë euro nga 4.75 miliardë euro që ishte vlera e regjistruar në fund të vitit 2020, ndërkohë që shtesa gjatë gjysmës së dytë të vitit ishte 580 milionë euro. Rritja e fortë e depozitave në euro gjatë periudhës lidhet me rritjen e hyrjeve valutore neto në bilancin e pagesave, rritjen e kredisë dhe rritjen e lehtë të normave të interesit gjatë muajve të fundit të vitit.

Grafik 61. Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontributi në normën vjetore të ndryshimit)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 9. Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës

	12/21		12/21 ndaj 06/21		V/V
	Mld lekë	Pesha	(%)	(p.p.)	(%)
Ll. rrjedhëse	590	41	12	5	19
Pa afat	191	14	7	1	14
Me afat	619	43	2	1	3
S. publik	45	3	32	1	37
Biznese	241	17	18	3	25
Individë	1,147	80	4	4	8
Lek	690	48	5	2	8
Valutë	743	52	10	5	14
Stoku i depozitave	1,433	100	7	7	11

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lëvizjet në kursin e këmbimit të lekut ndaj monedhave euro dhe USD nuk kanë dhënë ndikim të dukshëm në ndryshimin e depozitave në valutë të shprehura në Lek. Shpërndarja e depozitave sipas afatit, monedhës dhe sektorit institucional nuk ka shënuar ndryshime të dukshme gjatë periudhës, por peshat e llogarive rrjedhëse, depozitave të bizneseve dhe depozitave në valutë janë rritur lehtë në krahasim me një vit më parë. Në fund të vitit 2021, llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat përbënin përkatësisht 41%, 14% dhe 43% të depozitave nga 39%, 13% dhe 47% një vit më parë. Sektori i individëve vijon të zotërojë pjesën dërrmuese të depozitave, me 80% të totalit, por kjo peshë ka rënë lehtë për shkak të rritjes së shpejtë në depozitat e sektorit të bizneseve.

Grafik 62. Ecuria e depozitave në lekë dhe në euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 63. Struktura e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e depozitave sipas monedhës ka ndryshuar lehtë në favor të monedhave të huaja në raportin 48% /52% për ndarjen lek/valutë, si pasojë e rritjes së fortë në depozitat në valutë.

Depozitat e bizneseve vijojnë të dominohen nga llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat dhe shpërndarja sipas valutës e këtyre depozitave është pothuajse e balancuar. Në depozitat e bizneseve, depozitat me afat kanë një peshë pothuajse të papërfillshme, duke qenë se pjesa dërrmuese e llogarive të bizneseve me bankat përdoret për mbështetjen e aktiviteteve dhe nevojave të tyre operacionale dhe jo si instrumente të mirëfillta kursimi. Në portofolin e individëve, depozitat me afat përfaqësojnë rreth 60% të të gjitha depozitave të këtij sektori. Depozitat me afat të individëve mbahen kryesisht në monedhën vendase, ndërkohë që llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat

Grafik 64. Depozitat sipas afatit dhe valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 65. Depozitat sipas afatit dhe sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

janë në monedha të huaja (euro dhe USD). Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit është vënë re një rritje e lehtë e depozitave me afat të sektorit të individëve të denominuara kryesisht në monedhë të huaj.

Normat e interesit për të gjitha llojet e depozitave sipas afatit dhe valutës, mbeten në nivele të ulëta dhe nuk kanë shënuar ndryshime të forta gjatë periudhës. Normat e interesit për depozitat e reja me afat në lekë kanë shënuar një rritje të lehtë ndaj nivelit mesatar të gjashtëmujorit të parë dhe atij të gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar dhe në fund të vitit 2021 janë luhatur rreth vlerës 0.7%. Edhe për depozitat me afat në euro është vërejtur një rritje e lehtë e normës së interesit në 0.3%, nga 0.2% dhe 0.15% në dy gjashtëmujorët paraardhës. Pavarësisht se mbeten në nivele shumë të ulëta, normat e interesit për depozitat në euro janë më të lartat e regjistruara në 5 vitet e fundit.

4.1.2 RREZIQET E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT BANKAR

4.1.2.1 Rreziku i kredisë

Cilësia e kredisë është përmirësuar dukshëm gjatë periudhës. Në përmirësimin e cilësisë së kredisë, kontributin kryesor e ka dhënë zvogëlimi i stokut të kredisë në klasat e kredive 'nënstandard' dhe 'të humbura'. Rolin më të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së kredisë e ka pasur procesi i riklasifikimit të kredive me probleme në klasa performuese, si edhe ai i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Raporti i kredive me probleme (RKP) ra me 1.5 pikë përqindjeje, në nivelin 5.6% në fund të vitit. Stoku i kredive me probleme u zvogëlua me rreth 7 miliardë lekë dhe në fund të vitit shënonte rreth 40 miliardë lekë. Në tkurrjen e stokut të kredive me probleme, sipas madhësisë së kontributit kanë ndikuar ristrukturimi i një pjese të kredive me probleme, fshirja e kredive të humbura nga bilancet e bankave dhe zvogëlimi i fluksit të kredive performuese që kanë kaluar në klasat e kredive me probleme. Vëllimi i shlyerjeve në klasat e kredive me probleme gjatë periudhës ishte i krahasueshëm me atë të gjashtëmujorit të parë të vitit. Në krahasim me një vit më parë, bankat kanë raportuar përmirësim të cilësisë së kredisë kryesisht për kredinë me maturitet afatgjatë, kredinë për biznese dhe kredinë në valutë. Gjatë periudhës janar 2015 – dhjetor 2021, bankat kanë fshirë nga bilancet e tyre rreth 70 miliardë lekë kredi të humbura. Nga kjo vlerë, gjatë vitit 2021, vlera e kredive të humbura të fshira nga bilancet e bankave ishte vetëm 4 miliardë lekë dhe kreditë ishin kryesisht kredi në monedhën euro të mbajtura nga sektori i biznesit.

Gjatë periudhës, raporti i kredive me probleme vijoi rënien, duke arritur në 5.6% në fund të vitit. Ky përmirësim është vënë re në të gjitha llojet e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës.

Tkurrja e ndjeshme e stokut të kredive me probleme lidhet me hyrjet më të pakta të kredive të reja me probleme, riklasifikimin e kredive me probleme në klasa më të mira, si edhe fshirjet e kredive të humbura.

Përmirësimi i cilësisë së kredisë konfirmohet edhe nga tregues të tjerë plotësues.
Krijimi i provigjioneve për rrezikun e kredisë, ka qenë më pak se në periudhat e mëparshme. Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme u ngjit në nivelin 69%.

Brenda portofolit të kredive me probleme, bankat kanë raportuar rënie të tepricës për të gjitha klasat e kredive me probleme, por për shkak të rënies më të madhe në stokun e kredive të dyshimta dhe atyre në ndjekje, pesha e kredive të humbura ndaj tepricës së kredive me probleme u rrit në 52% nga 46% një vit më parë. Në krahasim me një vit më parë, cilësia e kredisë është përmirësuar kryesisht për kreditë me maturitet afatgjatë, kreditë për bizneset dhe kreditë në valutë. Këto portofole të kredisë kanë në të njëjtën kohë vlerat më të larta të

raportit të kredive me probleme. Në fund të vitit 2021, raportet e kredive me probleme për kredinë për biznese, kredinë në valutë dhe kredinë afatgjatë ishin përkatësisht 6.6%, 5.7% dhe 5.5%.

Bankat kanë vijuar të krijojnë provigjione (rezerva) për kreditë me probleme, por niveli i provigjioneve ka ardhur duke u zvogëluar, në mënyrë të ngjashme me stokun e kredive me probleme. Duke qenë se zvogëlimi i stokut të kredive me probleme ishte më i madh në krahasim me pakësimin e fondit të provigjioneve gjatë vitit 2021, raporti i mbulimit të kredive me probleme me provigjione u rrit në 69% nga 65% që ishte niveli i regjistruar në fund të vitit 2020.

Grafik 66. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 67. Kontributi në ndryshimin gjashtëmujor të stokut të kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerësimi i cilësisë së kredisë dhe rrezikut të kredisë mund të plotësohet nëpërmjet analizës së ecurisë së disa treguesve plotësues të cilësisë së kredisë si norma e prurjeve të kredive me probleme[29], norma e dështimit[30] dhe norma e kredive me probleme të rikuperuara[31]. Sipas të dhënave deri në fund të dhjetorit të vitit 2021, fluksi i kredive të reja me probleme ishte sa 1.5% e kredive të rregullta dhe kjo vlerë ishte nën vlerën e llogaritur në fund të gjashtëmujorit të parë dhe në fund të vitit 2020. Ky tregues ka shënuar vlerën maksimale prej 5% gjatë vitit 2019, dhe një rritje të përkohshme deri në nivelin 3% gjatë gjysmës së parë të vitit 2021. Nga ana tjetër, norma e dështimit që tregon shpejtësinë me të cilën akumulohen kreditë e humbura në krahasim me portofolin e përgjithshëm të kredisë, arriti në nivelin 1.6% në fund të vitit nga 2.6% në fund të gjashtëmujorit të parë. Gjithashtu, norma e rikuperimit të kredive me probleme arriti në 15%, nga 7% gjashtë muaj më parë.

[29] *Fluksi i ri i kredive me probleme gjatë periudhës ndaj tepricës së kredive të rregullta në fund të periudhës.*

[30] *Fluksi i ri i kredive të humbura gjatë një viti ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë në fund të periudhës.*

[31] *Fluksi i ri i kredive me probleme që kanë kaluar në klasat performuese gjatë një viti ndaj tepricës së kredive me probleme në fund të periudhës.*

Kjo ecuri tregon përmirësim të ndjeshëm të aftësisë së bankave për të rikuperuar kreditë me probleme. Gjatë katër viteve të fundit, norma e rikuperimit sugjeron që bankat e kanë përmirësuar mbledhjen e kredive me probleme që nga mesi i vitit 2018 deri në fund të vitit 2019 dhe gjatë gjithë vitit 2021, dhe kanë hasur vështirësi në këtë proces gjatë pjesës së parë të vitit 2018 dhe gjatë gjithë vitit 2020. Të tre treguesit plotësues të cilësisë së kredisë sugjerojnë se gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, sektori bankar ka regjistruar më pak kredi të reja me probleme dhe ka qenë më i suksesshëm në përmirësimin e cilësisë së kredisë për stokun ekzistues të kredive me probleme.

Grafik 68. Norma e prurjeve të kredive me probleme dhe norma e falimentit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 69. Norma e kredive me probleme të rikuperuara



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Cilësia e kredisë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit është përmirësuar dukshëm në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të kaluar dhe një vit më parë. RKP për këtë portofol të kredisë ra në 4.7% në fund të dhjetorit 2021, në krahasim me 6.2% dhe 7.1% gjashtë muaj dhe një vit më parë. Në përmirësimin e cilësisë së kredisë së pambrojtur ka ndikuar pakësimi në stokun e kredive me probleme për investime në pasuri të paluajtshme dhe kredisë për tregti.

Peshën kryesore[32] në tepricën e kredive me probleme të pambrojtur nga luhatjet e kursit të këmbimit vijon ta mbajë kredia për investime në pasuri të paluajtshme, dhe RKP për këtë kategori kredie ra në rreth 6.7% nga 7.9% një vit më parë. Ecuri pozitive është regjistruar për të gjitha llojet e kredisë së pambrojtur, por rënien më të shpejtë të RKP-së e regjistroi kredia për tregti. RKP për këtë lloj kredie ra me 5.2 pikë përqindje gjatë vitit 2021, në nivelin e ulët prej 1.7% në fund të vitit. Edhe portofolet e tjera të kredisë së pambrojtur sipas qëllimit të përdorimit kanë regjistruar përmirësim të cilësisë gjatë vitit të fundit. RKP për kredinë për zhvillim biznesi ra në 6.2% nga 7.8% dhe ai për kredinë për qëllime konsumi ra lehtë në nivelin 3.4%.

Cilësia e kredisë së dhënë nga bankat vendase për jorezidentët, e cila përfaqësohet nga kredi të marra nga bizneset në monedhën euro, vijon të jetë e mirë dhe është përmirësuar gjatë periudhës. RKP për këto subjekte ra pranë nivelit 0.3%, ndërkohë që në fund të vitit 2020 ky raport shënonte 1.7%.

[32] *Rreth 76% të totalit.*

Grafik 70. RKP-ja për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 71. RKP-ja për kredinë e pambrojtur sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Masa e mbulimit të kredive me probleme me fonde rezervë u zgjerua me 1 pikë përqindje në krahasim me qershorin 2021 dhe 3.4 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, në 69% si pasojë e rënies më të shpejtë në stokun e kredive me probleme në krahasim me tkurrjen e fondeve rezervë. Raporti i provigjionimit për bankat individuale luhatet midis intervalit 56% dhe 80%. Mbulimi me kapital i kredive me probleme neto[33] u ngjit në 14 herë nga 11.1 herë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2021. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rënia në kredinë me probleme neto[34]. Në fund të vitit 2021, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë shënoi 1.8%.

Mbulimi me kolateral[35] i kredisë, që përfaqëson një element kritik në bashkësinë e instrumenteve mbrojtëse të sektorit bankar nga rreziku i moskthimit të huave, ka regjistruar rritje të lehtë gjatë periudhës. Ky raport vijon të ruajë nivele të larta, çka tregon që bankat kanë hapësira të mjaftueshme për të administruar rrezikun e moskthimit të kredisë. Raporti i mbulimit me kolateral u zgjerua me rreth 0.3 pikë përqindjeje gjatë periudhës, duke arritur në nivelin 80.2%. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë peshën kryesore, ose rreth 65% të kredisë së kolateralizuar dhe 52% të tepricës së kredisë. Stoku i kësaj lloj kredie u zgjerua me rreth 7% krahasuar me një vit më parë.

Cilësia e kredisë për kategoritë e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme është përmirësuar ndjeshëm vitin e fundit. Nivelin më të ulët të RKP-së vijon ta mbajë kredia e kolateralizuar me para në dorë, ndërkohë që pesha e stokut të kredive me probleme për këtë lloj kredie në totalin e kredive me probleme është shumë e ulët. Teprica e kredisë së pakolateralizuar, gjithashtu është zgjeruar gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, pesha e kredisë së pakolateralizuar ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë, vijon të luhatet rreth të njëjtit nivel (20%). Cilësia e kredisë për këtë kategori

33 *Kreditë me probleme pas zbritjes së provigjioneve.*

34 *Si rrjedhojë e rënies së tepricës së kredive me probleme neto me gati 17%, raporti "kredi me probleme neto/kapitali rregullator" ra në 7.1% nga 9% që shënonte në fund të muajit qershor 2021.*

35 *Kolateral në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), para në dorë etj.*

është përmirësuar vitin e fundit, por niveli i RKP-së vijon të shënojë vlera më të larta se kategoritë e tjera, me një nivel prej rreth 8% të raportuar në fund të vitit 2021.

Grafik 72. Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme, sipas llojit të kolateralit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.2.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit në aktivitetin e sektorit bankar mbetet i kontrolluar dhe disa nga treguesit sinjalizojnë zbutje të lehtë të këtij rreziku gjatë periudhës. Treguesit kryesorë të likuiditetit për monedhën vendase dhe të huaj vijojnë të jenë dukshëm mbi kufijtë minimalë të përcaktuar nga aktet rregullative. Ashtu si në gjashtëmujorin e kaluar, sektori bankar nuk raportoi linja financimi nga grupet zotëruese. Hendeku i përgjithshëm midis aktiveve dhe pasiveve sipas maturitetit të mbetur ka mbetur pothuajse i pandryshuar, në rreth 5% të aktiveve të përgjithshme të sektorit bankar, por rritja e depozitave me afat ka rezultuar në një ngushtim të lehtë të këtij hendeku për shportën e maturimit deri në 3 muaj. Ecuri e qëndrueshme është vënë re edhe në diferencën midis maturitetit mesatar të kredive dhe depozitave, e cila ka mbetur e pandryshuar gjatë gjysmës së parë të vitit dhe ka shënuar një rënie të lehtë gjashtë gjashtëmujorit të dytë të vitit.

Aktivet likuide të sektorit bankar janë rritur më shpejt në krahasim me aktivet e përgjithshme dhe me detyrimet e tyre afatshkurtra. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të bankave mbeten depozitat, të cilat mbulojnë mbi dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në fund të periudhës, raporti "hua/depozita" ishte 46.8%, dhe mbeti i pandryshuar nga gjashtë muaj më parë, pasi huatë dhe depozitat e përgjithshme kanë shënuar ritme të ngjashme rritjeje. Rritja e depozitave në monedhën vendase ka qenë më e fortë sesa rritja e stokut të kredisë në lekë, gjë që ka çuar në rënien e lehtë të raportit "hua/depozita" për lekun në 47.5%, nga 47.8% në fund të muajit qershor të vitit 2021. Raporti "hua/depozita" në valutë u rrit lehtë në 46.1% nga 45.9%.

Rreziku i likuiditetit vlerësohet i ulët. Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivele të mira dhe treguesit e likuiditetit, sipas monedhave vijojnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë rregullativë.

Për afatet e shkurtra të maturimit, hendeqet midis aktiveve dhe detyrimeve mbeten në vlera të dukshme negative. Megjithatë, këto hendeqe mbulohen nga prania e bollshme e aktiveve likuide. Diferenca midis afatit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve, është rritur lehtë gjatë periudhës.

Depozitat vijojnë të mbulojnë më shumë se dy herë vlerën e kredive, në lek dhe në valutat kryesore.

Gjatë periudhës, aktivet likuide të sektorit bankar u shtuan me 30 miliardë lekë dhe në fund të vitit arritën në nivelin 590 miliardë lekë. Raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve në bilancet e bankave vijon të mbetet i lartë. Në fund të vitit 2021, vlera e tij ishte 34.4% nga 34.1% në fund të gjashtëmujorit të parë. Kjo ecuri reflekton rritjen me ritme më të larta të aktiveve likuide në bilancet e bankave në krahasim me rritjen e aktiveve të përgjithshme. Në të njëjtën mënyrë, për shkak të rritjes më të shpejtë të aktiveve likuide kundrejt detyrimeve afatshkurtra, raporti i aktiveve likuide ndaj tyre u rrit me rreth 0.2 pikë përqindjeje gjatë periudhës, në nivelin 46.7%.

Grafik 73. Diferenca në maturimin mesatar të mbetur midis aktive-pasive dhe kredi-depozita



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 74. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*



*Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur, në raport me totalin e aktiveve në afatin e shkurtër, vijon të mbetet i lartë, por shënoi një rënie të lehtë gjatë periudhës. Hendeku mes aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur për periudhën deri në 3 muaj,[36] që vijon të paraqitet si hendeku më i madh negativ për të gjithë horizontin e maturiteteve, u zvogëlua në 23%, nga 27% ndaj aktiveve të përgjithshme gjashtë muaj më parë. Në të njëjtën kohë, një rritje në madhësi të ngjashme është regjistruar në hendekun negativ për maturitetin 3 muaj deri në 1 vit, megjithatë në raport me aktivet e përgjithshme madhësia e këtij hendeku mbetet e kufizuar pranë një vlere mesatare prej 5%. Hendeku i përgjithshëm për të gjitha maturitetet vijon të jetë pozitiv dhe nuk ka shënuar ndryshime të dukshme ndaj periudhave të mëparshme, për shkak të qëndrueshmërisë në pozicionet pozitive për maturitetet më afatgjata. Ky hendek prej 3 vitesh është luhatur rreth nivelit 5% të aktiveve të sektorit bankar.

Gjatë periudhës është vërejtur një rritje e lehtë në diferencën midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve, si pasojë e rritjes më të lartë të maturitetit

[36] *I llogaritur si raporti i 'diferenca midis aktiveve dhe pasiveve' ndaj 'totalit të aktiveve' për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.*

mesatar të aktiveve ndaj maturimit të pasiveve. Në fund të periudhës, kjo diferencë ishte rreth 25.5 muaj, nga 25 muaj në fund gjashtëmujorit të kaluar. Maturiteti i mbetur i depozitave, të cilat përfaqësojnë kategorinë më të rëndësishme të detyrimeve, është rritur nga 7.3 në 7.7 muaj, si pasojë e rritjes së lehtë të stokut të depozitave me afat. Maturiteti i mbetur i kredisë shënoi një rënie të lehtë në 50.5 muaj.

4.1.2.3 Rreziqet e tregut

RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Treguesi i pozicionit të hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator është ngjitur në 9.2% gjatë periudhës dhe shpreh rritje të ekspozimit të drejtpërdrejtë të bilancit të bankave ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Megjithatë, ky tregues mbetet poshtë niveleve më të larta të regjistruara gjatë periudhave të mëparshme dhe është tre herë më i ulët nga kufiri i sipërm rregullator prej 30%. Ky konstatim vlen edhe për treguesit e agreguar për bankat sistemike dhe për bankat josistemike, të cilët në fund të vitit shënuan përkatësisht 11% dhe 0.8%.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit është shtuar gjatë periudhës, por mbetet ndjeshëm nën kufirin rregullator. Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka shënuar rënie.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur me treguesin e mospërputhjes valutore[37] ka rënë lehtë gjatë periudhës. Treguesi i mospërputhjes valutore në fund të vitit ishte sa 15.4% e aktiveve të sektorit bankar. Aktivet dhe detyrimet e bankave në valutë u rritën me përkatësisht 10% dhe 9% ndaj nivelit të gjashtë muajve më parë, ndërsa kredia për subjektet rezidente në valutë u rrit me 7%. Indeksi i përgjithshëm vijon të dominohet nga nënindeksi në monedhën evropiane, që ka rënë lehtë në nivelin 15.8% të aktiveve në fund të periudhës.

Grafik 75. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin bankar dhe grupet



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 76. Ecuria e përbërësve të indeksit për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[37] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të pasiveve në valutë të sektorit bankar, me aktivet në valutë, të netuar me kredinë në valutë për rezidentët. Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Metodologjia e llogaritjes së treguesit të mospërputhjes është publikuar në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

Në ecurinë e indeksit të mospërputhjes valutore, kontributin kryesor vijon ta japë grupi i bankave sistemike. Për këtë grup bankash, rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit ra me rreth 1 pikë përqindje ndaj nivelit të gjashtë muajve dhe një viti më parë. Në fund të periudhës, indeksi për bankat sistemike ishte sa 11.6% e aktiveve nga niveli 12.4% në periudhën e mëparshme dhe 12.2% para një viti. Sipas monedhave, kontributi kryesor vjen nga indeksi në monedhën euro i cili është sa 12.1% e aktiveve ose diçka më pak nga niveli prej 12.5% i vlerësuar gjashtë muaj më parë. Indeksi i mospërputhjes valutore për bankat josistemike ka vlera dukshëm më të larta nga indeksi i bankave sistemike dhe është rritur lehtë gjatë periudhës, duke arritur në nivelin 26.8% në fund të vitit. Në krahasim me një vit më parë, ky indeks ka shënuar rënie të lehtë.

Grafik 77. Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 78. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të normës së interesit ka shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës, por mbetet dukshëm nën kufirin e sipërm të përcaktuar nga kuadri rregullator.

Sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në lekë, ato me normë interesi fikse dhe për maturitetin afatgjatë.

RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të normës së interesit u rrit lehtë gjatë gjysmës së dytë të vitit, megjithatë treguesi i ekspozimit qëndron dukshëm nën kufirin e sipërm rregullator prej 20%, duke treguar që ekspozimi në nivel sektori është i moderuar. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës në fund të vitit ishte sa 5.9% e kapitalit rregullator, dhe kjo vlerë ishte pak më e lartë në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë fikse interesi (FIR) ishte sa 4.1% e kapitalit rregullator të sektorit, ose diçka më shumë nga vlera e regjistruar gjashtë muaj dhe një vit më parë[38]. Treguesi për aktivet dhe pasivet me normë të ndryshueshme interesi (VIR) ishte sa 1.8% e kapitalit rregullator dhe ra lehtë ndaj nivelit të fundit të gjashtëmujorit të parë të vitit. Pozicioni total neto për të dyja grupet e bankave sipas rëndësisë u rrit me 0.3 pikë përqindje gjatë periudhës. Bankat sistemike kanë një ekspozim më të vogël sesa grupi i bankave josistemike duke qenë se treguesit e pozicionit neto për secilin grup kanë përkatësisht vlerat 5.5% dhe 7.4%.

[38] *Përkatësisht 3.2% dhe 2.6%.*

Sipas grupeve të bankave, bankat sistemike kanë mbajtur një ekspozim pozitiv ndaj luhatjes së normave variabël të interesit (VIR), ndërkohë që kanë mbyllur gradualisht ekspozimin negativ[39] ndaj luhatjes së normave fikse të interesit (FIR), e cila prej rreth 2 vitesh regjistronte vlera pozitive. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2021, ekspozimi ndaj luhatjeve për normat e ndryshueshme të interesit (VIR) për bankat sistemike ishte sa 2.1% e kapitalit rregullator, ose 1 pikë përqindjeje nën nivelin e gjashtë muajve më parë. Për të njëjtën periudhë, ekspozimi ndaj luhatjeve të normave fikse të interesit (FIR) u rrit lehtë duke arritur në 3.4% të kapitalit rregullator të bankave sistemike. Bankat e tjera (josistemike), në përgjithësi kanë ekspozim më të lartë në aktive dhe pasive me normë fikse interesi (FIR), dhe ky pozicion gjatë periudhës u zgjerua me 0.5 pikë përqindje duke arritur në 6.7% të kapitalit rregullator në fund të muajit dhjetor. Ekspozimi në aktive dhe pasive me normë të ndryshueshme interesi (VIR) për bankat e tjera është pozitiv, por është luhatur vazhdimisht rreth një mesatareje prej 1% gjatë gjithë viteve të fundit.

Grafik 79. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 80. Ecuria sipas grupeve e pozicionit neto për normat fikse (FIR) dhe variabël (VIR) të interesit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sipas monedhave, kontributin kryesor në vlerën e pozicionit neto të peshuar për sektorin bankar vijon ta japë pozicioni neto në monedhën vendase, që në fund të vitit ishte sa 2.8% e kapitalit rregullator. Ekspozimi i aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj luhatjeve të normave të interesit në euro është më i kufizuar në krahasim me ekspozimin në lekë duke qenë se treguesi përkatës në fund të periudhës ishte 2%. Pavarësisht se ekspozimi në monedhën USD është mjaft më i vogël në krahasim me ekspozimin në euro dhe lekë, ky ekspozim ka dhënë kontributin kryesor në rritjen e pozicionit të përgjithshëm gjatë periudhës dhe lidhet me zgjerimin me 0.4 pikë përqindje të pozicionit në USD të bankave sistemike në nivelin 1.6% të kapitalit rregullator. Për grupin e bankave të tjera, treguesi i përgjithshëm ka pasqyruar rritjen e treguesit të pozicionit në euro deri në 2.5% dhe rënien e treguesit të pozicionit në lekë deri në 5.4%, ndërkohë që treguesi i pozicionit në dollarë amerikanë nuk shënoi ndryshime nga periudhat e mëparshme.

[39] *Pasive më të larta se sa aktivet me normë fikse interesi.*

Sipas afatit të maturimit, ndryshimi në pozicionin e përgjithshëm neto është ndikuar kryesisht nga rritja e ekspozimit pozitiv në shportën me maturitet afatgjatë, treguesi për të cilën u rrit në 10.5% të kapitalit rregullator nga 9% gjashtë muaj dhe 8% një vit më parë. Pozicioni për instrumentet me maturitet afatshkurtër mbeti pozitiv, por u tkurr në 0.5% nga 1.6% gjashtë muaj më parë. Për instrumentet me maturitet afatmesëm detyrimet e ndjeshme ndaj luhatjes së normës së interesit janë më të larta sesa mjetet, çka rezulton në një pozicion neto të peshuar negativ. Në fund të vitit, ky pozicion ishte sa 5.1% e kapitalit rregullator të bankave, duke qenë pak më i lartë ndaj nivelit të një viti më parë.

Grafik 81. Hendeku sipas grupeve dhe monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 82. Pozicioni neto i peshuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreziku i tërthortë ndaj ndryshimit të normave të interesit[40] shfaqi prirje rënëse gjatë gjysmës së dytë të vitit. *Spread*-i i përgjithshëm midis normave të peshuara të interesit të kredisë dhe depozitave në fund të vitit shënoi vlerën 4.1%, dhe kjo vlerë ishte më e ulët në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Kontributin kryesor në këtë rënie e dha rënia e *spread*-it për monedhën euro me 0.6 dhe 1.3 pikë përqindje në krahasim me vlerën e gjashtë muajve dhe një viti më parë. Kjo ecuri lidhet me rënien më të fortë të normës së interesit të kredisë në krahasim me normën e depozitave për këtë monedhë.

[40] *Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit jep tek klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ tek aftësia paguese e huamarrësve të bankës, kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i tërthortë).*

Grafik 83. Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave dhe *spread* i normave të interesit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 84. Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në p.p.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 5. EKSPOZIMI I SEKTORIT BANKAR NDAJ VENDEVE TË PËRFSHIRA NË AGRESIONIN USHTARAK NË UKRAINË

Në vijim të agresionit ushtarak rus në Ukrainë dhe sanksioneve që po ndërmarrin vendet e Perëndimit ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë, kemi vlerësuar ndikimin e mundshëm të këtyre zhvillimeve ndaj bankave që operojnë në Shqipëri. Ky ndikim do të kishte si kanal transmetimi, ekspozimet eventuale ndaj subjekteve ruse, ukrainase apo edhe bjelloruse.

Ekspozimi mund të konceptohet në këto forma: a) prania e bankave me kapital rus, bjellorus apo ukrainas në Shqipëri; b) prania e aktiveve (investime) apo burimeve (detyrime) që mbahen në bilancin e një banke që operon në Shqipëri, ndaj subjekteve ruse, bjelloruse apo ukrainase; c) prania e degëve apo filialeve të bankave që veprojnë në vendin tonë, në Rusi, Ukrainë apo Bjellorusi; d) ndërlidhja për shkak të marrëdhënieve të pronësisë me banka ose institucione të tjera financiare që kanë ekspozime në Rusi, Bjellorusi apo Ukrainë, në formën e shkronjës b) ose c). Për sa më sipër, Banka e Shqipërisë vlerëson që:

a) në Shqipëri nuk veprojnë banka me kapital që kontrollohet nga subjekte juridike apo fizike me origjinë ruse, bjelloruse apo ukrainase;

b) mbështetur në të dhënat e plota të raportuara nga bankat deri në fund të janarit 2022 dhe në vijim të komunikimeve operative të ditëve të fundit, rezulton që sektori bankar kishte një ekspozim në anën e aktivit të bilancit, i cili llogaritet sa 0.34% e vlerës së aktiveve të sektorit bankar ose 3.4% e vlerës së kapitalit aksionar. Provigjionimi eventual i kësaj vlere nga ana e sektorit bankar, nuk ndikon në mënyrë të rëndësishme gjendjen e kapitalit dhe atë të likuiditetit të sektorit bankar. Asnjë bankë që operon në Shqipëri nuk ka detyrime të përfillshme ndaj subjekteve ruse, bjelloruse apo ukrainase;

c) bankat që operojnë në Shqipëri nuk kanë degë apo filiale të tyre në Rusi, Bjellorusi apo Ukrainë;

d) disa nga grupet bankare evropiane që kanë filiale në Shqipëri, kanë degë apo filiale në Rusi, Bjellorusi apo Ukrainë, ekspozime të bilancit apo marrëdhënie pronësore me subjekte fizike dhe juridike ruse.

Së pari, duhet theksuar që aktualisht gjendja financiare e këtyre grupeve bankare evropiane është mjaft e mirë, duke ofruar një rezistencë të fortë ndaj goditjeve eventuale që burojnë nga struktura e grupit.

Së dyti, struktura e kapitalit të këtyre grupeve bankare evropiane nuk duket se paraqet ndonjë varësi kritike ndaj aksionarëve me origjinë ruse apo bjelloruse. Instrumentet në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse evropiane mundësojnë ndryshimin e shpejtë të strukturës së aksionarëve në rast nevoje dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit.

Së treti, gjatë muajit mars 2022, vetë grupet bankare kanë dhënë vlerësime lidhur me ndikimet që mund të rrjedhin nga luftimet në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj subjekteve ruse apo bjelloruse. Me gjithë vështirësitë objektive për të zhvilluar veprimtarinë në Ukrainë, grupet bankare vlerësojnë se ndikimi negativ është aktualisht i përballueshëm. Arsyet lidhen kryesisht me vlerat e ulëta të ekspozimit neto të bilancit, mungesës së një ndërlidhjeje të rëndësishme duke qenë se filialet e zonës së konfliktit mbështeten thelbësisht në burimet vendase dhe veprimeve korrektuese që grupet bankare kanë ndërmarrë deri tani.

Për bankat që operojnë në Shqipëri dhe që janë filiale të këtyre grupeve bankare, ndikimet që mund të rrjedhin nga struktura e grupit vlerësohen të kufizuara. Këto banka janë të mirëkapitalizuara, gjenerojnë fitim, janë likuide dhe mbështeten në burime financiare të subjekteve juridike dhe fizike shqiptare.

Në tërësi, vlerësohet se bankat që veprojnë në Shqipëri nuk pritet të ndjejnë një ndikim të rëndësishëm nga zhvillimet në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj subjekteve juridike e fizike ruse dhe bjelloruse. Gjithsesi, situata është ende duke u zhvilluar dhe Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar maksimalisht për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të zhvillimeve mbi sektorin bankar. Në këtë proces, është vendosur një komunikim i afërt jo vetëm me bankat por edhe me autoritetet e tjera publike në vend, me institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Vlerësojmë se kuadri i instrumenteve monetare, prudenciale dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, mbetet i përshtatshëm për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar.

4.1.3 USHTRIMET E PROVËS SË REZISTENCËS

Ushtrimi i provës së rezistencës shërben për të përcaktuar nëse bankat janë të kapitalizuara në mënyrë të mjaftueshme për të përballuar goditje të supozuara përtej një situate normale. Ky lloj ushtrimi njihet edhe si ushtrimi "për vlerësimin e aftësisë paguese". Nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës për aftësinë paguese, vlerësohen rreziqet kryesore të bilancit të sektorit bankar, siç janë: rreziku i kredisë, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziqet indirekte të kredisë nëpërmjet kreditimit në valutë dhe ndryshimit të normave të interesit. Për ushtrimin e provës së rezistencës të aftësisë paguese, është zbatuar një metodologji e re, për të cilën është punuar prej më shumë se një viti dhe që është verifikuar paraprakisht për dy tremujorë radhazi. Vlerësojmë se kjo metodologji, e cila është realizuar me mbështetjen e ekspertëve të huaj, ofron disa përparësi ndaj metodologjisë ekzistuese pasi

mundëson thellimin e analizës për shkak të një cilësie më të mirë të të dhënave, përdorimit të metodave më analitike në vlerësimin e rreziqeve, kombinimit më të mirë të moduleve përbërëse, dhe një paraqitjeje vizuale më të kuptueshme të rezultateve, me përfundime që vlerësohen më realiste dhe më pranë pritjeve të ekspertëve.

Ushtrimi i provës së rezistencës për rrezikun e likuiditetit kryhet me periodicitet vjetor dhe ofron informacion mbi rezistencën e bankave individuale dhe sektorit bankar për të përballuar goditje të mundshme të formës së mungesës së likuiditetit për të gjitha monedhat dhe për monedha të veçanta brenda një horizonti kohor dyvjeçar.

4.1.3.1 Ushtrimi i provës së rezistencës së aftësisë paguese

Ushtrimi përmban tre skenarë, që janë: bazë, i moderuar dhe i rënduar. Periudha e ushtrimit shtrihet deri në fund të vitit 2023.

Skenari bazë supozon një normë rritjeje ekonomike pozitive për periudhën ushtrimore. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me një rritje të ndjeshme të kreditimit dhe një përmirësim të cilësisë të portofolit të kredisë, bazuar edhe në procesin e fshirjeve të pritshme të kredive të humbura nga portofoli i bankave. Në terma të rrezikut të tregut, në këtë skenar është konsideruar edhe rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit dhe të vendosjes. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike vlerësohet pozitive përgjatë periudhës ushtrimore, por me një normë rritjeje më të ulët; ndërsa në kuadër të rivlerësimit të letrave me vlerë, në këtë skenar janë rivlerësuar vetëm letrat e investimit. Në skenarin e rënduar supozohet një normë rritjeje pozitive në fundin e vitit të parë ushtrimor, ndjekur nga një tkurrje ekonomike. Gjithashtu, në të tre skenarët është marrë në konsideratë pezullimi i shpërndarjes së dividendëve nga ana e bankave[41], deri në fund të vitit 2022.

Rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës për aftësinë paguese, për periudhën 2022 – 2023, tregojnë se sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj goditjeve të mundshme makroekonomike, por banka të veçanta mund të kenë nevojë të forcojnë pozicionet e tyre të kapitalit.

Ushtrimi i provës së rezistencës për rrezikun e likuiditetit për të njëjtën periudhë, tregon se në fund të vitit 2021 bankat zotëronin një nivel më të lartë aktivesh likuide të zgjeruara që mund të likuidojnë në rastin e stresit të likuiditetit dhe se rezistenca e tyre është përmirësuar në krahasim me një vit më parë.

Grafik 85. Projeksionet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[41] *Sipas vendimit nr. 6, datë 2.2.2022 të Këshillit Mbikëqyrës "Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat".*

Supozimeve për ecurinë më të dobët ekonomike në skenarin e moderuar dhe në atë të rënduar, i mbivendoset nënçmimi i kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritja e normave të interesit dhe ulja e ritmit të kreditimit, deri në një mungesë të kredidhënies. Këto zhvillime reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë, si për bizneset, ashtu edhe për individët.

Grafik 86. Projeksionet mbi treguesit e rinj makroekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, parashikimet për treguesit e rinj makroekonomikë të përfshirë në ushtrim, tregojnë një rënie të çmimeve të banesave përgjatë vitit 2022 në skenarët më të pafavorshëm, si edhe një rritje të normës së papunësisë. Këto supozime ndikojnë në një përkeqësim të treguesve të kapitalizimit për banka të veçanta dhe për sektorin bankar në tërësi, kryesisht gjatë vitit 2023.

Grafik 87. Projeksionet mbi portofolin e kredisë sipas modeleve përkatëse për bizneset dhe individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:

- Në skenarin bazë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar rritet në 21.9% në fund të vitit 2022 dhe 21.5% në fund të vitit 2023. Këto zhvillime tregojnë një qëndrueshmëri dhe nivele të larta të kapitalizimit për të gjithë sektorin bankar. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë kërkesat rregullative shtesë sipas bankave individuale, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali gjatë periudhës kohore ushtrimore. Numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara për këtë skenar është pesë deri në fund të vitit 2023, duke përbërë 17.2% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 3.5 miliardë lekë.

- Në skenarin e moderuar, RMK për sektorin bankar ulet lehtësisht në nivelin prej 17.5% në fund të vitit 2022 dhe 16.2% në fund të vitit 2023. Bazuar në rezultatet e përftuara, për banka të veçanta evidentohet nevoja për injektim kapitali në fund të periudhës ushtrimore. Më konkretisht, numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara shkon deri në tetë në fund të vitit 2023, duke përbërë 54.2% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 16.6 miliardë lekë.

- Edhe në skenarin e rënduar, sektori bankar mbetet i kapitalizuar, por RMK bie nga niveli 18.3% në fund të vitit 2022 ne nivelin 15.3% në fund të vitit 2023.

Grafik 88. Ecuria e vlerave të RMK-së përgjatë harkut kohor ushtrimor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 89. Kontributi në ndryshimin e RMK i zërave kryesorë të bilancit për skenarin e rënduar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 90. Kontributi në RMK për skenarin e rënduar, për Bankat me Rëndësi Sistemike - BARS (majtas) dhe Banka të Tjera (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 91. Kontributi në RMK për skenarin e rënduar, Bankat me Kapital të Huaj (majtas) dhe Vendas (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontribut kryesor në rënien e kapitalizimit për këtë skenar paraqet kryesisht humbja nga huatë dhe nga të ardhurat e tjera neto. Numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara për këtë skenar është shtatë në fund të vitit 2023, duke përbërë 48.7% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 20.1 miliardë lekë.

Bankat sistemike (BARS) në tërësi paraqesin një nivel të qëndrueshëm kapitalizimi prej 17% në fund të vitit 2023 për skenarin e rënduar, ndërkohë që grupi i bankave të tjera paraqitet i nënkapitalizuar, me një normë prej 10.6%. Diferenca midis këtyre dy grupeve vjen nga një kontribut më i ulët i humbjeve nga huatë dhe nga të ardhurat e tjera neto për BARS, si edhe nga një fitim i pashpërndarë më i lartë për këtë grup bankash. Grupi i bankave me kapital të huaj paraqet një nivel të mirë kapitalizimi prej 17% në fund të vitit 2023 për skenarin e rënduar, ndërkohë që grupi i bankave me kapital vendas shënon një normë prej 11.6%. Diferenca midis grupeve vjen nga një kontribut më i lartë i

humbjeve nga huatë dhe nga rënia e të ardhurave të tjera neto për bankat me kapital vendas.

Në përfundim të ushtrimit vlerësohet se analiza tregon që sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike, por banka të veçanta paraqesin ndjeshmëri të lartë ndaj skenarëve të supozuar. Në kushte të skenarëve me ekstremitet më të lartë, nevojat e injektimit të kapitalit arrijnë një peshë maksimale prej rreth 0.8% të PBB-së, në fund të vitit 2023 në skenarin më të rënduar.

Grafik 92. Nevojat për kapital shtesë ndaj PBB-së*



*Këtu nuk përfshihen shtesat makroprudenciale.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.3.2 Ushtrimi i provës së rezistencës së likuiditetit

Prova e rezistencës së likuiditetit ka për qëllim të vlerësojë aftësinë e bankave individuale dhe të sektorit bankar në përgjithësi për t'iu bërë ballë goditjeve ekstreme, por të mundshme, në financimin e veprimtarisë së tyre. Këto prova synojnë të evidentojnë dobësi apo mangësi të sektorit dhe bankave të veçanta në monedha, instrumente dhe horizonte të caktuara kohore; të vlerësojnë gatishmërinë e bankave për të përballuar skenarë ekstremë të mungesës së likuiditetit; si edhe të ndihmojnë autoritetin mbikëqyrës për ndërmarrjen e politikave të posaçme që adresojnë menaxhimin e likuiditetit, duke përfshirë masat që synojnë uljen e ekspozimeve ose krijimin e rezervave specifike. Prova e rezistencës së likuiditetit realizohet sipas përqasjes "nga lart – poshtë" me të dhëna të raportuara nga bankat një herë në vit në fund të vitit. Ushtrimi përdor të dhëna mbi flukset e parashikuara hyrëse dhe dalëse të parasë sipas instrumenteve kryesore dhe për një horizont kohor të përbërë nga 8 shporta maturimi që mbulojnë intervalin nga "deri në 1 ditë" deri në "mbi 1 vit dhe deri në 2 vjet".

Prova kryhet për monedhat Lek, Euro dhe USD dhe mbështetet në kushtin që tepricat e likuiditetit në një monedhë nuk mund të përdoren për të plotësuar mungesën e likuiditetit në monedhat e tjera, për shkak të probabilitetit të zhvlerësimit të shpejtë të kursit të këmbimit gjatë krizave të likuiditetit. Në situata reale, ky nuk është një element kufizues. Për llogaritjen e hendekut të likuiditetit përdoren koeficientë të përcaktuar për tërheqjet e burimeve të financimit (të depozitave) dhe për riinvestimin e aktiveve (kredive) sipas të gjitha shportave të maturimit. Për burimet e financimit, koeficienti tregon vetëm atë pjesë të shumës së detyrimeve që maturohet në shportën përkatëse, e cila do të tërhiqet dhe nuk do të riinvestohet nga klienti. Për hyrjet e parasë, koeficientët e riinvestimit nënkuptojnë atë pjesë të shumës së të drejtave që maturohen në shportën përkatëse, e cila do të konvertohet në fluks hyrës parash dhe nuk do të riinvestohet nga banka. Një bankë konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara, që shiten me

marzhe reduktuese të përcaktuara nga ushtrimi, bien deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

4.1.4.2 Rezultatet

Rezultatet e ushtrimit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit sipas të dhënave të muajit nëntor 2021, për horizontin kohor 2022-2023, vlerësohet e mirë dhe nuk ka shënuar ndryshime të ndjeshme në krahasim me një vit më parë. Hendeku i përgjithshëm i likuiditetit është zgjeruar lehtë për të tri monedhat, por rezistenca e bankave për të përballuar një goditje ndaj likuiditetit është forcuar në krahasim me një vit më parë. Ruajtja e rezistencës së sektorit bankar për të përballuar goditjet e mundshme të likuiditetit lidhet me faktin që bankat në fund të vitit 2021 zotëronin një nivel më të lartë kapacitetesh kundërpeshuese ose aktivesh likuide të zgjeruara që mund të likuidojnë në rastin e krizave të likuiditetit. Zgjerimi në kapacitetet kundërpeshuese lidhet me rritjen e aktiveve të bankave në formën e letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë Shqiptare në Euro dhe bankave qendrore të huaja në monedhat Euro dhe USD.

Situata e përgjithshme e likuiditetit të sektorit bankar sipas hyrjeve dhe daljeve të pritura të parasë për horizontin kohor nga 1 ditë deri në dy vjet, duke filluar nga data 1 dhjetor e vitit 2021, rezulton të jetë disi më sfiduese në krahasim

Grafik 93. Diferenca midis flukseve hyrëse dhe dalëse sipas shportave të maturimit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 94. Flukset e përgjithshme hyrëse dhe dalëse dhe kapacitetet kundërpeshuese



Burimi: Banka e Shqipërisë

me një vit më parë. Flukset e pritura hyrëse dhe dalëse rezultojnë përkatësisht 4% më pak dhe 9% më shumë sesa ato të një viti më parë, dhe diferenca e thjeshtë midis hyrjeve dhe daljeve është rreth 30% më e madhe. Diferencat më të mëdha negative midis hyrjeve dhe daljeve vijojnë të regjistrohen në shportat "deri në 1 ditë", "1-2 muaj" dhe "6-12 muaj", ndërkohë që për shportën

"1-2 vjet" diferenca midis hyrjeve dhe daljeve vijon të ketë vlerë pozitive, duke reflektuar maturitetin më të gjatë të aktiveve në krahasim me maturitetin e pasiveve të bankave.

Zgjerimi i hendekut të likuiditetit vërehet në të tri monedhat (Lek, Euro, USD), por rritja më e madhe vërehet në pozicionin në monedhën vendase, pasi për këtë monedhë, sektori bankar pret njëkohësisht rënie të flukseve hyrëse dhe rritje të flukseve dalëse. Flukset e pritura hyrëse dhe dalëse në monedhën euro janë më të larta në krahasim me ato të raportuara një vit më parë, por rritja në flukset dalëse është më e madhe sesa rritja në flukset hyrëse.

Rezistenca e bankave ndryshon sipas monedhave dhe konsiderohet si 'shumë e mirë' për monedhat lek dhe dollar amerikan dhe 'e mirë' për monedhën euro. Për monedhën vendase, bankat kanë përgjithësisht një hendek më të madh negativ midis hyrjeve dhe daljeve në krahasim me monedhën euro, por aktivet likuide që bankat mund të përdorin për të mbuluar hendekun e likuiditetit në monedhën lek janë disi më të larta në krahasim me ato në euro. Numri i bankave që nuk e kalojnë provën për secilën monedhë dhe madhësia e hendekut të mbetur në raport me aktivet e sektorit bankar janë të krahasueshme me vlerat e llogaritura një vit më parë. Numri i bankave që kanë hendek të thjeshtë negativ të likuiditetit për secilën nga monedhat, përpara përdorimit të kapaciteteve kundërpeshuese është rritur në krahasim me një vit më parë.

Tabelë 10. Rezultatet e provës për hendekun e thjeshtë sipas monedhave dhe shportave

	(11 banka)	<1 ditë	1 ditë - 1 javë	1 javë - 1 muaj	1muaj - 2 muaj	2muaj - 3 muaj	3muaj - 6 muaj	6muaj - 1 vit	1 vit - 2 vjet
Lek	Nr. i bankave me hendek negativ	11	10	10	10	8	3	2	1
	Hendeku si % e aktiveve	-4	-6	-6	-5	-3	-1	-1	-1
Euro	Nr. i bankave me hendek negativ	7	6	7	7	7	6	7	7
	Hendeku si % e aktiveve	-2	-2	-2	-3	-3	-2	-3	-2
USD	Nr. i bankave me hendek negativ	4	4	2	2	3	3	3	3
	Hendeku si % e aktiveve	-1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	-1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Numri maksimal i bankave që kanë hendek negativ të paktën në një shportë për monedhat Lek, Euro dhe USD është përkatësisht 10, 7, dhe 4, ndërkohë që një vit më parë këto vlera ishin përkatësisht 10, 5 dhe 4. Vlera maksimale e hendekut të likuiditetit në raport me aktivet e sektorit bankar në monedhën përkatëse lëviz nga një vlerë pothuajse e papërfillshme për monedhën USD, në 3% për monedhën Euro dhe në 6% për monedhën Lek. Nga skenari që supozon përdorimin e kapaciteteve kundërpeshuese për mbylljen e hendekut në secilën shportë, rezulton se numri maksimal i bankave që vijojnë të kenë hendek negativ në të paktën një shportë është 1, 3 dhe 1 për aktivitetin në Lek, Euro dhe USD. Në krahasim me rezultatet e një viti më parë, vërehet se sektori bankar ka një përmirësim të lehtë në rezistencën në monedhën euro, duke qenë se për këtë monedhë numri i bankave dhe hendeku negativ

Të gjitha segmentet e tjera të sistemit financiar kanë regjistruar zgjerim të aktivitetit dhe rritje të rezultatit financiar gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Kjo pjesë e sistemit financiar vijon të mbetet e mirëkapitalizuar dhe me një cilësi të mirë të portofolit të kredisë për institucionet krediduese, me përjashtim të segmentit të jobankave që kanë raportuar rritje të raportit të kredive me probleme.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë, por ka ardhur në rënie gjatë periudhës.

i mbetur në raport me aktivet e bankës janë zvogëluar. Në përmirësimin e rezistencës në monedhën euro ka ndikuar zgjerimi me rreth 30% i kapaciteteve kundërpeshuese në këtë monedhë.

Grafik 95. Struktura e sektorit jobankar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

4.2 SEKTORI JOBANKAR

ECURIA E SEKTORIT JOBANKAR

Sektori jobankar shqiptar përbëhet nga institucionet financiare jobanka (IFJB), shoqëritë e kursim-kredititi (Sh.K.K.), shoqëritë e sigurimit, fondet e investimit dhe fondet e pensionit. Në tregun financiar veprojnë 36 IFJB, 16 SHKK, 12 shoqëri sigurimi, 11 fonde investimi dhe 4 fonde pensioni. Aktivet e sektorit jobankar zënë rreth 11% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 12% të PBB-së. Peshën kryesore në veprimtarinë e sektorit jobankar e zënë fondet e investimit të ndjekura nga institucionet financiare jobanka.

Pothuajse të gjitha segmentet e sektorit jobankar kanë shënuar zgjerim të aktivitetit gjatë gjysmës së dytë të vitit. Aktiviteti kryesor i institucioneve financiare jobanka është ai kreditues, i ndjekur nga pagesat dhe transfertat. Rreth 45% e portofolit të kredisë së dhënë nga jobankat mbahet nga individët, ndërsa pjesa tjetër nga sektori i bizneseve. Sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë është sektori më i financuar nga IFJB-të me rreth 20% të totalit të stokut të kredisë për bizneset, i ndjekur nga aktivitete të tjera shërbimi (15%). Rreth 70% e kapitalit aksionar të institucioneve jobanka është kapital vendas. IFJB-të e mbyllën vitin me një rezultat financiar pozitiv prej rreth 4 miliardë lekësh dhe kjo vlerë ishte 2 herë më e lartë se një vit më parë. Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet i lartë, ndërkohë që cilësia e portofolit të kredisë shënoi rënie në terma vjetorë, pasi raporti i kredive me probleme u rrit në 14% nga 11%.

Shoqëritë e kursim-kredititi shënuan zgjerim të aktivitetit të tyre kreditues dhe regjistruan një fitim neto pozitiv. Ky segment ka shënuar një përmirësim të lehtë të cilësisë së portofolit nga viti i kaluar, të pasqyruar në rënien e raportit të huave me probleme në 5.2% nga 5.8%. Në portofolin e investimeve të SHKK-ve, peshën kryesore e zënë investimet në kredi (70%) dhe investimet në banka në formën e depozitave me afat (20%). Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit nga këto subjekte është sektori i bujqësisë (32%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (12%).

Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit zgjeruan aktivitetin e tyre si rrjedhojë e rritjes së primeve të shkruara bruto dhe investimeve në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë. Fondet e investimit shënuan zgjerim të aktivitetit të tyre kryesisht në investimet në obligacionet qeveritare. Nga ana e detyrimeve, këto fonde regjistruan një rritje të zërit "kapital dhe aksione në fondet e investimit".

Grafik 96. Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas subjekteve në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 97. Mjetet, detyrimet dhe pozicioni neto sipas subjekteve të sektorit jobankar (Shtator 2021)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori jobankar ka regjistruar vazhdimisht një pozicion të balancuar të aktiveve dhe detyrimeve financiare[42]. Aktivet dhe detyrimet e këtij sektori në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021 shënonin rreth 190 miliardë lekë. Aktivet kryesore janë në formën e letrave me vlerë të borxhit dhe të huave, ndërsa detyrimet përfaqësohen nga monedha dhe depozita; nga kapitali dhe aksionet në fondet e investimit. Për herë të parë pas 5 vitesh, pozicioni neto i sektorit jobankar rezultoi negativ. Efektin kryesor në zhvendosjen e pozicionit e dha zgjerimi më i madh i detyrimeve kryesisht në formën e kapitalit dhe aksioneve në fondet e investimit në krahasim me rritjen e mjeteve. Brenda sektorit jobankar, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit kanë një pozicion neto negativ (debitor), ndërsa ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobankat dhe ShKK-të) kanë një pozicion neto pozitiv (kreditor). Për nënsektorin e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, pozicioni debitor në fund të tremujorit të tretë të vitit ishte sa 3% e totalit të aktiveve.

Grafik 98. Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas instrumenteve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 99. Ndërlidhja e sektorit jobankar me sektorin bankar (Shtator 2021)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[42] *Analiza për aktivet dhe detyrimet e sektorit jobankar është mbështetur në të dhënat e llogarive financiare për tremujorin e tretë të vitit 2021.*

Letrat me vlerë të borxhit zënë rreth 40% të aktiveve financiare të sektorit jobankar, ndërsa huatë dhe monedhat dhe depozitat zënë nga 22%. Këto raporte janë të ndryshme për segmente të ndryshme të kësaj pjese të sistemit financiar. Për fondet e investimit, letrat me vlerë të borxhit përfaqësojnë rreth 84% të aktiveve, ndërkohë që për ndërmjetësit e tjerë financiarë peshën më të madhe të mjeteve të tyre e zënë huatë. Shoqëritë e sigurimit dhe fondeve të pensionit të marra së bashku, kanë shpërndarjen më heterogjene të aktiveve. Rreth 34% e aktiveve të tyre është në formën e monedhave dhe depozitave, ndërkohë që 23%, 17% dhe 10% e aktiveve janë përkatësisht në formën e letrave me vlerë të borxhit, sigurimeve dhe skemave të pensioneve dhe kapitalit dhe aksioneve në fondet e investimit. Sipas instrumenteve, sektori jobankar ka një pozicion neto debitor për kapitalin dhe aksionet në fondet e investimit, në sigurime dhe skema pensionesh, me një pozicion neto kreditor për letrat me vlerë të borxhit dhe monedha dhe depozita.

RREZIQET DHE EKSPOZIMET MIDIS SEKTORIT BANKAR DHE JOBANKAR

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i kufizuar në vlera minimale dhe i qëndrueshëm. Në krahun e aktivit të bankave, ky ekspozim përfaqësohet kryesisht nga huatë akorduar institucioneve financiare jobankare. Ndërmjetësit financiarë (jobankat dhe SHKK-të) rezultojnë të jenë segmentet me stokun më të madh të financimit nga sektori bankar deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, në masën 14 miliardë lekë, ndjekur nga fondet e investimit me rreth 3 miliardë lekë. Financimi i përgjithshëm në formën e huave të dhëna nga sektori bankar për institucionet e tjera financiare rezidente është rreth 17 miliardë lekë dhe zë vetëm 1% të vlerës së bilancit të sektorit bankar.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë, por ka ardhur në rënie gjatë periudhës. Pretendimet e sektorit jobankar ndaj bankave janë në formën e vendosjeve (llogari rrjedhëse, dhe depozita me dhe pa afat). Stoku i fondeve të vendosura pranë bankave deri në fund të muajit shtator të vitit 2021 ishte rreth 45 miliardë lekë, ose sa 24% e totalit të aktiveve të sektorit jobankar, nga 26% në fund të vitit 2020. Vendosjet më të mëdha pranë sektorit bankar i kanë ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobanka, SHKK).

Këto vendosje janë sa rreth 50% e të gjitha vendosjeve të sektorit jobankar pranë bankave, por kanë rënë lehtë në krahasim me nivelin e regjistruar në fund të vitit 2020. Në raport me aktivet e veta, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit kanë ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar pasi vendosjet e tyre në banka përbëjnë rreth 34% të aktiveve të tyre. Për fondet e investimit është vërejtur një rritje e ndjeshmërisë ndaj zhvillimeve në sektorin bankar, duke qenë se vendosjet pranë bankave në formën e monedhave dhe depozitave janë rritur.

Aktualisht, sektori jobankar ka një pozicion neto kreditor me sektorin bankar që arrin në nivelin 28 miliardë lekë nga 30 miliardë lekë të raportuara në fund të vitit 2020. Një zgjerim i këtij pozicioni neto rrit ndjeshmërinë ose ekspozimin e sektorit jobankar ndaj ecurisë së aktivitetit të sektorit bankar dhe anasjelltas. Pozicionin neto kreditor më të lartë e kanë shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit, duke qenë se ato kanë vetëm vendosje pranë sektorit bankar, ndjekur nga ndërmjetësit e tjerë financiarë. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë në kuadrin e vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike dhe monitorimit të përmbushjes së objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.

5. POLITIKA MAKROPRUDENCIALE

5.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE NË SHQIPËRI

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritete të tjera, kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar. Si pjesë e këtij kontributi, Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton politikën makroprudenciale, e cila analizon e vlerëson rrezikun sistemik dhe zbaton masat për parandalimin e zbutjen e tij, në dy drejtime:

I. parandalon akumulimin e rreziqeve në sistemin financiar, dhe
II. forcon rezistencën e sistemit financiar.

Nga pikëpamja e parandalimit të akumulimit të rreziqeve, Banka e Shqipërisë harton analiza që synojnë identifikimin e zhbalancave financiare bazuar në monitorimin e ngushtë të performancës së treguesve që reflektojnë akumulimin e rreziqeve, me fokus kryesor sektorin bankar. Banka e Shqipërisë ka identifikuar tashmë një grup të plotë të treguesve makroprudencialë[43] në përputhje të plotë me rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB), të cilët grupohen në katër objektiva[44]. Pavarësisht vështirësive të krijuara nga situata e pandemisë COVID-19, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, treguesit e Hartës Makroprudenciale reflektojnë që sektori bankar ka vijuar të jetë i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e veprimtarisë. Në vijim paraqitet një analizë e shkurtër sipas secilit objektiv:

Objektivi I: Hendeku negativ i kredisë për ekonominë ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB) ka vijuar të mbetet në vlera negative, duke shënuar rënie të mëtejshme gjatë gjashtëmujorit të dytë 2021. Vlerat negative të këtij treguesi sinjalizojnë mungesën e një flluske kreditimi, por dhe nivelin e ulët të rritjes së kreditimit në raport me prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Zgjerimin më të madh në vlera negative e ka shënuar portofoli i kredisë për biznesin. Gjithashtu në vëmendje duhet mbajtur ecuria e kredisë për pasuri të paluajtshme dhe lidhja që ajo krijon me rritjen e çmimeve të banesave, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e këtyre zhvillimeve dhe rreziqet eventuale për stabilitetin financiar.

[43] *Për secilin objektiv janë përzgjedhur ata tregues që sinjalizojnë më mirë rrezikun sistemik rreth të cilit është ndërtuar objektivi. Monitorimi i sinjaleve të rrezikut që kap secili prej tyre bëhet duke krahasuar vlerën aktuale dhe ecurinë në kohë të treguesit ndaj një vlere kritike, tejkalimi i të cilës mund të sinjalizojë akumulim të rrezikut.*

[44] *Për më shumë, lutem konsultoni dokumentin "Strategjia e Politikës Makroprudenciale", nr. 37, datë 2.8.2017: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Strategjia_makroprudenciale/*

Objektivi II: Gjatë gjashtëmujorit të fundit, aktivet likuide kanë vijuar të jenë në nivele të kënaqshme, duke shënuar nivelin 33.3% të totalit të aktiveve, ose një rënie me 0.85 pp krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të parë 2021. Gjithashtu, ka vijuar hendeku i konsiderueshëm negativ midis aktiveve dhe pasiveve për të gjitha shportat e maturimit. Ndërkohë, *spread*-i i kursit të këmbimit për monedhën euro në tregun ndërbankar është zgjeruar më tej gjatë gjashtëmujorit të dytë 2021. Njëkohësisht, luhatshmëria e kursit të këmbimit për monedhën vendase është rritur gjatë këtij gjashtëmujori për shkak të situatës në tregjet ndërkombëtare. Zgjerimi i hendekut të likuiditetit, në kushtet edhe të ndryshimit të strukturës së burimeve të financimit në favor të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat, rrit nevojën e vëmendjes për rreziqet e likuiditetit në sektorin bankar dhe në banka të veçanta.

Objektivi III: Ekspozimi ndaj pesë vendeve kryesore si përqindje e totalit ka ruajtur nivel të përafërt. Për sa i përket ekspozimit të sistemit financiar ndaj një sektori të caktuar ekonomik[45], dhe gjatë gjashtëmujorit të dytë 2021 ka vijuar përqendrimi i kredisë kryesisht në sektorin e tregtisë, atë të ndërtimit dhe në industrinë përpunuese. Përdorimi i valutës vijon të mbetet i lartë, duke u shoqëruar me efekte negative mbi kanalet e transmetimit të politikës monetare dhe mbi administrimin e likuiditetit në valutë. Kreditë e pambrojtura në valutë e ekspozojnë sektorin bankar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, veçanërisht ndaj monedhës së përbashkët evropiane. Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit, të nënshkruar më 18 prill 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për të ulur nivelin e euroizimit në vend, Banka e Shqipërisë ka zbatuar një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase. Një analizë e detajuar për efektin e masave të deeuroizimit publikohet periodikisht në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.[46]

Objektivi IV: Totali i aktiveve të sektorit bankar në terma të PBB-së ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të kaluar (pas ndryshimit të metodologjisë së përdorur në llogaritje), duke sinjalizuar një rritje më të ngadaltë të sektorit bankar në raport me ecurinë ekonomike. Nga ana tjetër, detyrimet jorezidente dhe ekspozimet ndërbankare kanë qëndruar thuajse të pandryshuara ndaj fundit të gjashtëmujorit të parë 2021.

5.2 MASAT MAKROPRUDENCIALE NË SHQIPËRI

Gjatë periudhës, nuk pati masa të reja të natyrës makroprudenciale apo ndryshim të masave ekzistuese.

Veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua pa masat mbështetëse të natyrës prudenciale që Banka e Shqipërisë zbatoi në kuadër të zbutjes së efekteve

[45] *Për monitorimin e përqendrimit të ekspozimeve është përdorur metoda e indeksit të Herfindahl-it.*

[46] *https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Paketa_e_deeuroizimit/*

të pandemisë (që përfunduan në mars të vitit 2021). Përkundër pritjeve, nuk pati reagime të padëshiruara në cilësinë e kredisë së sektorit bankar. Zhvillimet e kreditimit kanë qenë të shpejta dhe kjo ka sjellë rënien e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në krahasim me një vit më parë. Zhvillimet gjeopolitike po e përballin ekonominë e vendit me mundësinë e ngadalësimit të rritjes dhe kjo mund të sjellë një rënie të volumit dhe të cilësisë së portofolit të kredisë. Në këto kushte do të ishte e nevojshme që bankat të ruanin pozicione sa më të mira të kapitalit, duke përfshirë edhe nëpërmjet ruajtjes së pashpërndarë të një vlere sa më të lartë të fitimeve.

Në zbatim të rregullores 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", është vijuar me publikimin e vendimeve të Guvernatorit[47], për zbatimin e këtyre shtesave.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka vijuar me operacionalizimin e vlerave të kapitalit që mbulojnë rreziqet strukturore të sistemit financiar, si dhe konceptimin e instrumenteve që parandalojnë rritjen e tepërt të kredisë dhe të borxhmarrjes, kryesisht nga sektori i individëve.

[47] *Mund të gjenden në adresën: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikës_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/*